



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 76/2021 regjistër (JR)
Datë 02.12.2021

Nr. 52 i vendimit
Datë 24.10.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 03.10.2024, ora 10:00 dhe datë 24.10.2024, ora 10:45, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 76/2021 (JR), datë 02.12.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 62,63, 64, 65 e 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 47, 51 pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, prej të cilave rezultoi si më poshtë.

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: *(i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor, për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarim të pasurisë; iv. nuk ka kryer deklarim të rremë; v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin e Grupit të Punës, i cili ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë vendimin nr. 450, datë 22.09.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 450, datë 22.09.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 dhe E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe

në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit si më poshtë.

4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar i lidhur me kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

4.4 Në vlerësimin tërësor të procedurave: konstatimet mbi procedimet penale të marra në trajtim në kuadër të kontrollit të figurës dhe konstatimet në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, cenojnë besimin e publikut te drejtësia dhe shkallën e besueshmërisë së tij, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 18.11.2021, ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit, duke kërkuar që Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë: (i) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes; (ii) ndryshimin e vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit; (iii) konfirmimin në detyrën e prokurorit të subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri.

6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të administruara nga Komisioni.

7. Shkaqet procedurale të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1 Komisioni i ka cenuar të drejtën e mbrojtjes efektive, si në drejtim të aksesit në dokumentacion, ashtu dhe në drejtim të kohës së kufizuar në dispozicion.

7.2 Komisioni ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, dhe se gjykimi nuk ka qenë i drejtë e brenda një afati të arsyeshëm.

7.3 Është vendosur pa drejtë në pozita që duhet të bëjë të pamundurën për të marrë dokumente jashtë vendit dhe në fund ato nuk vlerësohen ose interpretohen gabim duke i rënduar pozitën.

7.4 Janë keqinterpretuar kufizimet e përcaktuara në nenin A të Aneksit të Kushtetutës dhe janë cenuar të drejtat e shtetasit shqiptar me banim të përhershëm jashtë kufijve.

7.5 Vendimi i Komisionit nga ana formale është në kundërshtim me formën e vendimit që përcakton ligji.

7.6 Komisioni ka cenuar haptazi barazinë para ligjit, duke manifestuar diskriminim ndaj subjektit të rivlerësimit në statusin e prokurorit dhe duke u shfaqur inkuizitiv.

7.7 Komisioni nuk ka arsyetuar, përse shkeljet janë të tilla që janë vendimtare, dhe ai nuk mund të konfirmohet, por është shkarkuar, dhe përse nuk mund të aplikoheshin lloje të tjera vendimi;

7.8 Në proces nuk janë interpretuar drejt përkufizimet e ligjit nr. 84/2016, dhe se disa dispozita të tij janë në kontradikta mes tyre.

8. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë të parashtruara si “Konstatime mbi shkeljet e Komisionit në vlerësimin e pasurisë”, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

8.1 Komisioni ka administruar raportin e ILDKPKI-së jashtë afatit ligjor dhe nuk ka vendim të arsyetuar për vazhdimin e procesit të rivlerësimit në aspektin e kriterit të pasurisë.

8.2 Komisioni nuk ka mbajtur parasysh problemet me deklaratimet ndër vite, kohën e shkurtër për dokumentacionin dhe ngarkesat në kohën e përpilimit të deklaratës vetting.

8.3 Deklaratat e pasurisë ndër vite shërbejnë si prova për të konkluduar mbi vërtetësinë e deklaratës së pasurisë vetting, por nuk janë objekt shqyrtimi se si janë apo se si duheshin bërë.

8.4 Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deklaratat noteriale të paraqitura prej tij, të cilat përputhen me realitetin, ashtu si në fakt ka vepruar me disa subjekte të konfirmuara në detyrë.

8.5 Është e papranueshme se si Komisioni nuk paraqet një analizë me tregues financiarë konkretë dhe nga ana tjetër konsideron probleme me qarkullimin monetar.

8.6 Në lidhje me pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 69,30 m², në zonën {***}, Sarandë”, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) nuk ka asnjë sjellje specifike të tij që të manifestojë ndonjë qëllim për të pasqyruar fakte jo të vërteta apo të ndryshme, aq më tepër për të kryer deklaram të rremë a tentuar fshehjen e pasurive; (ii) Komisioni tejkalon logjikën duke konstatuar se vjehri dhe vjehrra e tij nuk justifikojnë pasurinë, kur ligji i njej të ardhurat nga emigracioni; (iii) askush që ka mundësi t’i sjellë paratë vetë ose me të tjerë, për shuma nën kufirin ligjor, nuk mund të jetë i detyruar të paguajë në banka apo transfera.

8.7 Në lidhje me pasurinë “Automjet tip Audi”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni mbi cenimin e besimit të publikut është i paargumentuar, formal dhe subjektiv.

8.8 Në lidhje me pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 93 m², në Sarandë dhe shtesë banese me sipërfaqe 40 m²”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i paarsyetuar dhe i pambështetur në ligj.

8.9 Në lidhje me pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 112 m², zyrë me sipërfaqe 28 m², truall me sipërfaqe 150 m², në Sarandë”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në prova dhe se ligjshmëria e burimeve të tij është e qartë.

8.10 Në lidhje me pasurinë “Garazh me sipërfaqe 23,8 m², në Lagjen nr. {***}, Sarandë”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në prova, pasi babai i tij ka disponuar leje drejtimi mjeti që prej vitit 1967, ndërsa certifikata e pronësisë së garazhit është paraqitur dhe është mohuar.

8.11 Në lidhje me pasurinë “Truall me sipërfaqe 4200 m², {***}, Sarandë”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në prova dhe se ligjshmëria e burimeve të tij është e qartë.

9. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit si “Konstatime mbi shkeljet e Komisionit në kontrollin e figurës”, konsistojnë në faktin se Komisioni ka vepruar në kundërshtim më frymën kushtetuese dhe qëllimin e ligjit sipas nenit DH të Kushtetutës dhe standardet e përcaktuara nga neni 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Sipas

tij, Komisioni ka paraqitur vlerësime joligjore dhe abuzive të një organi jo të pavarur si DSIK-ja, nuk ka kryer hetime dhe nuk ka asnjë pretendim në drejtim të subjektit. Konkluzioni i Komisionit mbi cenimin e besimit të publikut është i paarsyetuar.

10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të parashtruara si “Konstatime mbi shkeljet e Komisionit në vlerësimin e aftësive profesionale”, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë: (i) Komisioni nuk ka arsyetuar përse i referohet ligjit nr. 96/2016 për raste jashtë periudhës së rivlerësimit, duke i dhënë ligjit fuqi prapavepruese; (ii) shkeljet apo mangësitë profesionale të konstatuara nuk mjaftojnë për kualifikimin “si të papërshtatshëm profesionalisht” dhe aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
11. Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit që të merren në shqyrtim e të vlerësohen aktet e paraqitura bashkëlidhur ankimit, si vijojnë: (a) 5 (pesë) kontrata kredie bankare afatmesme ekspres të lidhura mes Bankës Societe Generale Albania ShA, e përfaqësuar nga E. M., drejtoresh e degës së kësaj banke në Sarandë dhe shtetasve të ndryshëm në cilësinë e kredimarrëve: (i) kontratë kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2011; (ii) kontratë kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.02.2011; (iii) kontratë kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.12.2010; (iv) kontratë kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2010; (v) kontratë kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.09.2010; (b) dëshmi aftësie “Për drejtim automjetesh”, nr. {***}, në emër të shtetasit Th. M.; (c) vërtetim nr. {***} prot., datë 16.11.2021, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Sarandë; (d) vërtetim nr. {***}, datë 11. 11.2021, lëshuar nga Drejtoria e Drejtuesve të Mjeteve Tiranë.
12. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti parashtrime me shkrim mbi shkaqet e ngritura në ankim, sikurse parashikon neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

14. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

15. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit, për shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
16. Trupi gjykues, fillimisht, mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit, që do të cenonte procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si vijon.
17. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni i ka cenuar të drejtën e mbrojtjes efektive, si në drejtim të mungesës së aksesit në dokumentacion ashtu dhe në drejtim të kohës së kufizuar në dispozicion*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet si vijojnë: (i) nuk i është dhënë asnjëherë raporti i DSIK-së, për më tepër kur pati dhe deklasifikim të tij; (ii) nuk i janë bërë të njohura informacionet e administruara nga Komisioni mbi kontrollin e figurës duke keqinterpretuar kufizimet ligjore dhe jurisprudencën e GjEDNj-së në çështjen Regner kundër Republikës Çeke; (iii) nuk është njohur me aktet që vërtetojnë përkthimin në gjuhën angleze të dokumentacionit për vëzhguesit ndërkombëtarë; (iv) ka pasur vështirësi në sigurimin e dokumentacionit dhe në shumë raste është vendosur përballë situatave të pa pretenduara më parë; (v) gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, ishte vendosur nën një nxitim të imponuar nga ana e trupit gjykues.

17.1 Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në datën 26.08.2021, ka nënshkruar në ambientet e Komisionit një deklaratë, në të cilën deklaroi njohjen dhe marrjen e të gjithë dokumentacionit të kërkuar prej tij në CD dhe në formë shkresore sipas kërkesës, dhe se nuk ka asnjë vërejtje. Edhe në shpjegimet shtesë mbi rezultatet e hetimit të datës 03.09.2021, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Prej datës 26.08.2021 unë kam në dispozicion dhe një CD ku gjenden akte të dosjes lidhur me hetimin administrativ ndaj meje në këtë proces. Ndër aktet që konstatoj janë padyshim një pjesë e madhe e tyre që lidhen me sa kam parashtruar më parë apo dhe pretendime e prova shtesë që do të paraqes”. Ndërsa në lidhje me raportin e DSIK-së, duke konfirmuar faktin se tashmë është parë prej tij, në këto shpjegime ka deklaruar: “Nuk e kuptoj pse nuk më jepet raporti i parë, ku ka qenë ndryshimi konkret, kush është autoriteti që mund të sajojë kaq subjektivisht [...]”. Gjatë seancës dëgjimore të datës 21.09.2021, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrjen në dorëzim të dokumentacionit të Komisionit, si dhe ka deklaruar se nuk ka kërkesa paraprake¹.

17.2 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *atij i është cenuar e drejta e mbrojtjes efektive për shkak të mosnjohjes me informacionin e plotë të kontrollit të figurës (informacionin e klasifikuar)*, trupi gjykues konstaton se:

¹ Shih procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 21.09.2021.

i) Në vendim, lidhur me kontrollin e figurës, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “[...] nuk rezultuan marrëdhënie të tilla që të mund të kualifikohen në kuptim të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk ka rezultuar person me kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por se konstatimet e gjetura gjatë hetimit, të rrethanave që përmbajnë praktikën e procedimeve penale, analizuar në funksion të këtij kriteri kanë dëshmuar se subjekti, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka krijuar kushtet e klimës së pandëshkueshmërisë në sytë e publikut, duke cenuar besimin e publikut të drejtësia [...]”. Më tej, në paragrafët 28, 29 dhe 30, Komisioni shprehet: “[...] 28. Në vlerësim të trupit gjykues mbahet edhe aksesi nga ana e tij, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, për kontrollin e kriterit të figurës për subjektin, me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit që shërbyen për arritjen e konkluzioneve paraqitur nga Grupi i Punës në raportin e DSIK-së. 29. Aksesimi i informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u vënë në dispozicion të trupit gjykues dhe të vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së dosja që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga ShISh-i për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit. 30. Në kuadër të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GjEDNj-së në çështjen Regner kundër Republikës Çeke, njohja me provat e administruara gjatë hetimit të Komisionit, për shkak të natyrës së informacionit që mbart edhe kushtet specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, u krye pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror, trupi gjykues verifikoi në vend të njëjtin informacion të aksesuar edhe nga Grupi i Punës së DSIK-së, si dhe burimet e informacionit që kanë shërbyer për hartimin e raportit të këtij grupi [...]”.

ii) Në rezultatet e hetimit administrativ, parashtrohet se: “[...] Komisioni bazuar në informacionin e dhënë në raportin e DSIK-së, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion dhe analizoi procedimet penale nr. {***}/2014, nr. {***}/2016 dhe nr. {***}, me të cilin janë bashkuar procedimet penale nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} dhe nr. {***}, të vitit 2016. Lidhur me komponentin e figurës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të neneve Ç dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në referim dhe të dosjeve të analizuar nga Komisioni [...]”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: “[...] Konkluzionet janë të pavërteta, ndërkohë janë dukshëm përgjithësuese dhe joserioze, pas asnjë provë. Në lidhje me figurën nuk ka asgjë konkrete që më bëhet prezent dhe mund të përgjigjem në kuadrin e konstatimeve përgjithësuese. Është e papranueshme që të paraqiten konkluzione subjektive, pa baza dhe pa verifikime, pra në kundërshtim me ligjet, ndërkohë nuk jepet asgjë konkrete”. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë në vijim shpjegime konkrete lidhur me procedimet penale të trajtuara në kuadër të kontrollit të figurës.

17.3 Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjektit të rivlerësimit i është bërë me dije, që në rezultatet e hetimit, se çështjet për të cilat atij i kishte kaluar barra e provës në kuadër të kontrollit të figurës lidheshin me problematika në dosjet e disa procedimeve penale të trajtuara prej tij, të cilat ishin administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Ndonëse nuk ka vendosur në dispozicion të subjektit të rivlerësimit dokumentacionin e klasifikuar, i cili

sipas kuadrit ligjor nuk mund të përdoret në aktet publike², Komisioni duke marrë shkas nga informacionet e organeve ligjzbatuese mbi indicie për përfshirje të tij në veprime korruptive në disa çështje penale gjatë periudhës që ka qenë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe Sarandë, ka bërë pjesë të hetimit administrativ disa çështje penale të hetuara prej tij, me të cilat subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka debatuar duke dhënë shpjegime me shkrim e paraqitur prova e, së fundi, është dëgjuar edhe në seancë dëgjimore. Pra, në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjektit të rivlerësimit, përveçse i është bërë e mundur njohja me dokumentacionin e deklasifikuar pjesërisht, i është dhënë mundësia të mbrohet në atë kufi që Komisioni ka mbështetur vendimmarrjen e tij.

17.4 Pavarësisht se Komisioni në lidhje me kontrollin e figurës nuk i ka atribuuar subjektit të rivlerësimit pasojën ligjore të parashikuar nga neni 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur në vendim shprehet se për krijimin e bindjes në lidhje me këtë kriter ka verifikuar drejtpërdrejt pranë Shërbimit Informativ të Shtetit (në vijim “ShISh”) dosjen e praktikës së verifikimit të kryer nga ky institucion për rastin në fjalë dhe konstatimet lidhur me procedimet penale të trajtuara në kuadër të kontrollit të figurës i ka vlerësuar si sjellje që cenojnë besimin e publikut të drejtësia, trupi gjykues i Kolegjit, në konsideratë edhe të qëndrimit të GjEDNj-së në çështjen *Thanza kundër Shqipërisë*³ dhe në jurisprudencën e deritanishme të tij⁴, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të datës 03.10.2024, u njoh në mënyrë të drejtpërdrejtë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, me të njëjtin informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, të cilin kishte aksesuar Komisioni gjatë hetimit administrativ. Në përfundim të këtij verifikimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se klasifikimi i informacionit të institucioneve verifikuese është i justifikuar dhe se ekspozimi i tij do të cenonte burimin këtij informacioni, duke rrezikuar sigurinë e tij.

17.5 Në vijim të analizës së mësipërme, lidhur me pretendimin për keqinterpretim të dispozitave mbi kufizimet ligjore dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, konkretisht çështjes *Regner kundër Republikës Çeke*, trupi gjykues sjell në vëmendje se bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, anëtarët e organeve të rivlerësimit kanë akses dhe mund të verifikojnë dhe studiojnë dokumente të klasifikuara, por sipas parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e organeve ligjzbatuese që i disponojnë ato, pa ekspozuar burimin dhe pa përdorur këto dokumente në aktet publike⁵. Ky parim materializohet në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin përcaktohet se *informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit [...]*. Në çështjen *Regner*

² Ligji nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, në nenin 2 të titulluar “Përkufizime” parashikon: “Sekret shtetëror” do të thotë informacion i klasifikuar sipas këtij ligji, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar. “Informacion” do të thotë çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma dhe që është nën kontrollin e shtetit. “Institucion” do të thotë një institucion shtetëror apo çdo zyrë tjetër brenda këtyre institucioneve, që vihet në zotërim të një informacioni të klasifikuar. “Kontroll” do të thotë e drejta e autoritetit nga buron informacioni i klasifikuar apo zotëruesit e tij, për ta mbrojtur nga çdo e drejtë njohjeje e paautorizuar”; dhe në nenin 4 të titulluar “Autoriteti klasifikues” parashikon “Informacioni që përbën sekret shtetëror klasifikohet nga një autoritet i klasifikimit origjinal. Ai zotërohet e prodhohet për interesa të shtetit dhe është nën kontrollin e tij”.

³ Shih <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-225653>, vendimi i GjEDNj-së, çështja *Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafët 113-123.

⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 7, datë 24.06.2020, nr. 14, datë 14.09.2020 dhe nr. 31, datë 27.07.2022.

⁵ Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për shërbimin informativ kombëtar”, i ndryshuar, në nenin 10, parashikon: “Shërbimi Informativ Kombëtar përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit”.

kundër Republikës Çeke, GjEDNj-ja ka vlerësuar se: [...] e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim [...]. Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit, për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'u përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...]. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se mosnjohja e subjektit të rivlerësimit me të dhënat e aksesuara nga Komisioni drejtpërdrejt në ShISH, përbën një kufizim proporcional dhe në përputhje me garancitë për një proces të rregullt ligjor nën dritën e parashikimeve të KEDNj-së.

17.6 Sa i takon mungesës së akteve që vërtetojnë përkthimin e dokumentacionit të rivlerësimit për vëzhguesin ndërkombëtar, trupi gjykues sjell në vëmendje se dispozitat kushtetuese dhe ligjore i kanë njohur vëzhguesve ndërkombëtarë të ONM-së një status të veçantë, duke i dhënë akses të plotë në dosjen e procesit të rivlerësimit⁶, çka nënkupton që ai mund të njihet në çdo kohë dhe pakufizim me të, papërcaktuar procedurë të veçantë komunikimi. Çështja e përkthimit të informacionit dhe përcjellja e tij mbetet çështje e organizimit të brendshëm të këtij institucioni, që duket se nuk afekton ndonjë element që lidhet me mbrojtjen efektive të subjektit të rivlerësimit. Ndërkaq, në rastin konkret nuk rezulton që vëzhguesi ndërkombëtar të ketë paraqitur gjetje apo mendim, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, e cila në këtë rast do të duhet të ishte pjesë e dosjes së rivlerësimit.

17.7 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kohë të pamjaftueshme në dispozicion të tij, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ më datë 03.08.2021, duke caktuar si afat për paraqitjen e provave e shpjegimeve datën 23.08.2021, pra, një afat 20-ditor që është dhe afati maksimal i parashikuar nga pika 6⁷, shkronja “f” e aktit rregullator të Komisionit “Mbi hapat proceduralë të unifikuar”. Për shkak të njohjes me vonesë me aktet e dosjes nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni e zgjati këtë afat edhe me 7 (shtatë) ditë tjera e, për më tepër, nuk ka refuzuar në asnjë fazë të procedurës së rivlerësimit dokumentet e paraqitura nga subjekti, qoftë edhe ato të paraqitura me vonesë. Sa i takon pretendimit të subjektit mbi vështirësinë për të siguruar dokumentacion gjatë kohës së përgatitjes së mbrojtjes nga ana e tij, nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur prapësimeve apo atyre të paraqitura në seancë dëgjimore, trupit gjykues nuk i rezultojnë kërkesa të subjektit drejtuar ndonjë institucioni, e cila të ketë mbetur pa përgjigje apo përgjigje të ardhura me vonesë. Gjatë seancës dëgjimore nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë shfaqur ndonjë kundërshti mbi ndonjë

⁶ Në pikën 5, të aktit rregullator “Hapat proceduralë të unifikuar” parashikohet se vëzhguesi ndërkombëtar ka akses të plotë në çdo dokument përbërës të dosjes.

⁷ Në pikën 6, shkronja “f” parashikohet se: “Kur trupa gjykon se janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm hetimorë për përfundimin e hetimit kryesisht, merr vendim për: (i) përfundimin e tij; dhe (ii) njoftimin e subjektit si më poshtë vijon: [...] “f”. Afatin brenda të cilit duhet bëjë kërkesën me shkrim për njohjen me dosjen dhe të paraqesë prova/ shpjegime me shkrim apo të bëjë kërkesa në përputhje me pikat “d” dhe “e” të kësaj pike. Ky afat nuk mund të jetë më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t’u njohur me dosjen”.

element procedural të procedurës së hetimit administrativ, për shkak të mungesës së dokumentacionit nga ndonjë institucion apo individ në veçanti.

17.8 Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, për një nxitim të imponuar ndaj tij gjatë seancës dëgjimore, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 21.09.2021, trupi gjykues vëren se pas prezantimit të përmbajtjes së dosjes së rivlerësimit nga relatorja e çështjes e ka marrë fjalën subjekti i rivlerësimit, i cili ka parashtruar me hollësi pretendimet e tij, të njëjta me ato të paraqitura në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ. Për shkak të këtij prezantimi të detajuar të pretendimeve të tij, në kushtet kur Komisioni ishte njohur me to paraprakisht, dhe në mbështetje të nenit 55, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kryesuesi i trupit gjykues i ka kërkuar disa herë subjektit të rivlerësimit që të ishte më i përmbledhur në shpjegimet e tij. Megjithatë, ai ka vijuar me shpjegimet, duke i paraqitur ato në mënyrë të plotë dhe në përfundim ka ushtruar të drejtën për të dhënë qëndrimin përfundimtar në lidhje me procesin e rivlerësimit të zhvilluar ndaj tij. Bazuar në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është kufizuar në të drejtën e tij për t'u shprehur në seancë dëgjimore. Lidhur me pretendimin se subjekti i rivlerësimit është vendosur në kushtet e pretendimeve që i dëgjonte për herë të parë e për të cilët nuk kishte pasur kohën e mjaftueshme për t'i sqaruar, trupi gjykues vëren se një pretendim i tillë është ngritur nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e datës 23.08.2021, kur ai ende nuk ishte njohur me aktet e dosjes së rivlerësimit e, për këtë arsye, kishte kërkuar zgjatjen e afatit për përgatitjen e mbrojtjes së tij. Pas plotësimit të kësaj kërkesë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë ngritur ndonjë pretendim për konkluzione që i dëgjonte për herë të parë, qoftë në prapësimet shtesë të datës 03.09.2023, qoftë në seancën dëgjimore të datës 21.09.2023, kur ka mbajtur qëndrimin e tij përfundimtar. Gjithashtu, trupi gjykues, referuar tërësisë së dokumentacionit të dosjes së rivlerësimit, vëren se Komisioni, pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, nuk ka administruar prova nga institucione publike apo private, me përjashtim të provave të paraqitura nga subjekti në prapësimet e tij në datat 23.08.2021 dhe 03.09.2023, si dhe në seancën dëgjimore të datës 21.09.2023. *Bazuar në sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive është i pabazuar.*

- 18.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, pasi është krijuar në kundërshtim me ligjin dhe ka qenë në konflikt interesi. Sipas subjektit të rivlerësimit, gjykimi nuk ka qenë i drejtë e brenda një afati të arsyeshëm. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet si vijojnë: (i) personat që kanë përpiluar aktet në proces nuk e kanë kompetencë, nuk shfaqen, nuk deklarojnë konfliktin e interesit, paraqesin përlllogaritje dhe interpretime të gabuara; (ii) kërkesat, ankesat dhe vërejtjet e tij, jo vetëm nuk janë marrë parasysh, por në shumicën e rasteve nuk kanë marrë përgjigje, janë devijuar ose kanë marrë përgjigje të pjesshme a të përcipta, ndërkohë nuk mund të flitet për arsyetim; (iii) komunikimet në adresën elektronike kanë qenë thujtë të njëanshme, me afate të shkurtra e të palogjikshme; (iv) për të njëjtat shkaqe ndëshkimi apo mosplotësim kriteresh deri tek etika për subjektet e rivlerësimit, administrata e organeve të rivlerësimit vazhdon punën normalisht, edhe pse kanë qenë të dënuar për kundërvajtje të caktuara apo kur janë në hetim penal.*

18.1 Në analizë të pretendimeve të mësipërme, trupi gjykues sjell në vëmendje se kompetencat

e Komisionit në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Edhe në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, për pretendime të njëjta të kërkuases me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me një gjykatë jo të pavarur e të krijuar në kundërshtim me ligjin, GjEDNj-ja ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme⁸. Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se që në nisje të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit është njoftuar më datë 06.12.2019 mbi përbërjen e trupit gjykues dhe të drejtën për t'u shprehur mbi konfliktin e interesit. Të tre anëtarët e trupit gjykues kanë nënshkruar deklaratat, në të cilat kanë deklaruar se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin. Nga ana tjetër edhe subjekti i rivlerësimit, me marrjen dijani të përbërjes së trupit gjykues, konfirmoi mungesën e konfliktit të interesit, duke deklaruar shprehimisht në përgjigjet e pyetësorit standard⁹ se: *“Konfirmoj faktin se jam njohur me trupën gjyqësore të KPK, në përbërje të së cilës janë komisionerët: Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Xhensila Pine, si dhe faktin se deri aktualisht nuk kam evidentuar ndonjë situatë konflikti interesi me ndonjërin prej tyre. Nëse gjatë procedurës së rivlerësimit do të evidentohet ekzistenca e ndonjë shtate konflikti interesi, rezervoj të drejtën që ta paraqes në momentin e duhur”*. Si përgjatë procesit të rivlerësimit, ashtu dhe në seancë dëgjimore, trupit gjykues nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues, të ketë kërkuar përjashtimin e tyre apo ndonjë prej tyre të ketë kërkuar heqje dorë, gjë që mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit.

18.2 Sa i takon pretendimeve lidhur me këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues sjell në vëmendje se referuar parashikimeve të nenit 22 të ligjit nr. 84/2016, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron veprimtari këshilluese dhe mbështetëse në procesin e rivlerësimit, pa qenë i parashikuar në ligj detyrimi për identifikimin e personit konkret që kryen këtë funksion. Ata nuk kanë kompetenca vendimmarrëse, çka përjashton mundësinë e konfliktit të interesit, në kuptim të ligjit nr. 9367/2005¹⁰. Analizat financiare të kryera nga kjo strukturë, i nënshtrohen debatit nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit dhe, në përfundim, lidhur me to, vendos trupi gjykues i Komisionit, i ngarkuar me short për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Për pretendimin tjetër, se për të njëjtat shkelje që shërbejnë si shkak për shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit anëtarët apo administrata e institucioneve të rivlerësimit vazhdon të qëndrojë në detyrë, ndonëse nga subjekti nuk referohet rast konkret, trupi gjykues sjell sërish në vëmendje se sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, subjekte të këtij procesi janë gjyqtarët dhe prokurorët, dhe jo anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, përgjegjësia disiplinore e të cilëve është e përcaktuar qartësisht nga ligji nr. 84/2016.

⁸ Paragrafët 307, 308 dhe 317, të vendimit të GjEDNj-së.

⁹ Përcjellë Komisionit më datë 20.12.2019.

¹⁰ Neni 4 parashikon: “2. Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; c) një zyrtar” ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit”.

18.3 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se kërkesat, ankesat apo vërejtjet e tij drejtuar Komisionit, jo vetëm nuk janë marrë parasysht, por as është kthyer përgjigje*, nga aktet në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se: (i) me e-mail të datës 28.06.2021, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit ridërgimin e pyetësorit (nr. 3), i cili, pavarësisht njoftimit të Komisionit se i ishte dërguar që më datë 25.06.2021, nuk kishte mbërritur në postën e tij elektronike. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioni i ka përcjellë subjektit përmes postës elektronike më datë 29.06.2021 pyetësorin përkatës, duke i caktuar si afat për kthimin e përgjigjeve datën 09.07.2021; (ii) me kërkesën e datës 19.08.2021, për shkak se ende nuk ishte njohur me dosjen e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit shtyrjen e afatit të paraqitjes së prapësimeve. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioni, me vendimin e datës 26.08.2021, vendosi të shtyjë afatin e dorëzimit të prapësimeve deri në datën 03.09.2021; (iii) në prapësimet mbi rezultatet e hetimit të datës 23.08.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të thirren e të pyeten si dëshmitarë shtetasit M. N., E. M., dhe K. M.. Nga verifikimi i akteve procedurale të Komisionit nuk rezulton që subjektit të rivlerësimit t'i jetë kthyer përgjigje për këtë kërkesë. Ndërkaq referuar prapësimeve shtesë të datës 03.09.2021 dhe procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 21.09.2021, trupit gjykues nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë rishprehur kërkesë specifike apo sqarime për mosthirrjen e dëshmitarëve të adresuar më herët në prapësimet e tij, madje i pyetur nga kryesuesi i trupit gjykues ka deklaruar se nuk ka kërkesa paraprake. Në vendim, Komisioni ka arsyetuar¹¹ duke vlerësuar të panevojshëm thirrjen si dëshmitar të shtetasit M. N., bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që nuk rezulton ndonjë përgjigje për pjesën tjetër të kërkesës, lidhur me shtetasit E. M., dhe K. M. Në këtë drejtim, trupi gjykues vëren se nuk janë respektuar plotësisht përcaktimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të Komisionit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit. Veç kësaj, Komisioni nuk është shprehur brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve, sikurse parashikon pika 8 e aktit rregullator "Për hapat procedurale të unifikuar"¹², i ndryshuar, dhe subjekti i rivlerësimit erdhi në dijeni të vlerësimit të Komisionit mbi këtë kërkesë vetëm në vendimin përfundimtar. Megjithatë, nisur nga fakti që subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore iu dha mundësia për të paraqitur kërkesa procedurale dhe ai zgjodhi të mos paraqiste të tilla, shkelja procedurale e kryer në këtë rast vlerësohet se nuk mund të ngrihet në atë nivel sa të justifikojë korrigjimin e procedurave nëpërmjet debatit gjyqësor në Kolegj apo ta bëjë të cenueshëm vendimin e Komisionit.

18.4 Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, *mbi njëanshmërinë e komunikimit, kohën e pamjaftueshme për t'iu përgjigjur pyetësorëve dhe gjykimin brenda një afati jo të arsyeshëm*, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton

¹¹ Në paragrafët 74-75, Komisioni shprehet se: "74. Deklarata noteriale e shtetasit M. N., merret me rezervë në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklaratës së subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratës noteriale forcohet sidomos pasi nuk mbështetet dhe nuk është në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit, referuar më sipër. 75. Deklarata noteriale rezulton se daton pas dorëzimit të deklaratës vetting, administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si e tillë, ashtu sikurse dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbetet në nivelin deklarativ. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi të panevojshëm thirrjen dëshmitar të këtij shtetasi, bazuar në pikën 6/a, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016".

¹² Në pikën 8 përcaktohet: "8. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit për thirrjen e një dëshmitari apo marrjen e një prove, trupa gjyqësore, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendos me arsyetim për pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në rast se kjo kërkesë pranohet, relatori i çështjes ka detyrimin të marrë deklarinim/provën mbështetëse, ta vlerësojë atë dhe ta përfaqësojë në relacionin përfundimtar".

se procesi i rivlerësimit në rastin konkret është shtrirë në një hark kohor prej 1 (një) vit, 10 (dhjetë) muaj e 9 (nëntë) ditë¹³. Gjatë kësaj periudhe, trupi gjykues vëren se ka pasur një komunikim të dyanshëm mes Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit, përmes 3 (tre) pyetësorëve të dërguar nga Komisioni dhe përgjigjeve respektive, si vijojnë: (i) pyetësori standard i dërguar nga Komisioni në datën 06.12.2019, me një afat prej 15 ditësh për kthimin e përgjigjeve. Subjekti i rivlerësimit ka kthyer përgjigje brenda afatit, më datë 20.12.2019, ndërkohë ka dërguar elektronikisht në datën 07.01.2020 edhe sqarim shtesë lidhur me pyetjen 18 të pyetësorit dhe dokumente shoqëruese; (ii) pyetësori nr. 2 i dërguar nga Komisioni më datë 23.11.2020, me një afat prej 8 ditësh për kthimin e përgjigjeve. Subjekti i rivlerësimit ka kthyer përgjigje brenda afatit, më datë 30.11.2020; (iii) pyetësori nr. 3 i dërguar nga Komisioni më datë 29.06.2021, me një afat prej 10 ditësh. Subjekti i rivlerësimit ka kthyer përgjigje brenda afatit, më datë 09.07.2021, ndërkohë në plotësim të përgjigjeve të tij ka përcjellë në datën 16.07.2021 sqarime mbi pyetjen nr. 6 të pyetësorit, së cilës nuk i ishte përgjigjur brenda afatit. Në përgjigjet e tij nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ngritur shqetësime për kohë të pamjaftueshme dhe nga ana tjetër nuk rezulton që Komisioni të ketë refuzuar në ndonjë rast dokumente apo shpjegime shtesë të dhëna nga subjekti në plotësim të përgjigjeve të tij, edhe në tejkallim të afateve të caktuara. Në vlerësimin e trupit gjykues, fakte të tilla si kohështrirja e procesit të rivlerësimit, paraqitja e shpjegimeve dhe provave brenda afatit të caktuar, e pashoqëruar me ngritjen e shqetësimeve nga subjekti i rivlerësimit për kohë të pamjaftueshme, pranimi nga Komisioni në çdo rast i shpjegimeve shtesë dhe provave të paraqitura, edhe në tejkallim të afateve, në të gjitha fazat e procesit deri në seancën dëgjimore, dhënia e kohës shtesë për të paraqitur prapësime dhe dokumente për të kundërshtuar barrën e provës, pavarësisht faktit që organet e rivlerësimit kanë detyrimin të përmbushin rivlerësimin kalimtar brenda një kohë të caktuar, nuk e mbështesin pretendimin e tij për proces të njëanshëm dhe gjykim jo në një afat të arsyeshëm.

19. Subjekti ka pretenduar se *Komisioni nuk ka kryer hetim të plotë dhe e ka vendosur atë me pa të drejtë në pozita që duhet të bëjë të pamundurën për të marrë dokumente jashtë vendit e në fund ato nuk vlerësohen ose interpretohen gabim duke i rënduar pozitën. Barra e provës nuk mund të aplikohet pa vend, ajo është mjeti i fundit dhe mund të përdoret në kushte pamundësie të vërtetuara për marrjen e informacionit, por jo për situata apo fakte të njohura botërisht.*

19.1 Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues, referuar akteve të administruara, vëren se Komisioni përveç analizimit të raporteve të institucioneve të pavarura ndihmëse, si ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme, ka hetuar në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë, duke iu drejtuar subjekteve publike dhe private për të marrë informacionin e duhur për subjektin dhe personat e lidhur. Po ashtu, trupi gjykues vëren se Komisioni ka administruar informacionin e dërguar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të tri pyetësorëve. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit, duke i bërë të njohur gjetjet për të cilat i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e tyre. Në seancën dëgjimore të datës 21.09.2021, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë procedurale në drejtim të riçeljes

¹³ Nga data e hedhjes së shortit më datë 12.11.2019 deri në ditën e seancës dëgjimore më 21.09.2021.

së hetimit administrativ për marrjen e ndonjë prove të re, në kuadër të ndonjë konstatimi për hetim të mangët nga ana e Komisionit.

19.2 Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues sjell në vëmendje se specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30-32 të ligjit nr. 84/2016, është që subjekti i kontrollit në procesin e rivlerësimit është subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të dhe detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar nga dhurime apo huamarrje të konfirmuar nga persona të tjerë të lidhur e ka vetë subjekti i rivlerësimit. Po kështu, edhe barra e provës¹⁴ është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra, i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim. Në zbatim të këtyre normave, trupi gjykues, në rastin konkret, vëren se dokumentacioni mbi të ardhurat nga puna e prindërve të bashkëshortes në ShBA është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, fillimisht me përgjigjet e pyetësorit standard e më pas me përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Pas analizimit e vlerësimit të këtij dokumentacioni, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni arriti në konkluzionin paraprak se *për sa i përket të ardhurave nga punësimi në ShBA i prindërve të bashkëshortes, të dhënat e depozituara, ndonjëse jo në formën e kërkuar nga ligji, fillojnë në vitin 2012, pra, nuk mund të japin një evidencë për të ardhura që i takojnë një periudhe të mëparshme kohore, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me këtë pasuri.* Subjekti i rivlerësimit depozitoi sërish dokumentacion mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortes nga puna në ShBA, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit të datës 23.08.2023 dhe në seancën dëgjimore të datës 21.09.2021, pa ngritur pretendime në ndonjë fazë të procesit mbi pamundësinë e tij për të gjetur dokumentacion në lidhje me të ardhurat nga puna e prindërve të bashkëshortes së tij në ShBA. Bazuar në këtë situatë faktesh, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka përmbushur detyrimin sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për t'i bërë me dije subjektit çështjet për të cilat provat kanë pasur nivelin e provueshmërisë, ndërkaq vlerësimi përfundimtar i provave bëhet nga Komisioni në vendimin përfundimtar, pas kryerjes së hetimit administrativ dhe pas dhënies së shpjegimeve përfundimtare të subjektit në seancë dëgjimore. Parimisht, ky vlerësim i provave, i ndryshëm nga vlerësimi që iu bën atyre subjekti, nuk do të thotë *apriori* se ato nuk janë vlerësuar nga Komisioni. Në rastin konkret, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me mungesën e vlerësimit nga ana e Komisionit të dokumentacionit mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortes në ShBA, do të jetë pjesë e analizës së shkaqeve të ankimit për sa i përket pasurisë respektive.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *në proces janë keqinterpretuar kufizimet e përcaktuara në nenin A të Aneksit të Kushtetutës. Janë cenuar të drejtat e shtetasit shqiptar me banim të përhershëm jashtë kufijve, të garantuara nga neni 8 i Kushtetutës dhe se është bërë publik çdo moment i jetës së tij private, duke dhënë hollësi personale, familjare, financiare, raporte me publikun dhe persona të veçantë. Janë publikuar numra llogarish bankare apo shifra e situata konkrete dhe se nuk është marrë asnjë masë për ndreqjen apo fshirjen e të dhënave të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.*

20.1 Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje se neni A i Aneksit të Kushtetutës, në funksion të procesit të rivlerësimit, parashikon kufizime të të drejtave

¹⁴ Sipas parashikimeve të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës në procesin e rivlerësimit i kalon subjektit të rivlerësimit.

kushtetuese, që lidhen me respektimin e jetës private, si dhe dispozitat që lidhen me barrën e provës¹⁵, sipas kushteve të parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës. Ky nen parashikon vendosjen e kufizimeve të të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, mes të tjerash për një interes publik¹⁶, për të cilin Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “[...] Gjykata vëren se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret, ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë [...]”.

20.2 Nga kontrolli i procedurës së Komisionit në rastin konkret, në raport me dispozitat e mësipërme, trupi gjykues nuk konstaton shkelje të dispozitave mbi barrën e provës e as tejkalim të kufizimit të së drejtës së privatësisë familjare gjatë hetimit administrativ. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është njohur dhe u ka kthyer përgjigje tri pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, është njohur me barrën e provës të dërguar nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, në përgjigje të së cilës ka dorëzuar dy herë prapësime dhe prova, fillimisht në datën 23.08.2021 e më pas më 03.09.2021. Së fundi, subjekti i rivlerësimit është dëgjuar në seancë dëgjimore mbi pretendimet e tij lidhur me procesin e rivlerësimit. Ndonëse në momentin kur subjektet e rivlerësimit kanë plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, kanë pranuar edhe kufizimet e të drejtave të parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vëren se në asnjë prej fazave të hetimit administrativ nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ngritur pretendime për tejkalim të kufizimit të së drejtës së privatësisë së tij apo personave të lidhur. Nga ana tjetër nga vëzhgimi i komunikimit të Komisionit, pyetjeve, kërkimeve apo barrës së provës dërguar subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren re se ato kanë qenë në funksion të përcaktimit sa më të qartë të përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në raport me pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* apo çështjet penale të trajtuara prej tij, dhe se sa ato janë të ndikuara prej ushtrimit të funksionit të tij si prokuror.

20.3 Në vijim të analizimit të pretendimeve të mësipërme, nga verifikimi i vendimit të publikuar¹⁷ në faqen e zyrtare të Komisionit, trupi gjykues, në një vështrim të përgjithshëm, vëren se ky vendim paraqitet i anonimizuar, por në kushtet kur subjekti nuk përcakton të dhënën konkrete, e cila ka mbetur e paanonimizuar, bëhet i pamundur kontrolli i saj. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se publikimi dhe anonimizimi i vendimit janë çështje që i përkasin veprimtarisë administrative të Komisionit, bazuar në nenin 49, pika 5¹⁸ e ligjit nr. 84/2016. Në

¹⁵ Neni A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 12, 131, nënparagrafi “f”, 135, 13, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës [...]”.

¹⁶ Sipas nenit 17 të Kushtetutës: “[...] 1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

¹⁷ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim-Lorenc-Merkuri.pdf>

¹⁸ Në nenin 49, pika 5 përcaktohet: “5. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave, sipas këtij neni, u nënshtrohen rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni ose Kolegji

mbështetje të parashikimi të kësaj dispozite, si dhe të nenit 16¹⁹ të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se shqyrtimi i këtij pretendimi del jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Kolegjit.

20.4 Sa i takon pretendimit në lidhje me cenimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, ndonëse subjekti i rivlerësimit nuk referon konkretisht se me cilin konkluzion a veprim të Komisionit e lidh këtë pretendim, të drejtën konkrete që supozohet të jetë shkelur, apo pasojën e ardhur nga kjo shkelje, trupi gjykues vëren se gjatë hetimit administrativ ai ka mbajtur një qëndrim aktiv, duke i vënë në dispozicion Komisionit dokumentacionin e nevojshëm për të justifikuar krijimin e pasurisë nga ana e prindërve të bashkëshortes të cilët jetojnë në ShBA, si një detyrim që buron nga kuadri kushtetues dhe ligjor i procesit të rivlerësimit. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit në rastin konkret është kryer brenda kufijve të përcaktuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, pa tejkaluar në asnjë rast qëllimin e tyre.

21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *vendimi i Komisionit nga ana formale është në kundërshtim me formën e vendimit që përcakton ligji*. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtrohen argumentet si vijojnë: *në pjesën hyrëse të vendimit nuk përfshihet mendimi i vetë subjektit të rivlerësimit, siç parashikon neni 57, pika 3, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016; në pjesën përshkruese arsyetuese, nuk veçohet mendimi i relatorit; pretendimet e subjektit të rivlerësimit shprehen aty këtu në mënyrë të vakët dhe nuk ka arsyetim për rrëzimin e tyre, por një përshkrim kalimtar me bazë ligjore që nuk përputhet me situatën; baza ligjore dhe arsyetimi janë të mangët dhe të paplotë; ka rrethana e përshkrime fiktive, konstatime të pavërteta dhe prova të treguara në mënyrë të gabuar; ka kundërshti mes pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese; shpallja e vendimit është shtyrë në seancën tjetër pa motiv; në vendim nuk flitet në asnjë pjesë dhe duket se nuk ekziston asnjë dijeni, komunikim apo opinion nga përfaqësues të ONM-së dhe nga ana tjetër përfshihet si pjesë e përbashkët e vendimit për shkarkimin.*

21.1 Në analizë të pretendimeve të mësipërme, nga verifikimi i vendimit të Komisionit, në raport me përcaktimet e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se ai përmban elementët thelbësorë të një vendimi, si bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ, si dhe caktimin e masës disiplinore. Mungesa e mendimit të subjektit të rivlerësimit në pjesën hyrëse të vendimit, megjithëse është ndër elementët e detyrueshëm sipas nenit 57, pika 3, në kushtet kur kjo pjesë përmban të gjithë elementët e tjerë thelbësorë të tij, në vlerësimin e trupit gjykues nuk ngrihet në atë nivel sa të bëjë të cenueshëm vendimin e Komisionit nga pikëpamja e formës. Në pjesën përshkruese-arsyetuese përshkruhen rrethanat e çështjes, analiza e provave dhe baza ligjore mbi të cilën bazohet vendimi, duke u cituar shprehimisht se trupi gjykues ka konkluduar në vendimmarrje, pasi është njohur me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, si dhe shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti i

i Apelit merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në format elektronik, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale”.

¹⁹ Sipas këtij neni: “Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë”.

rivlerësimit. Pjesa urdhëruese, paraqitet e plotë me të gjithë elementët e parashikuar, që janë vendimmarrja e trupit gjykues, masa disiplinore e dhënë, e drejta e ankimit dhe afati i paraqitjes së saj. Nga pikëpamja formale nuk rezulton të ketë kundërshti mes pjesës arsytuese dhe asaj urdhëruese, për sa kohë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit ka ardhur si pasojë e konkluzioneve të Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e situatave të parashikuara nga neni 61, pikat 3, 4 dhe 5, raste të cilat çojnë në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Sa i takon kërkesave të subjektit të rivlerësimit, pasqyrimi i tyre nuk përbën një ndër elementët e detyrueshëm të vendimit, sipas nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, por detyrimi i Komisionit lidhur me to është që refuzimi i tyre të bëhet me vendim të arsyetuar, duke argumentuar shkaqet e refuzimit, sipas nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016.

21.2 Në përmbajtje të vendimit, në analizën e gjetjeve që lidhen me të tria kriteret e vlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni i është referuar edhe qëndrimin apo shpjegimit të dhënë prej subjektit të rivlerësimit si gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve, ashtu dhe në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës, të cilat janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në vendim. Nga kjo pikëpamje vlerësohet se vendimi i Komisionit është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese²⁰ dhe të GjEDNj-së²¹. Nga ana tjetër, fakti që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me atë të subjektit të rivlerësimit nuk mund të kuptohet si mohim i së drejtës për t'u dëgjuar e për të sjellë prova, por si ushtrim prej Komisionit i attributeve të tij analizuuese e vlerësuese, mbi çështje që shtrohen për diskutim përgjatë procedurës administrative të rivlerësimit, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative²². Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se vendimi nr. 450, datë 22.09.2021, i Komisionit, përgjithësisht ka në përmbajtje të tij elementët thelbësorë, sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkaq sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit *për mospërdorimin e dispozitave ligjore respektive për cilësimin ligjor të situatave të ndryshme faktike, prova të interpretuara gabim apo paraqitje rrethanash jo të vërteta*, megjithëse në këtë pikë të ankimit, subjekti i rivlerësimit nuk referon ndonjë situatë konkrete, trupi gjykues vlerëson se situata të tilla nuk e bëjnë vendimin e Komisionit të cenueshëm, por mund të korrigjohen e ndreqen nga Kolegji, sipas nenit 57, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në të tilla kushte, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të marrin përgjigje përgjatë këtij vendimi nga qëndrimi i trupit gjykues lidhur me çështjet e ngritura në nivelin e shkaqeve të ankimit.

21.3 Në vijim, referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 21.09.2021, trupi gjykues konstaton se në fund të saj kryesuesi i trupit gjykues është shprehur se [...] *trupi gjykues tërhiqet për vendimmarrje. Seanca rifillon më datë 22.09.2021, në orën 14:00, në këtë sallë*. Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo procedurë e Komisionit është në përputhje me përcaktimet e nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore. Në këtë kuptim, ndërprerja e seancës dëgjimore nuk do të nënkuptojë

²⁰ *Vendimet nr. 12, datë 19.03.2015 dhe nr. 26, datë 27.03.2017, të Gjykatës Kushtetuese.*

²¹ *GjEDNj-ja në çështjen Garcia Ruiz v. Spain, 1999 është shprehur se neni 6/1 i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, por kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument.*

²² *Në nenin 81 përcaktohet: "Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat akte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatit tërësor të hetimit administrativ".*

përfundimin e saj, pasi trupi gjykues është tërhequr për të marrë vendim dhe kjo seancë konsiderohet e përfunduar më datë 22.09.2021, kur është shpallur vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, për pasojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për shtyrje të seancës pa motiv, nuk qëndron. Ndërkaq, referuar dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues sjell në vëmendje se vëzhguesi ndërkombëtar është i pranishëm në bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit, por ai nuk ka të drejtë vote. Trupi gjykues konstaton se vëzhguesi ndërkombëtar ka qenë i pranishëm në seancë dëgjimore dhe në dhomë këshillimi gjatë marrjes së vendimit, vërtetuar prezenca e tij në këtë moment nga nënshkrimi i procesverbalit të vendimmarrjes së Komisionit të datës 22.09.2021, por vetëm nëse ai do të kishte një mendim ndryshe ose paralel, sipas nenit 55 pika 5, atëherë ky mendim do t'i bashkohej vendimit të Komisionit dhe do të ishte pjesë përbërëse e tij.

22. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *procesi ka cenuar haptazi barazinë para ligjit duke manifestuar diskriminim ndaj subjektit të rivlerësimit në statusin e prokurorit dhe duke u shfaqur inkuizitiv. Këtë pretendim subjekti i rivlerësimit e lidh me cenimin e një sërë të drejtash si e drejta e informimit, e drejta e aksesit në dosje, publikimi i të dhënave personale e familjare, si dhe me një mungesën e përgjigjeve të Komisionit ndaj tij, konstatime të pavërteta në vendim, tendencë për rëndimin e pozitës, vendim i parregullt apo pozita të pamundura për t'u mbrojtur.* Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit, referuar kronologjisë së zhvillimit të procesit të rivlerësimit, pa rënë në përsëritje me sa parashtuar më lart në këtë vendim, konstaton se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor përfshirë edhe aspektet e parimit të barazisë, kontradiktorialitetit, proporcionalitetit dhe ligjshmërisë. Komisioni ka zhvilluar procesin e mbledhjes, verifikimit, analizës dhe shqyrtimit për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, përgjatë periudhës nëntor 2019 – shtator 2021, në të cilën rezultoi që ndërmjet tij dhe Komisionit të ketë pasur komunikim të rregullt, ai është pyetur, i është dhënë e drejta të njohë aktet, ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes duke dhënë shpjegime e paraqitur prova e, së fundi, është dëgjuar në seancë dëgjimore. Tërësia e këtyre fakteve, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk e mbështet pretendimin e subjektit të rivlerësimit për një proces diskriminues dhe qëllimisht rëndues.
23. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni nuk ka arsyetuar, përse shkeljet janë të tilla që janë vendimtare dhe ai nuk mund të konfirmojë por është shkarkuar, si dhe përse nuk mund të aplikojë pezullimi nga detyra për një vit, i shoqëruar me edukim të detyrueshëm dhe cilat ishin mangësitë që nuk mund të korrigjoheshin.* Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, Kolegji ka në tagrin e tij mundësinë për të disponuar edhe me lloje të tjera vendimi përveç atyre që shprehen në mënyrë eksplicite në ligjin nr. 84/2016, duke kërkuar që në rastin e tij të mbajë në konsideratë edhe pretendimin për shpalljen të pavlefshëm të vendimit nr. 450, datë 22.09.2021 dhe hetimin administrativ të Komisionit apo pushimin e çështjes për shkak të pamundësisë së shqyrtimit të çështjes ose pezullimin e procesit të rivlerësimit deri në plotësimin e kuadrit ligjor.

23.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar arsytimit të vendimit, vëren se subjekti i rivlerësimit ka probleme me saktësinë e deklaramit në deklaratën pasurisë *vetting*, të cilat e kanë vendosur atë në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me probleme në aftësitë profesionale, për shkak të gabimeve të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që e vendosin

atë në kushtet e nenit 61, pika 4. Përveç këtyre, nga Komisioni janë konsideruar si veprime që cenojnë besimin e publikut, veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, për futjen në territorin shqiptar të një automjeti, si dhe disa veprime e mosveprime të tij, në kuadër të hetimeve të disa procedimeve penale të marra e të shqyrtuara nga Komisioni, në funksion të kontrollit të figurës, problematika të cilat janë kualifikuar, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Në rastin konkret, masa disiplinore e dhënë subjektit të rivlerësimit lidhet, jo vetëm me faktin se ai është gjetur i papërshtatshëm në dy prej kriterëve, atë të vlerësimit të pasurisë dhe aftësive profesionale, por dhe për shkak të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Nga ana tjetër, masa disiplinore e pezullimit nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit, e parashikuar nga neni 60 i ligjit nr. 84/2016, i jepet subjekteve të rivlerësimit nëse evidentohen mangësi në aftësitë profesionale, të cilat janë të atilla që mund të plotësohen, por jo në rast se subjekti përveç këtyre mangësive nuk arrin as ndonjë nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë e, më pak akoma, kur atij i është atribuar cenimi i besimit të publikut.

23.2 Sa i takon kërkimit të subjektit të rivlerësimit mbi disponimin nga ana e Kolegjit edhe me lloje të tjera vendimi, përfshirë këtu edhe shpalljen e pavlefshëm të vendimit të Komisionit, nga leximi i ankimit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk argumenton se si dhe mbi çfarë baze e lidh kërkimin e tij për pavlefshmëri të vendimit të Komisionit me ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 108²³ i Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk argumenton në vijim, nuk specifikon bazën ligjore e as parashtron ndonjë rrethanë në lidhje me kërkimin e tij për pushimin e çështjes, për shkak të pamundësisë së shqyrtimit ose pezullimit e procesit deri në plotësimin e kuadrit ligjor, duke i lënë pretendimet e tij në nivel të përgjithshëm.

24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *në proces nuk janë interpretuar drejt përkufizimet e ligjit lidhur me termat “kontakt i papërshtatshëm”, “marrëdhënie biznesi”, “pasuri”, “periudha e rivlerësimit”, “person i përfshirë në krimin e organizuar” dhe “të ardhura të ligjshme”. Subjekti i rivlerësimit ka shprehur kundërshtitë e tij edhe për një sërë dispozitash të ligjit nr. 84/2016, konkretisht nenin 65, lidhur me procesin gjyqësor në Kolegj, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, si dhe nenin 68, lidhur me marrëdhëniet kalimtare mes institucioneve, që sipas tij paraqet kontradikta. Në shqyrtim të këtij pretendimi, referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me terminologjinë e paqartë të përdorur në ligjin nr. 84/2016, ku citohet: [...] është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë [...], trupi gjykues vlerëson se përdorimi nga Komisioni i koncepteve*

²³ Neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: (a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: (i) kompetencën e organit publik; (ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose (iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; (c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; (ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”.

të sipërcituara dhe kuptimi i dhënë atyre në vendim janë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e rivlerësimit të cilit i përket. Për rrjedhojë, vetëm fakti i përdorimit të këtyre togfjalëshave në vendimin e Komisionit, pa vlerësuar kontekstin në të cilin kanë gjetur përdorim, si dhe kuptimin që i ka dhënë Komisioni nëpërmjet arsytimit të tij, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk është i mjaftueshëm për t'u ngritur në nivelin e një shkaku ligjor, që mund të cenojë vlefshmërinë e vendimit të Komisionit. Trupi gjykues i Kolegjit sjell, gjithashtu, në vëmendje se dispozitat e ligjit nr. 84/2016 i janë nënshtruar analizës së kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, e cila gjatë kontrollit të ushtruar prej saj, në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit.

25. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për shkelje të rënda procedurale dhe për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, u gjetën të pabazuara në fakte e në ligj. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve
26. Kërkesa e subjektit për marrjen në cilësinë e provës së akteve të paraqitura bashkëlidhur ankimit u analizua nga trupi gjykues në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin në shkallë të dytë, konkretisht sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Nga analizimi i këtyre akteve shpresore, trupi gjykues vëren se:

- *5 (pesë) kontratat e kredisë të lidhura mes Bankës Societe Generale Albania ShA, përfaqësuar nga drejtoresha e degës Sarandë, znj. E. M.*, janë paraqitur në funksion të shkakut të ankimit të pasqyruar në paragrafin 35 të vendimit, me qëllim vërtetimin e faktit se bashkëshortja e subjektit ka qenë në Shqipëri, në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së banesës në bashkëpronësi me dy prindërit e saj, më 19.01.2011. Në kushtet kur fakti që kërkohet të provohet rezulton i evidentuar gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nga ana e subjektit nuk është paraqitur ndonjë argument apo arsye mbi pamundësinë e paraqitjes së këtyre akteve në Komision, jo për faj të tij, vlerësohet se ato nuk mund të pranohen në cilësinë e provës në këtë fazë të procesit, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Pavarësisht mosplotësimit të këtij kriteri formal, edhe nëse do të konsideroheshin me vlerë të plotë provuese, fakti që kërkohet të provohet rezulton i provuar nga Komisioni, pasi në ndryshim nga rezultatet e hetimit administrativ, në vendim nuk shprehet për mungesën e bashkëshortes në Shqipëri në datën e lidhjes së kontratës. Në këto kushte, marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës vlerësohet e panevojshme edhe sipas nenit 49, pika 6, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

- *Aktet mbi leje drejtimi automjeti të z. Th. M.*, janë paraqitur me qëllim vërtetimin e faktit që babai i subjektit ka disponuar leje drejtimi që në vitin 1967, në funksion të shkakut të ankimit të pasqyruar në paragrafin 57 të vendimit, në kundërshtim të konstatimit të Komisionit në

vendim²⁴ se ky shtetas nuk dispononte leje drejtimi për automjet. Në kushtet kur fakti që kërkohet të provohet nuk i është bërë i njohur subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, por vetëm në vendim, vlerësohet se përmbush kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Pavarësisht plotësisht të këtij kriteri, trupi gjykues vëren se lidhur me faktin që kërkohet të provohet Komisioni nuk i ka atribuar subjektit të rivlerësimit ndonjë pasojë ligjore lidhur me ligjshmërinë e pasurisë *garazh me sipërfaqe 23,8 m²*, duke qenë pa ndikim në masën disiplinore. Për këto arsye, marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës vlerësohet se nuk ndikon në marrjen e vendimit, sipas nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

27. Në konkluzion të analizës së mësipërme, nga kontrolli i zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit në fashikullin e administruar gjatë hetimit administrativ, nuk u konstatuan shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve, siç ka pretenduar subjekti në ankim. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, çmohet shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni ka administruar raportin e ILDKPKI-së, jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me ligjin dhe nuk ka vendim të arsyetuar për vazhdimin e procesit të rivlerësimit në aspektin e kriterit të pasurisë, tej atij të kryer nga ILDKPKI-ja*. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar nenit 33, pika 4²⁵ e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se afati 180 ditë i parashikuar në këtë dispozitë është një afat orientues, me synim strukturimin e procesit të rivlerësimit që kryen Komisioni, për ta nxitur këtë të fundit për fillimin e punës në një kohë sa më të afërt nga hyrja në fuqi e ligjit. Kryerja e kontrollit dhe dërgimi i raportit që i përket subjektit të rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, pas këtij afati, duke nisur nga data e plotësisht të deklaratës së pasurisë prej subjektit²⁶, nuk rezulton të ketë ndikuar në përmbajtjen e këtij akti, vlerësimin tërësor të kontrollit të pasurisë, ushtrimin e ndonjë të drejte të subjektit në proces dhe, për më tepër, nuk rezulton të ketë kushtëzuar në ndonjë lloj forme hetimin administrativ të kryer nga Komisioni, i cili është një hetim i pavarur në të gjitha aspektet²⁷. Nga ana tjetër, në asnjë rast dispozitat kushtetuese dhe ligjore, të cilat autorizojnë drejtpërdrejt Komisionin për të kryer hetime të pavarura nga ato të organeve ndihmëse, nuk e ngarkojnë atë me ndonjë detyrim për t’u shprehur me vendimmarrje për vazhdimin e hetimeve për kryerjen e procesit të rivlerësimit.
29. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni nuk ka mbajtur parasysh problemet me deklaratimet ndër vite, kohën e shkurtër për dokumentacionin dhe ngarkesat në kohën e përpilimit të deklaratës vetting, por edhe procesin e ri për shkak të indiferencës,*

²⁴ Në paragrafin 138 të vendimit, Komisioni shprehet se: [...] babai i subjektit, referuar hetimit administrativ, nuk dispononte leje drejtimi për automjet.

²⁵ Në nenin 33, pika 4 parashikohet se ILDKPKI-ja kryen një procedurë të plotë kontrolli sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e depozitimit të deklaratës së pasurisë.

²⁶ Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë vetting pranë ILDKPKI-së në datën 30.01.2017.

²⁷ Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese shprehet se organet e rivlerësimit nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.

*aprofesionalizmit të ILDKPKI-së që manifestoi paqartësi për deklaratën vetting, kur nga ana tjetër nuk ka proceduar në kohë për saktësimin e deklaratave vjetore dhe kur në konstatimet e vitit 2016 nuk kishte nxjerrë problematika. Nuk ka asnjë konstatim, kërkesë, njoftim, vlerësim apo vendim nga ILDKPKI, KPK apo ONM nëse subjekti ndodhet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive të tij. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje se ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, që nga momenti i hyrjes në fuqi të tij, ka përcaktuar përgjegjësinë ligjore për subjektet e deklarimit dhe personat e lidhur me ta, si dhe sanksionet përkatëse, në rast të mosplotësimit me vërtetësi të deklaratës së pasurisë. Fakti nëse ILDKPKI-ja ka kryer apo jo kontrole të plota lidhur me pasurinë e subjektit dhe se nuk ka nisur ndonjë procedurë administrative apo ndonjë procedim penal, për problematika në lidhje me deklarimet e pasurisë dhe interesave privatë të tij, vlerësohet si pa relevancë në vlerësimin e organeve të rivlerësimit. Edhe pretendimi për paqartësi në plotësimin e deklaratës së pasurisë *vetting*, nga trupi gjykues vlerësohet i pabazuar, për sa kohë për t’i ardhur, pikërisht, në ndihmë subjekteve të rivlerësimit në plotësimin e saj, ILDKPKI-ja ka miratuar udhëzimin nr. 4095 prot., datë 10.10.2016. Po aq të pabazuara vlerësohen edhe pretendimet se Komisioni nuk ka marrë parasysh kohën e shkurtër të paraqitjes së dokumentacionit shoqërues të deklaratës së pasurisë apo ngarkesat në plotësimin e saj, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha mundësitë, që në një hark kohor prej 22 muaj e 9 ditë të procesit të tij, të paraqesë të gjitha dokumentet, të cilat ishte në pamundësi kohore apo nën ngarkesë për t’i paraqitur bashkëlidhur deklaratës *vetting*. Nga ana tjetër, mungesa e detyrimit ligjor për të ruajtur dokumentacion dhe kalimi i afateve të ruajtjes së tyre nga arkivat është një situatë e cila është mbajtur parasysh dhe është parashikuar nga ligjvënësi në miratimin e ligjit nr. 84/2016, konkretisht në nenin 32, pika 2, duke përcaktuar se në këto raste subjektit i lind detyrimi që t’i vërtetojë organeve të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër ose t’i vërtetojë së paku përpjekjet e bëra në këtë drejtim. Nga tërësia e dokumentacionit të hetimit administrativ, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit në ndonjë fazë të procesit, sipas kërkesave të dispozitës së mësipërme, të ketë vërtetuar se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër ose të ketë vërtetuar së paku përpjekjet e tij në këtë drejtim.*

30. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *deklaratat e pasurisë ndër vite shërbejnë si prova për të konkluduar mbi vërtetësinë e deklaratës së pasurisë vetting, por nuk janë objekt shqyrtimi se si janë apo se si duheshin bërë. Komisioni dhe ILDKPKI nuk kanë marrë parasysh se në një periudhë kohe të caktuar ai ishte oficer i policisë gjyqësore dhe jo prokuror, nuk kryente deklarime dhe nuk kishte detyrime të lidhura me to. Në vlerësimin e trupit gjykues, ndonëse neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 u ka njohur deklaratave periodike të pasurisë vlerën e provës, ky ligj kurrësi nuk ka si qëllim zhbërjen e legjislacionit në fuqi për deklarimin e kontrollin e pasurive, por përkundrazi synon realizimin e kontrollit mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke ndjekur vazhdimësinë e deklarimeve të mëparshme të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, për të përcaktuar përgjegjësinë e tij në raport me deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas ligjit nr. 84/2016. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar pranë ILDKPKI-së dy deklarata në funksionin e oficerit të policisë gjyqësore, deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie e vitit 2003 dhe*

deklaratën periodike vjetore për vitin 2004. Ndonëse nuk rezulton që Komisioni t'i ketë atribuar subjektit të rivlerësimit ndonjë shkelje lidhur me mosdeklarimin e tij në funksionin e OPGj-së, trupi gjykues vëren se me të drejtë gjatë kontrollit të deklarimeve të bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*, sikurse çdo të dhëne që rezulton nga hetimi, Komisioni iu është referuar edhe deklaratave të tij të dorëzuara në funksionin e oficerit të policisë gjyqësore, duke i analizuar së bashku me të gjitha të dhënat e përfutuara. Argumenti se ai në funksionin e OPGj-së asokohe nuk ka pasur detyrimin për deklarim nuk mund të prezumojë faktin se pasuria nën verifikim nuk ka ekzistuar.

31. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deklaratat noteriale të paraqitura prej tij, të cilat përputhen me realitetin, ashtu si në fakt ka vepruar me disa subjekte tashmë të konfirmuara në detyrë, e nëse kishte dyshime duhet të thërriste bërësit e tyre. Komisioni ka mbajtur standarde të ndryshme në vlerësimin e pasaktësive, ku shpesh pasaktësi më serioze nuk janë vlerësuar me ndikim në vendimmarrje.* Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues sjell në vëmendje se çështja që lidhet me fuqinë e provuesë të deklaratave noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit²⁸ ka gjetur trajtim të gjerë në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës deklaratat noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, nëpërmjet të cilave kërkohet të provohen apo vërtetohen deklarime të vetë subjektit, pavarësisht vlerës ligjore nga pikëpamja formale, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, përbëjnë akte me vlerë të kufizuar nëse nuk mbështeten nga akte të tjera të administruara gjatë hetimit administrativ dhe janë vlerësuar si përpjekje për të justifikuar deklaratimet e subjektit gjatë procesit. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, atë për standarde të ndryshme të Komisionit, referuar jurisprudencës së Kolegjit, pretendime të tilla të subjekteve të rivlerësimit nuk mund të përbëjnë *apriori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e rrethanave faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit sipas situatës konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni.
32. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *është e papranueshme se si Komisioni nuk paraqet një analizë me tregues financiarë konkretë dhe nga ana tjetër konsideron probleme me qarkullimin monetar.* Sipas tij, *Komisioni nuk ka një qëndrim në përputhje me ligjin lidhur me vlerësimin në tërësi të pasurisë, aq më tepër për personat e lidhur.* Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, referuar përmbajtjes së vendimit përfundimtar, trupi gjykues vëren se Komisioni, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka arritur në konkluzionin se [...] *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.* Në këtë konkluzion është arritur pa u kryer një analizë financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, si dhe personave të tjerë të lidhur, për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë

²⁸(i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2019, të deklaruesve F. G., E. M.; (ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2019, të deklaruesve I. G., F. G., E. M.; (iii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.12.2019, F. M.; (iv) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.12.2019, të I. G., E. M.; (v) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.01.2020, të deklaruesit E. D.; (vi) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.07.2021, të T. M.; (vii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.07.2021, të deklaruesit I. G.; (viii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2021, të M. N.

vetting. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në pretendimet e tij në ankim, ka kundërshtuar përfundimin e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme financiare në krijimin e pasurive në pronësi të tij, vlerësohet që këto pretendime do të marrin përgjigje përgjatë arsyetimit të këtij vendimi, në trajtimin e shkakut të ankimit respektiv.

Apartament banimi me sipërfaqe 69,30 m², në zonën {}***

33. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“Për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë arsyen se përse u hartua dhe u nënshkrua kontrata në emër të prindërve të bashkëshortes së saj, për 2/3 pjesë të pasurisë, kur nuk ishin prezentë në Shqipëri, dhe nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit të tij, përpjekja e subjektit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave që lidheshin me krijimin e kësaj pasurie, në vlerësimin e trupit gjykues bëjnë që të ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016”.*
34. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, veç sa më sipër, ndonëse arsyeton²⁹ se sjellja e subjektit në raport me këtë pasuri, në këndvështrimin e një vëzhguesi objektiv, cenon besimin e publikut te drejtësia, në konkluzionin e tij nuk i atribuon pasojën ligjore që i përgjigjet kësaj situatë që është neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk e ka konsideruar në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
35. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se konkluzionet e Komisionit janë të gabuara, jologjike dhe subjektive, pasi nuk ka asnjë sjellje specifike nga ana e tij që të manifestojë ndonjë qëllim për të pasqyruar fakte jo të vërteta apo të ndryshme, aq më tepër për të kryer deklaramit të rremë apo për të tentuar fshehjen e pasurisë. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet si vijojnë: (i) Komisioni e bën përgjegjës për sjellje të prindërve të bashkëshortes, madje për sjellje të ligjshme të tyre, me qëllim që të konkludojë me çdo kusht që pasuria është e familjes së tij, që nuk përbën një sjellje normale gjyqësore; (ii) Komisioni tejkalon logjikën kur konstaton se vjehrra dhe vjehrra nuk justifikojnë pasurinën, ndërkohë që kishte në dispozicion gjithë dokumentacionin ligjor të mundshëm, përfshirë atë me vullë “Apostille” mbi të ardhurat nga puna e tyre në ShBA, të cilin nuk e konsideroi në kundërshtim me ligjin; (iii) Komisioni vlerëson në mënyrë tendencioze dhe arbitrare se në kufi duheshin deklaruar edhe shuma nën nivelin që detyron ligji, pasi askush që ka mundësi t'i sjellë paratë vetë ose me të tjerë, për shuma nën 1.000.000 lekë ose 10.000 USD, nuk ka arsye dhe nuk mund të jetë i detyruar të paguajë në banka apo transferta, për më tepër që pagesat cash lejoheshin nga ligji dhe janë bërë me këste.
36. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe kontrolloi arsyetimin e vendimit në drejtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

36.1 Në deklaratë e pasurisë së personit të lidhur pjesë e deklaratës së pasurisë vetting, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *“Apartament banimi, 69,30 m², zona {***}, rr. “{***}”, z. k. {***}, pasuria nr. {***}, kati {***}-të, ap. {***}, blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2011, prej subjektit “{***}” ShPK. Unë E. M., jam*

²⁹ Shih paragrafin 76 të vendimit të Komisionit.

*përfshirë në bashkëpronësi të këtij apartamenti në 1/3 pjesë ideale me dy prindërit e mi, pa asnjë kontribut timin personal. Me burim krijimi të ardhurat e krijuara nga shitja e banesës së mëparshme në pronësi të familjarëve të mi K. M., D. M., dhe B. M., me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2007, në vlerën 2.000.000 lekë dhe të ardhurat e siguruara prej tyre në ShBA. Vlera: 3.118.500 lekë. Pjesa takuese: 33.33%”.*

36.2 Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2011, në të cilën citohet se kjo kontratë është e lidhur përpara noterit Th. K., mes palës shitëse shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga M. N.,³⁰ dhe palës blerëse K. M., D. M., dhe E. M., me vlerë të përgjithshme 3.118.500 lekë, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale (pa përcaktuar kohën e shlyerjes) dhe pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Sarandë, në bashkëpronësi të blerësve me 1/3 pjesë takuese³¹.

36.3 Në deklaratë e interesave private të pjesëtarëve të familjes që mbartin detyrim për deklaram, pjesë e deklaratës para fillimit të detyrës së vitit 2012 të subjektit të rivlerësimit³², bashkëshortja e tij ka deklaruar: “*Apartament në bashkëpronësi me prindërit e mi K., e D. M., me sip 69,30 m², me nr. {***}, në z. k. {***}, e ndodhur në qytetin Sarandë, zona {***}. Apartamenti nr. {***}, kati i {***}-të. Regjistri hipotekor nr. {***}, Nr. {***} ind, datë 01.02.2011. Pjesa takuese: 33%”.* Kjo pasuri është deklaruar edhe në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të këtij deklarimi, duke deklaruar: “*Vlera totale e paguar nga prindërit”.*

36.4 Në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 12.04.2016³³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “*Prindërit e bashkëshortes kanë pasur një apartament me burim privatizimin në qytetin e Sarandës. Ky apartament u shit dhe me shumën e përfituar nga shitja u ble një apartament i ri në zonën {***}. Kur do të kryhej regjistrimi prindërit e bashkëshortes ishin emigrantë në USA. Për efekt procedurash ata kanë përfshirë që në momentin e regjistrimit bashkëshorten. Sqaroj se bashkëshortja nuk ka investuar në vlerë blerje. Bashkëpronësia është bërë me marrëveshje ndërmjet prindërve dhe për arsye të përfitimit të pjesës takuese si trashëgimtare ligjore në të ardhmen [...]”.*

36.5 Nga dokumentacioni i përcjellë nga AShK Sarandë³⁴, rezulton se pas aplikimit për regjistrim të datës 18.05.2011 nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të E. M., dhe K., e D. M. Nga informacioni i përcjellë nga OShEE ShA³⁵ nuk konfirmohet kontratë furnizimi me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes apo prindërve të saj.

36.6 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi rrethanat e blerjes së këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar³⁶ se [...] *nuk kam dijeni të hollësishme mbi veprimet e vjehrrit, vjehrrës dhe bashkëshortes time lidhur me këtë pasuri, por nga sa i kam pyetur ata aktualisht*

³⁰ Përmes prokurës së përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.10.2010, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. V. Ll., ka emëruar përfaqësues të përgjithshëm, z. M. N.

³¹ Shih vërtetim nga dokumentet hipotekor të datës 01.02.2011 dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 30.11.2016, e ZVRPP-së Sarandë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

³² Kjo deklaratë është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 04.06.2012, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë.

³³ Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive të datës 12.04.2016.

³⁴ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 17.01.2020, nga AShK Sarandë dhe shkresë nr. {***} prot., datë 03.10.2017, e ZVRPP-së Sarandë drejtuar ZQRPP-së Sarandë.

³⁵ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 30.12.2019.

³⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe sqarimeve plotësuese të tij.

më kanë informuar se blerja e këtij apartamenti është kryer pas shitjes së banesës së tyre të vjetër [...]. Arsyeja e blerjes së kësaj pasurie ka qenë dëshira e tyre për të përmirësuar kushtet e banimit në një pallat të ri dhe në një pozicion më të favorshëm në qytetin e Sarandës në raport me banesën që kanë pasur më parë. Apartamenti është blerë në kushtet e bashkëpronësisë për shkak të marrëdhënies së posaçme prindër-fëmijë. [...] Vjehri dhe vjehrra ime janë shtetas amerikanë që prej vitit 2012 (emigruar në vitin 2006 me Green Card) dhe pjesën më të madhe të kohës jetojnë në ShBA në një apartament të marrë me qira (jo në pronësi).

36.7 I pyetur më tej mbi mënyrën dhe kohën e pagimit të çmimit të blerjes të shoqëria “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar³⁷ se për shkak të njohjes me përfaqësuesin e shoqërisë ndërtuese, z. M. N., vjehri i ka mbajtur vetë kontaktet me shitësin, si në Shqipëri ashtu edhe në ShBA. Sipas tij, pagesa është kryer pjesë-pjesë nga viti 2007 e në vijim, sipas fazave të avancimit të punimeve ndërtimore, herë nga vetë vjehri kur ka ardhur në Shqipëri e herë nga vajza e tyre, e cila kishte derdhur në llogarinë e saj në ProCredit Bank ShA një pjesë të kursimeve të prindërve ndër vite, si dhe të ardhurat e buruara nga shitja e apartamentit në vitin 2007. Pagesat kanë qenë cash dhe në asnjë rast me transfera në llogaritë bankare të shitësit. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2021, të përfaqësuesit të shoqërisë, M. N.; (ii) prokurë e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.01.2014, përmes së cilës E. M., emërohet përfaqësuese e posaçme e babait të saj, K. M³⁸.

36.8 Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës, pasi duket se: (i) është përpjekur të fshehtë këtë pasuri; (ii) ka bërë deklaratë të rremë në vetting dhe gjatë hetimit administrativ lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie; (iii) me veprimet e mosveprimet e kryera ka cenuar besimin e publikut të sistemit të drejtësisë. Po me këto rezultate, subjektit i është bërë i njohur edhe konstatimi se nga verifikimi në sistemin TIMS nuk rezulton që shtetasit K. M., dhe D. M., të kenë qenë në Shqipëri në datën 19.01.2011, datë e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe gjithashtu E. M., nuk rezulton të ketë qenë në Shqipëri në datën 19.01.2011 (dalja më 01.09.2010 deri kthimi më 09.06.2011). Në shpjegimet e tij mbi këto rezultate, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ se ka qenë një marrëdhënie e iniciuar nga prindërit e bashkëshortes dhe se ai apo bashkëshortja nuk kanë asnjë kontribut, por ka qenë një tendencë dhurimi nga ana e tyre. Më tej, ai ka deklaruar se: “Nuk është e vërtetë që palët nuk kanë qenë në Shqipëri. Bashkëshortja

³⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe plotësim të përgjigjeve të tij.

³⁸ Sipas kësaj prokure, znj. E. M., i jepen, ndër të tjera, tagrat: Të mbrojtë interesat e mia të ligjshme pasurore dhe pasurinë time të paluajtshme kudo që ndodhet në rast se cenohet nga veprimet e padrejta dhe të paligjshme të personave të tretë fizikë dhe juridikë duke u paraqitur në organet e ndryshme administrative si në Komisaratin e Policisë Sarandë, organin e akuzës apo organet gjyqësore [...]; të paraqitet në organet e ndryshme administrative duke paraqitur kërkesën përkatëse për të marrë dokumente që kanë lidhje me pasurinë time të paluajtshme në Sarandë apo në çdo vend tjetër dhe në rast cenimi të pronësisë dhe çështja është në gjykim gjyqësor të ketë të drejtën të më përfaqësojë në gjykatën e rrethit gjyqësor [...]; të paraqitet pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Sarandë për regjistrimin e pasurive të paluajtshme kudo që ndodhen duke paraqitur dokumentacionin përkatës, duke bërë pagesat përkatëse dhe duke nënshkruar dokumentacionin përkatës që është i nevojshëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme kudo që ndodhen; të kryejë marrëveshje investimi apo kontrata sipërmarrjeje apo bashkëpunimi dhe bashkëpronësisë dhe shkëmbimit, qiraje apo shitje me persona të tretë fizikë apo juridikë privatë apo shtetërorë [...]; të hapë llogari në bankat e ndryshme në Sarandë apo dhe në çdo vend tjetër dhe të ketë të drejtë të kryejë veprime në këto banka duke tërhequr dhe para në emrin dhe llogarinë time apo të shoqërisë nëse ka të tilla në emrin tim. [...].

ime ka qenë në këtë kohë punonjëse në bankë dhe nuk ekzistonte mundësia që bankat në atë kohë (madje dhe sot) të të lejonin të largohesh nga puna për një ditë duke u paguar, jo më për një periudhë 10-mujore. Nuk mund të kujtoj për prindërit e bashkëshortes, por as nuk mund të mendoj që ne apo noteri të bëjmë veprime të tilla dhe nuk kishte arsye pse të ndodhte. Sistemi TIMS është fakt i njohur publik që manifeston shpesh mangësi, probleme, gabime, etj. Shpesh madje nuk ka as shënime për personat që hyjnë e dalin dhe kurrsesi nuk mund të përbëjë provë vendimtare për të konkluduar. Unë pretendoj me siguri që nuk ka ndodhur një gjë e tillë [...]”³⁹.

36.9 Në seancën dëgjimore të datës 21.09.2021 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se [...] e them me bindje absolute, bashkëshortja ime në kohën e lidhjes së asaj kontrate ka qenë këtu, ka firmosur personalisht. Për shkak të kohës që ka kaluar unë nuk kujtoj saktësisht për vjehrrin dhe vjehrrën, por mendoj që kanë qenë dhe ata në mënyrë të padiskutueshme përpara noterit, sepse nuk mund të bënte noteri veprime të tilla dhe nuk kishte arsye në fund të fundit përse do të kryheshin. Nëse do të ishte mungesë e tre blerësve përse do të kryhej ky lloj transaksioni në interes të kujt [...]. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit përcolli në rrugë elektronike shpjegime shtesë mbi udhëtimet e bashkëshortes së tij.

37. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara më sipër, nga kontrolli i arsyetimit në vendim, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin e tij për përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën e ka mbështetur në dy argumente: *së pari*, marrëdhënia e prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me këtë apartament nuk krijon bindjen se ata janë pronarët *de facto* të kësaj pasurie, për shkak të mungesës së prezencës së tyre në Shqipëri në datën 19.01.2011, që është data e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, bazuar në të dhënat mbi hyrje-daljet e tyre nga sistemi TIMS⁴⁰ dhe, *së dyti*, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë burimin e ligjshëm të kësaj pasurie. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se në ndryshim nga rezultatet e hetimit administrativ, në vendim, Komisioni nuk ka mbajtur më qëndrim lidhur me faktin e mungesës së prezencës së bashkëshortes së tij në Shqipëri në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, por vetëm të prindërve të saj.
38. Në drejtim të sa më sipër, bazuar në të dhënat e hyrje-daljeve në sistemin TIMS të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, K., dhe D. M.⁴¹, konfirmohet fakti i evidentuar nga Komisioni se ata nuk kanë qenë në Shqipëri në datën 19.01.2011, kur u lidh e u nënshkrua kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol. Kjo situatë, në vlerësimin e trupit gjykues duket se përforcohet edhe nga disa rrethana të tjera, lidhur me marrëdhënien e prindërve të bashkëshortes me pasurinë objekt shqyrtimi, të tilla si: (i) nuk rezulton e dokumentuar nisja e marrëdhënies me shoqërinë “{***}” ShPK që në vitin 2007, pra 3 (tre) vite përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes në janar të vitit 2011; (ii) nuk provohen përmes ndonjë dokumenti financiar të lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, pagesa të kryera nga K. M.; (iii) nuk rezultuan gjurmë të përdorimit të kësaj pasurie nga prindërit e bashkëshortes, të tilla si mosaplikimi nga

³⁹ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur prapësimeve vërtetim nr. {***} prot., datë 20.08.2021, të OTP Bank ShA, në lidhje me bashkëshorten E. M.

⁴⁰ Në paragrafin 60 të vendimit, Komisioni shprehet se: Nga sistemi TIMS rezultoi e provuar dhe e pakontestuar nga subjekti i rivlerësimit fakti se prindërit e bashkëshortes nuk kanë qenë prezentë në ditën e nënshkrimit të kontratës, pasi rezulton që ata kanë dalë nga territori shqiptar në datën 19.05.2010 dhe kanë rihyrë në datën 18.11.2011, duke rezultuar të mos kenë qenë për një periudhë disa mujore para dhe pas kontratës së nënshkruar prej tyre për blerjen e kësaj pasurie para noterit publik.

⁴¹ Në vitet 2010, 2011 bashkëshortët M., kanë hyrje-daljet si vijojnë: hyrje në territorin shqiptar më datë 30.04.2010 dhe dalje më 19.05.2010; hyrje më datë 18.11.2011 dhe dalje më datë 30.11.2011.

ana e tyre për regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat publikë, kontrata apo pagesa për energjinë edhe ujin në emër të tyre etj.; (iv) nuk rezulton të jetë lëshuar nga K., e D. M., ndonjë prokurë e kohës (2007-2011), që të ketë autorizuar bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit për kryerje në emër të tyre të veprimeve në lidhje me këtë pasuri.

39. Veç sa më sipër, trupi gjykues vëren se, megjithëse Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit që në rezultatet paraprake të hetimit administrativ konstatimin mbi mungesën e prezencës së prindërve të bashkëshortes në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes e bashkë me të edhe dyshimet për fshehje pasurie e deklarim të rremë, rrethana që duhet të kishin tërhequr vëmendje të theksuar të tij, subjekti i rivlerësimit në prapësime dhe në ankim, në ndryshim nga situata e bashkëshortes së tij nuk dha asnjë informacion më tepër dhe nuk paraqiti asnjë dokument provues mbi prezencën e prindërve të saj në Shqipëri në datën 19.01.2011. Nuk rezultojnë përpjekje të subjektit të rivlerësimit as në drejtim të paraqitjes së dokumentacionit financiar të shoqërisë “{***}” ShPK, si për shembull librat e arkës së kësaj shoqërie. Një qëndrim i tillë nga ana e subjektit të rivlerësimit përbën një element që shkon, po ashtu drejt mbështetjes së dyshimit të ngritur nga Komisioni se prindërit e bashkëshortes nuk janë pronarët *de facto* të kësaj pasurie. Megjithatë, për të legjitimuar ekzistencën e këtyre dyshimeve trupi gjykues verifikoi edhe konkluzionin tjetër të Komisionit që subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të pasqyruara në paragrafin 35, më sipër në këtë vendim.

40. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, në drejtim të kundërshtimit si të gabuar të konkluzionit të Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në drejtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

40.1 Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin e tij për mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë e ka mbështetur në argumentet, si vijojnë: (i) nuk është provuar që të ardhurat nga shitblerja e pronës së paluajtshme nga prindërit e bashkëshortes së subjektit në vitin 2007 të jenë përdorur si burim për blerjen e pasurisë në vitin 2011; (ii) nuk provohet me dokumentacion transferimi i shumave të prindërve të bashkëshortes nga ShBA-ja nëpërmjet rrugës bankare apo tokësore.

40.2 Në drejtim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, mbi burimin e krijimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, krahasuar me deklaratimet e mëparshme të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, të cilave neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 u ka njohur fuqinë e provës dhe deklaratimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, konstatoi ekzistencën e mospërputhjeve si vijojnë: (i) në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi: (a) të ardhurat e krijuara nga shitja e banesës së mëparshme në pronësi të familjarëve të saj K. M., D. M., dhe B. M., me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2007, në vlerën 2.000.000 lekë; (b) të ardhurat e siguruar prej tyre në ShBA; (ii) në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2012, nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie, por vetëm fakti që çmimi është paguar nga prindërit; (iii) në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, deklarohen si burim vetëm të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament me sipërfaqe 73 m²; (iv) gjatë hetimit administrativ dhe në prapësime janë deklaruar si burim krijimi edhe kursimet gjendje të prindërve në kohën e blerjes. Me qëllim për të vlerësuar nëse këto mospërputhje në deklarime

e vendosin subjektin në situatën e deklaramit të rremë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, u verifikua fillimisht ekzistenca e burimeve të deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*.

40.3 Burimi i krijimit: *“Të ardhura nga kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2007, në vlerën 2.000.000 lekë”*.

40.3.1 Lidhur me këtë burim krijimi, i pyetur gjatë hetimit administrativ mbi vendin e depozitimit të shumës së përfutur nga shitja e apartamentit në vitin 2007 nga ana prindërve të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁴² se [...] *shuma e përfutur nga shitja e apartamentit të vjetër në masën 2.000.000 lekë, si dhe një pjesë e kursimeve gjendje e prindërve të bashkëshortes janë konvertuar në euro dhe totali i tyre në masën 20.000 euro janë derdhur në datën 20.06.2007 (pikërisht në ditën e shitjes së apartamentit të vjetër) në llogarinë nr. {***} të bashkëshortes time pranë ProCredit Bank/degë Sarandë [...]*.

40.3.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në euro të bashkëshortes së subjektit pranë Procredit Bank ShA, konstatohet se në datën 20.06.2007, znj. E. M., ka depozituar *cash* vlerën 20.000 euro, me përshkrimin *“Të ardhura nga shitja e shtëpisë së prindërve”*. Në datën 21.06.2007, ajo ka tërhequr nga kjo llogari vlerën 20.000 euro dhe balanca e kësaj llogarie në datën 21.06.2007, rezulton të jetë zero (0). Në datën 30.04.2008 bashkëshortja e subjektit ka transferuar në llogarinë bankare të djalit të saj M. M., pranë të njëjtës bankë, vlerën 14.803,35 euro. Nga të dhënat e përcjella nga OTP Bank ShA, konstatohet se E. M., dhe D. M., kanë llogari depozite bashkëemërore në monedhën euro, hapur më datë 25.03.2010, me balancë fillestare në vlerën 6.500 euro, depozituar *cash* në llogari, e cila është mbyllur më datë 14.05.2010. Më datë 22.11.2010 është depozituar vlera 3.100 euro, e cila është tërhequr më datë 24.01.2011.

40.3.3 Në vijim të hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit, i pyetur mbi llogarinë e përbashkët bankare të bashkëshortes dhe nënës së saj, ka sqaruar se [...] *Për sa i përket depozitës me shumë 3.107 euro të maturuar më 24.01.2011 dhe tërheqjes në të njëjtën ditë të shumës 3.000 euro, poseduesit realë të kësaj shume kanë qenë prindërit e bashkëshortes sime. [...] Këto fonde burojnë nga të ardhurat e prindërve të saj në ShBA. Ato janë rezultat i derdhjes prej 5.080 euro në datën 06.09.2010 në llogarinë e përbashkët pranë OTP Albania, ish-Societe Generale Albania. Këto fonde përbëhen nga shuma 2.080 euro sjellë *cash* prej prindërve të saj në maj 2010 dhe nga shuma prej 3.000 eurosh të tërhequra nga llogaria e përbashkët më 14.05.2010. Më 22.11.2010 një pjesë prej 3.100 euro janë çelur depozitë me afat. Kjo depozitë është maturuar më 24.01.2011, pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit dhe pas tërheqjes nga banka janë përdorur për investime të mëtejshme në këtë apartament⁴³. Subjekti i rivlerësimit ka theksuar më tej se këto transaksione janë kryer nga bashkëshortja e tij vetëm me porosi të prindërve të saj dhe për shkak të mungesës së prezencës së tyre fizike në Shqipëri, duke referuar prokurën e përgjithshme të sipërcituar.*

40.3.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, *duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në datën 19.01.2011, në shumën 3.118.500 lekë, për më tepër që nuk janë prekur edhe vlerat monetare*

⁴² Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe plotësim të përgjigjeve të këtij pyetësori.

⁴³ Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur lëvizjet e llogarisë së përbashkët pranë OTP Bank.

në llogarinë e përbashkët në euro në emër të shtetasve E. M., ose D. M., në Bankën Societe Generale Albania Sh.A. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit, përveç sa ka deklaruar gjatë hetimit administrativ në lidhje me shumën prej 2.000.000 lekësh, ka sqaruar se [...] Mosprekja e një llogarie të përbashkët në datën e blerjes, siç pretendohet, nuk nënkupton patjetër se çdo para në qarkullim nga prindërit e bashkëshortes shkon pikërisht për blerjen e banesës. Në lidhje me depozitën prej 3.107eurosh, ka qenë depozitë e maturuar në datën 24.01.2011, ku në të njëjtën datë janë tërhequr 3.000 euro për investime në apartamentin e blerë të prindërve. [...] Për sa i përket gjendjes së llogarisë prej 4.013 eurosh në datën 19.01.2011, vlen të sqarohet se kjo gjendje është totali i llogarisë së depozitës plus depozita e maturuar në datën 24.01.2011 [...].

40.3.5 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara më sipër, duket se Komisioni konkluzionin se *nuk provohet që të ardhurat nga shitblerja e pronës së paluajtshme nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të jenë përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie e ka mbështetur në mungesën e provueshmërisë së një lidhjeje të drejtpërdrejtë të pagesës së çmimit të apartamentit të blerë në vitin 2011 me të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2007, nga ky moment e në vijim. Në këtë drejtim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2011, vërteton likuidimin e çmimit të shoqëria “{***}” ShPK, por jo kohën e saktë të pagimit dhe personin që e ka kryer atë⁴⁴. Veprimet bankare të kryera nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, lidhur me disponimin e vlerës 20.000 euro, duke e depozituar fillimisht këtë shumë në bankë e duke e tërhequr pas një dite nga sistemi bankar, jo vetëm nuk qartësojnë destinacionin e kësaj shume drejt shoqërisë “{***}” ShPK, pavarësisht se rregullat mbi transaksionet e shitjeve të pasurive të paluajtshme nëpërmjet llogarisë bankare të noterit nuk kishin hyrë në fuqi, por së bashku me faktin e mosprekjes së llogarisë së përbashkët bankare me nënën e saj në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes më 19.01.2011, i lenë vend një tjetër elementi dyshues në drejtim të besueshmërisë së destinacionit të përdorimit të këtyre të ardhurave. Në këtë kuptim, në vlerësimin e trupit gjykues, ndonëse mungesa e provueshmërisë së transaksionit të pagesës së çmimit të blerjes së pasurisë nuk mund të çojë *apriori* drejt konkluzionit për mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të saj, sipas standardit të kërkuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në rastin konkret një rrethanë e tillë duhet të vlerësohet në harmoni me të gjitha të dhënat e tjera që kanë rezultuar nga analiza e kësaj shtate.*

40.4 Burimi i krijimit: *“Të ardhura të prindërve nga puna në ShBA”*.

40.4.1 Në lidhje me këtë burim krijimi, me përgjigjet e pyetësorit standard (nr. 1), subjekti i rivlerësimit ka paraqitur lëvizjet e llogarive bankare të vjehrrit dhe vjehrrës në ShBA, si dhe formularët e deklarimit të të ardhurave të tyre, ndër vite, si shtetas amerikanë, që i përkasin periudhës 2012-2018.

40.4.2 Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit konkluzionin paraprak se *për sa i përket të ardhurave nga punësimi në ShBA të prindërve të bashkëshortes, të dhënat e depozituara, ndonëse jo në formën e kërkuar nga ligji, fillojnë në vitin 2012, pra nuk mund të japin evidencë për të ardhura që i takojnë një periudhe*

⁴⁴ Në kontratë parashikohet: *“Palët deklarojnë se: Shitësi, apartamentin me sipërfaqe 69,3 m² ia shet blerësve kundrejt çmimit 45.000 lek/m² në vlerën e përgjithshme 3.118.500 lekë, shumë të cilën shitësi deklaroi se e ka marrë tërësisht prej blerësve jashtë kësaj zyre, por palët më konfirmojnë mua noterit se çmimi i shitjes në shumën e mësipërme është likuiduar plotësisht”*.

*të mëparshme kohore. Në shpjegimet e tij të datës 03.09.2021 dhe në seancën dëgjimore të datës 21.09.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur lëvizjet e llogarive bankare dhe gjendjen e taksave për vitet 2007-2011 në ShBA, në emër të K., dhe D. M., në gjuhën angleze, me vulë Apostille, vërtetuar njësisht me origjinalin me nr. {***} rep., datë 20.09.2021.*

40.4.3 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara më sipër, trupi gjykues çmoi fillimisht se Komisioni ka mbajtur një qëndrim jo koherent në raport me subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion, pasi vëren se në rezultatet e hetimit Komisioni ka bërë një vlerësim paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortes në ShBA, duke i bërë të njohur atij se këto dokumente, përveçse nuk ishin paraqitur në formën e kërkuar nga ligji i përkisnin një periudhe pa interes për Komisionin. Në vijim, pasi subjekti i rivlerësimit paraqet këtë dokumentacion për periudhën respektive dhe në formën e kërkuar nga ligji, Komisioni në vendim nuk mban asnjë qëndrim mbi to, duke e fokusuar tashmë arsyetimin e tij në mungesën e provueshmërisë së transferimit të shumave nga ShBA-ja nëpërmjet rrugës bankare apo tokësore, me arsyetimin se: *në dy hyrjet e prindërve të bashkëshortes së subjektit nuk është deklaruar në kufi transportimi i vlerave monetare, të cilat referuar çmimit të shitblerjes dhe numrit të hyrjeve të tyre në vitet 2008 dhe 2010, do të ishin mbi vlerën e detyrueshme për deklarim gjatë hyrjes në aeroportin e Rinasit, për të provuar destinacionin dhe mbërritjen e tyre në Shqipëri.* Në vlerësim të trupit gjykues, Komisioni duhet të ishte më i qartë dhe transparent në analizën ligjore të fakteve dhe duhet të qartësonte subjektin e rivlerësimit mbi qëndrimin e tij lidhur me dokumentacionin mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortes në ShBA.

40.4.4 Në drejtim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka shoqëruar deklarinë e personit të lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting* mbi të ardhurat nga puna e prindërve në ShBA, me dokumentacion justifikues ligjor nga vendi i punës së shtetit përkatës, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095 prot., datë 10.10.2016⁴⁵. Nga verifikimi i të dhënave mbi hyrje-daljet në sistemin TIMS konstatohet se në periudhën 2007 – janar 2011 prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë pasur 2 (dy) hyrje-dalje në territorin shqiptar, duke hyrë përkatësisht në datat 03.10.2008 dhe 30.04.2010. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, që është ligji nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, trupi gjykues vëren se në nenin 17 të tij përcaktohet: “1. Çdo person, shqiptar ose i huaj, i cili hyn/largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlera e saj në monedha të tjera të huaja, si dhe qëllimin e mbartjes së tyre, për të cilat duhet të paraqesë dokumente justifikuese. [...]”. Në zbatim të kësaj dispozite në rastin konkret, sipas një përlllogaritjeje të thjeshtë aritmetike, trupit gjykues i rezulton se prindërit e bashkëshortes në hyrjet e tyre, përkatësisht në vitet 2008 dhe 2010⁴⁶, të dy së bashku

⁴⁵ Në pikën 21 të këtij udhëzimi përcaktohet: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë”.

⁴⁶ Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se shtetasit K. M., dhe D. M., deri në janar të vitit 2011 kanë hyrje, përkatësisht në datat 13.10.2006, 03.10.2008 dhe 30.04.2010.

mund të sillnin pa qenë të detyruar të deklarojnë, shuma deri në vlerën 1.999.800 lekë për secilën hyrje. Megjithëse arsyetimi i Komisionit në këtë rast nuk u gjet i drejtë, për trupin gjykues nuk ishte e besueshme që gjithë të ardhurat modeste të kursyera prej tyre të kishin shkuar për financimin e pasurisë objekt shqyrtimi, referuar faktit se totali i të ardhurave *neto* të rezultuara nga të dhënat dokumentare për periudhën 2007 – 2011 në vlerën 142.049 USD, i shpërndarë në një periudhë 5-vjeçare, që do t'i takonte një mesatareje mujore në vlerën 2.400 USD, si një e ardhur minimale për nivelin e të ardhurave në ShBA, duke i zbritur edhe shpenzimet minimale të jetesës, dëshmon për një mundësi kursimi të ulët. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo situatë, në tërësinë e fakteve të analizuara më sipër, e bën edhe më të qenësishme ekzistencën e dyshimeve të ngritura lidhur me raportin e prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri.

40.5 Trupi gjykues, në përfundim të analizës së kryer më lart, duke konsideruar të gjitha faktet në harmoni dhe në mënyrë integrale në raport me njëri-tjetrin, pasi shqyrtoi arsyetimin e Komisionit se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk janë pronarët *de facto* të kësaj pasurie, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie dhe ndodhet në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues e gjen të rëndësishme dhe përcaktuese për të konfirmuar këtë konkluzion faktet si vijojnë: (i) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë në ndonjë mënyrë lidhjen e prindërve të bashkëshortes së tij me këtë pasuri; (ii) bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është sjellë me këtë pasuri si pronare e vetme e saj, duke qenë prezente në lidhjen e nënshkrimit e kontratës së shitblerjes, si dhe regjistrimin e pasurisë në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme.

Automjet tip “Audi”, me targa {}***

41. Komisioni ka arritur në konkluzionin se [...] duke qenë se në rastin konkret, objekt shqyrtimi ishte deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, sa i përket kësaj pasurie nuk sjell asnjë pasojë në lidhje me kontrollin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, për shkak se ky deklarim për këtë automjet nuk është bërë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por do të vlerësohet në kuptim të vlerësimit tërësor për subjektin dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
42. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke parashtruar se një konkluzion i tillë duhet të jetë tepër i argumentuar dhe nuk mund të jetë formal e subjektiv.
43. Nga përmbajtja e vendimit, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i mësipërm i atribuohet veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në futjen në territorin shqiptar të automjetit “Mercedes-Benz”, të ardhurat nga shitja e të cilit në vitin 2015 kanë shërbyer si një ndër burimet për krijimin e pasurisë “automjet tip Audi” të deklaruar në deklaratën e rivlerësimit. Këto veprime në vlerësimin e Komisionit meritojnë të trajtohen në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si veprime që cenojnë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.
44. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në drejtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

44.1 Nga verifikimi i dokumentacionit⁴⁷ të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor dhe Doganës Kakavijë, rezulton se në datën 07.05.2009, në emër të subjektit të rivlerësimit, është lëshuar në Mynih, Gjermani, leje qarkullimi automjeti me targa {**}, me afat vlefshmërie deri më datë 21.05.2009. Procedura e zhdoganimit të këtij automjeti në Shqipëri është kryer në Doganën Kakavijë më datë 22.02.2010, në bazë të faturës me nr. {***} datë 06.02.2010 të lëshuar nga shoqëria "{***}", në të cilën evidentohet blerja nga subjekti i rivlerësimit i një automjeti tip "Mercedes-Benz E220 CDI Elegance", viti i prodhimit 2003, në vlerën 6.000 euro. Po në datën 22.02.2010, janë paguar detyrimet doganore në vlerën 358.583 lekë, ndërsa leja e qarkullimit rrugor të këtij automjeti është lëshuar më datë 25.02.2010.

44.2 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, pas kalimit të barrës së provës *se subjekti me veprimet e mosveprimet e kryera ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë*, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *"Fatura e blerjes mban datën 06.02.2010. Gjatë procedurave të shumta nisur dhe nga fakti se mora kredi, më ka humbur dokumenti i shitjes dhe jam detyruar të kërkoj dublikatë, e cila më ka ardhur vetëm pas kaq kohësh dhe me datën e lëshimit të dublikatës. Madje jam penguar dhe të zhdoganoj dhe përdor mjetin në kohë. Dublikata nuk ka asnjë ndryshim në të dhënat dhe vlerën [...]. E kisha të pamundur pa dublikatën ose faturën e blerjes të kryeja zhdoganimin. [...] Sapo erdhi dorazi dublikata menjëherë kam bërë doganën se nuk kisha më pengesa në dokumentacion. Nuk kam ndërhyrë në asnjë procedurë, ka vepruar dogana në mënyrë të pavarur. Kam bërë çdo pagesë të nevojshme që më është bërë prezent. [...] Procedura hyrje-dalje nuk dokumentohen e kontrollohen nga unë, po ashtu dokumentacioni i dosjes nuk bëhet nga unë, thjesht marr shërbimin dhe bëj pagesat si çdo qytetar dhe nuk ka asnjë privilegj për mua në doganë. [...] Në lidhje me etikën, në pozitën e qytetarit që merr shërbim mund të përgjigjem për sjelljen time, jo atë të institucioneve të tjera. [...] Fatura e ardhur rishtas nuk ka ndryshime, përveç datës që nuk është në favorin tim duket, ndërkohë që dogana është paguar mbi çmim reference. Nuk ka asnjë dokumentim për lëvizje të miat me mjetin [...]".* Në seancën dëgjimore të datës 21.09.2021, lidhur me faktin e hyrjes në territorin shqiptar në vitin 2010 pa u regjistruar më parë dalja e tij, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *"Praktikisht nuk është se ka dalë mjeti jashtë është bërë thjesht për efekt procedure ky lloj vërtetimi dhe është bërë nga autoritetet se unë s'kam akses. [...]"*.

44.3 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, nga kontrolli i arsytimit të Komisionit në vendim, fillimisht, trupi gjykues vëren se konkluzionin për ta trajtuar këtë çështje në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një sjellje që cenon besimin e publikut te drejtësia, Komisioni e ka argumentuar si vijon: *[...] fatura e blerjes e datës 6.2.2010 nuk ka asnjë lidhje kohore me marrjen dhe targimin në Gjermani të këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit (datë 7.5.2009). Subjekti nuk arriti të shpjegojë se si arriti të realizojë hyrjen e këtij automjeti në vitin 2009 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa kryer më parë zhdoganimin, dhe se si realizoi hyrjen rishtas të tij në territorin shqiptar në datën 22.02.2010, pa dokumentuar daljen e tij. Kryerja e zhdoganimit të automjetit sikur të kishte hyrë në datën 22.02.2010, në territorin e Shqipërisë janë pasojë e veprimeve të mësipërme të kryera nga subjekti, të cilat janë kryer në shkelje të praktikave normale duke kryer procesin e regjistrimit të këtij automjeti, jo vetëm duke shmangur detyrimet doganore që lindin nga vonesat në zhdoganim, por edhe mbi*

⁴⁷ Dokumentacion i përcjellë me shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 23.12.2019, të DPShTRr-së dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 05.07.2021, të Doganës Kakavijë.

*paraqitjen e fakteve të pavërteta nga ana e tij lidhur me zhdoganimin dhe duke mos paraqitur çmimin apo kohën reale të blerjes së këtij automjeti në vitin 2009. Në këtë drejtim, trupi gjykues verifikoi të dhënat mbi hyrje-daljet e sistemit TIMS, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka hyrë në territorin shqiptar me automjetin me targa {***} në datën 09.05.2009, nëpërmjet pikës kufitare Qafë Botë dhe pa regjistruar dalje në pikat kufitare shqiptare ka hyrë sërish në territorin shqiptar në datën 22.02.2010 me automjetin në fjalë, përmes pikës kufitare Kakavijë.*

45. Nga kjo situatë faktike, vlerësuar në raport me dispozitat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar⁴⁸ (në vitin 1999, 2000 dhe 2003), i cili përbënte kuadrin ligjor të kohës për hyrjen e mallrave në territorin shqiptar, trupi gjykues vëren se në vitin 2009 asnjë automjet nuk mund të hynte në territorin shqiptar pa u paraqitur pranë autoriteteve doganore dhe as të përdorej përkohësisht pa një autorizim të lëshuar nga këto autoritete. Shmangia nga këto rregulla përbënte kundërvajtje dhe ka qenë e dënueshme. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në datën 09.05.2009 ka futur një automjet në territorin shqiptar pa iu nënshtruar mbikëqyrjes doganore në çastin e hyrjes dhe pa njoftuar autoritetet doganore në vijim mbi pamundësinë e paraqitjes para tyre në çastin e hyrjes së automjetit, duke iu shmangur detyrimeve doganore. Ky automjet është mbajtur në territorin shqiptar nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë 10-mujore pa u pajisur me autorizim për t’u përdorur qoftë edhe përkohësisht deri më datë 22.02.2010, kur rezultoi të jetë bërë dhe zhdoganimi i tij. Nga ana tjetër, sikurse pohuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se procedura e zhdogimit në vitin 2010 është kryer nga autoritetet doganore bazuar në hyrje-dalje fiktive të këtij automjeti.
46. Veprimet e mosveprimet e mësipërme të kryera në kundërshtim me ligjin, në vlerësimin e trupit gjykues tregojnë një qasje të gabuar në raport me respektimin e ligjit dhe përbëjnë një sjellje jo të denjë për një funksionar të një niveli të tillë, të cilat do të perceptoheshin negativisht në syrin e një vëzhguesi të zakonshëm publik dhe pritshmërinë e tij. Trupi i gjykues i Kolegjit, duke mbajtur në konsideratë faktin se cenimi i besimit të publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, lidhet ngushtësisht me veprime a mosveprime të kryera nga subjektet e rivlerësimit, gjatë periudhës që kanë qenë duke ushtruar detyrën e gjyqtarit apo prokurorit, vlerëson se në rastin konkret shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në periudhën 2009-2010, kur ai ushtronte detyrën e OPGj-së⁴⁹ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe jo atë të prokurorit, janë të pamjaftueshme për t’u vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe për t’u ngritur në nivelin e një sjelljeje të subjektit të

⁴⁸ Neni 11 përcakton: “Mallrat mund të kalojnë vijën doganore të kufirit tokësor, ujor dhe në aeroporte vetëm në pikat e kalimit të kufirit shtetëror ku ka zona doganore”. Neni 41 përcakton: “Mallrat që futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore që nga çasti i hyrjes”. Neni 42 përcakton: “Mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë duhet të çohen pa humbur kohë nga personi që i transporton ato, dhe në rrugën e përcaktuar nga autoritetet doganore e sipas udhëzimeve të tyre, nëse ka të tilla, a) në zyrën doganore të caktuar nga autoritetet doganore ose në cilindo vend tjetër të caktuar ose miratuar prej tyre”. Neni 43 përcakton: “Kur, për shkak të rrethanave të paparashikueshme ose fuqie madhore, detyrimi i parashikuar në nenin 42 (1) nuk mund të përmbushet, personi që ka këtë detyrim ose çdo person tjetër që vepron në emër të tij duhet të njoftojë pa humbur kohë autoritetet doganore për gjendjen”. Neni 246 përcakton: “Shmangia ose tentativa për të shmangur, me çfarëdo mënyrë, kontrollin dhe/ose mbikëqyrjen doganore mbi mallrat me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve të importit dhe eksportit siç është përshkruar në nenet 276 deri në 280, si dhe secili prej veprimeve të përshkruara në këto nene, përbën kontrabandë dhe dënohet si i tillë”.

⁴⁹ Referuar raportit “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri” në periudhën maj 2003 – qershor 2012, ai ka ushtruar detyrën e OPGj-së në Prokurorinë Gjyrokastër.

rivlerësimit që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Apartament banimi me sipërfaqe 93 m² dhe shtesë me sipërfaqe 40 m², në Sarandë

47. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “Vlera e kostos së ndërtimit rezulton e ndryshme në sa është deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë vetting dhe babai në deklaratën fillestare si subjekt deklarues në vitin 2003, si dhe e ndryshme në dokumentacion. [...] Në këto kushte, situata faktike, lidhur me deklarinimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, klasifikohet sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016”.
48. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim këtë konkluzion, duke e konsideruar të marrë *apriori*, të paarsyetuar dhe të pabazuar në vlerësime të pavarura e profesionale.
49. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, si dhe kontrolloi arsyetimin e tij në vendim, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

49.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi, 93 m², lagjja {***}, rruga “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, me burim privatizimi, blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa, me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.1993, me burim krijimi të ardhurat nga pagat e dy prindërve. Vlera: 25.157 lekë. 100% bashkëpronësi e prindërve*”. Po në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar: “*Shtesë banesë, 40 m² + trualli në bashkëpronësi me banorët e tjerë të seksionit të pallatit, lagjja {***}, rruga “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, sipas vendimit KRRT-Rrethit Sarandë nr. {***}, datë 13.10.1998. Burimi i krijimit pagat e prindërve dhe më vonë edhe paga ime si subjekt, e motrës dhe bashkëshortes sime. Investim i kryer gradualisht ndër vite, aktualisht në procedurë për regjistrim. Vlera: Godinë 1.421.280 lekë + truall 28.950 lekë = 1.450.230 lekë. Pjesa jonë: 1.450.230 lekë : 5 = 290.000 lekë. 100% bashkëpronësi e prindërve*”. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003 dhe në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresa banimi, përkatësisht: *Lagjja nr. {***}, pall. {***}, ap. {***}, Sarandë dhe rruga “{***}”, pallati. nr. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Bashkia Sarandë*.

49.2 Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, të personit të lidhur Th. M., në funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, është deklaruar *shtëpi banimi (ap) {***}, l. {***}, p. {***}, sh. {***}, ap. {***}, Sarandë. Burimi: privatizuar nga Enti i Banesave, ndërsa në DIPP-në për vitin 2004 është deklaruar shtesë banesë 40 m² plus trualli në bashkëpronësi, ndërtuar me vendim të KRRT Rrethit nr. {***}, datë 13.10.1998. Shtesa: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Viti i krijimit: 1998-1999*.

49.3 Nga verifikimi i fashikullit të Komisionit rezulton se më datë 15.05.1999 është lidhur kontratë ndërtimi mes shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK dhe z. Th. M., me objekt “Shtesë pallati nr. {***}, lagjja {***}”, në vlerën 1.201.200 lekë, me afat të ndërtimit të objektit 1 vit. I pyetur gjatë hetimit administrativ mbi mospërputhjet në deklarime, lidhur me vlerën e ndërtimit të shtesës me sipërfaqe 40 m², subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁵⁰ se: [...] (a) *Vlera 1.450.230 lekë e shprehur në deklaratën vetting është llogaritur nga ana ime si vlerë mesatare e tregut të gjithë objektit “shtesë banesë 5 kate + vlerë trualli” në momentin e dorëzimit të kësaj deklarate, ku është marrë parasysh edhe vlera e shprehur në kontratën e ndërtimit. (b) Vlera prej 1.000.000 lekësh e shprehur në DIPP të vitit 2004 të babait tim është referuar me përafërsi prej tij referuar kostove mesatare të ndërtimit, duke mos konsultuar paraprakisht kontratën e*

⁵⁰ Shih përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

ndërtimit [...]. (c) *Vlera e saktë në periudhën e ndërtimit të shtesës anësore të objektit 5-katësh është pikërisht vlera 1.201.200 lekë që mbartet e shprehur në kontratën e ndërtimit të datës 15.05.1999 [...]. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, në kundërshtim të barrës së provës së subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën vetting lidhur me vlerën e këtij ndërtimi, për sa ka deklaruar një vlerë të ndryshme nga ajo e kontratës së vitit 1999, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim.*

50. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, nga kontrolli i arsytimit të Komisionit në vendim, trupi gjykues vëren se konkluzioni i tij në përfundim të shqyrtimit të kësaj pasurie lidhet me pasaktësitë në deklarime, për shkak të mospërputhjes së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting me deklarimet e babait të tij Th. M., si subjekt deklarues në vitin 2003, si dhe aktet e administruara në drejtim të vlerës së ndërtimit të shtesës me sipërfaqe 40 m². Trupi gjykues, gjithashtu, vëren se ky konkluzion, ndonëse i kualifikuar nga Komisioni sipas shkronjës “b”, pikës 5, nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nuk shoqërohet me analizë të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për ndërtimin e shtesës me sipërfaqe 40 m².
51. Në drejtim të sa më sipër, trupi gjykues, referuar shtojcës nr. 2 “Deklarata e pasurisë”, pjesë e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit kanë pasur detyrimin të deklarojnë në rubrikën “Deklarimi i pasurive” vlerën në lekë apo në valutë të pasurisë të regjistruar ose jo, që pasqyrohet në dokumentacionin e disponuar, vëren se vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting nuk përputhet me vlerën e pasqyruar në kontratën e ndërtimi të lidhur mes subjekti “{***}” ShPK dhe babait Thanas Mërkuri. Në këto rrethana, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë vetting, në lidhje me vlerën e ndërtimit të shtesës me sipërfaqe 40 m², element që i pashoqëruar me ndonjë rezultat financiar, për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Apartament banimi me sipërfaqe 112 m², zyrë me sipërfaqe 28 m² dhe truall me sipërfaqe 150 m², në Sarandë

52. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Referuar përfitimit të kësaj pasurie në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, ku neni 3 i këtij ligji parashikonte: “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve, kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private bëhet vetëm në rastet që vijnë: (a) për ndërtimin e banesave me qëllim të lirit të banesave të ish-pronarëve, si dhe për të pastrehët, të ndërtuara nga Enti i Banësve apo persona të tjerë; (b) me vendim të Këshillit të Ministrave, për shitje, për investime shumë të rëndësishme për vendin”, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, sipas germës “b”, të pikës 5 të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion duke pretenduar se ai është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe se ligjshmëria e burimeve të pasurive të tij është e qartë.*
53. Nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin e tij për mungesë të shpjegimit bindshëm të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë e ka lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me përfitimin në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të truallit me sipërfaqe 150 m², mbi të cilin është ndërtuar objekti.

54. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues verifikoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nga ku konstatoi situatën e fakteve si vijojnë:

54.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi 112 m² + zyrë 28 m² + truall 150 m² në b/pronësi me avokatët, L. {***}, rruga “{***}”, Godina e Avokatëve Sarandë. Trualli i blerë nga shteti me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.1996. Krijuar në vitet 1996-2015. Investuar periodikisht sipas mundësisë. Burimi i krijimit të ardhurat familjare ndër vite nga pagat, nga vlera e kredisë prej 300.000 lekësh, sipas kontratës së kredisë, datë 27.05.2005, me Raiffeisen Bank, nga vlefata e shitjes së truallit prej 1.000.000 lekësh, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2002, nga qiraja e zyrës prej 10.000 lekë/muaj ose në total prej 600.000 lekësh neto, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.01.2006, e cila ka vazhduar prej vitit 2006 deri në dhjetor 2010, nga ekzekutimi i detyrimit nga ProCredit Bank nëpërmjet zyrës së përmbarimit në shumën 1.427.530 lekë në datën 27.02.2010, sipas vendimit nr. {***}, datë 10.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga vlera e kredisë Nr. {***} prej 500.000 lekësh, me ProCredit Bank ShA, datë 04.12.2006, nga vlera e kredisë nr. {***} prej 1.000.000 lekësh, me ProCredit Bank, datë 13.07.2007. Vlera: trualli = 108.000 lekë pjesëtim për 5 b/pronarë = 21.600 lekë; ap. 112 m²+sip. përbashkëta = 132 m² X 27.000 lekë kosto mesatare ndërtimi = 3.564.000 lekë. Zyra 28 m² x 27.000 lekë kosto mesatare ndërtimi t= 756.000 lekë. 100% bashkëpronësi e prindërve”. Sipas certifikatave për vërtetim pronësie të paraqitura bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, të tria këto pasuri rezultojnë të regjistruara në pronësi të z. Th. M⁵¹.*

54.2 Në DIPP-në e vitit 2004, personi i lidhur, z. Th. M., ka deklaruar se: “*Apartament banimi dhe një zyrë në një godinë në bashkëpronësi me 5 bashkëpronarë, të ndërtuar deri në karabina (pjesa ime), e pa hipotekuar. Vlerat ndërtimore në shumën 1.140 lekë. Trualli në bashkëpronësi 150 m² miratuar me vendim nr. {***}, datë 14.03.1995, të KRT. Trualli blerë me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.1996. Vlera e truallit 108.000 lekë nga kjo 21.600 lekë pjesa ime”.*

54.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Sarandë, konstatohet se me vendim nr. {***}, datë 07.07.1995, “Për dhënie sheshi ndërtimi”, të Këshillit të Bashkisë Sarandë, në bazë të kërkesës së datës 01.02.1993⁵², i jepet shtetasve G. A., P. K., K. Q., Th. M., dhe V. H., si investitorë në bashkëpronësi, një sipërfaqe prej 150 m² për zyra avokatie. Në vijim, me vendimin nr. {***}, datë 15.3.1996, këtyre shtetasve u jepet në bashkëpronësi si investitorë të sheshit të ndërtimit një sipërfaqe truall prej 150 m² duke respektuar kondicionet urbanistike. Në datën 14.08.1996 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes Seksionit të Financës të Këshillit të Rrethit Sarandë, në cilësinë e shitësit dhe pesë avokatëve si më sipër në cilësinë e blerësve, me objekt truallin me sipërfaqe 150 m², me çmim 108.000 lekë, me qëllim përdorimin e tij për avokati dhe lokal shërbimi. Më datë 10.12.2002, mes grupit të avokatëve dhe shoqërisë “{***}” ShPK, është lidhur kontrata e ndërtimit për ndërtimin e objektit zyra+banesë. Me vendim nr. {***}, datë 24.12.2002, të KRrT-së Sarandë është

⁵¹ (i) pasuria nr. {***}, e llojit apartament me sipërfaqe 112 m²; (ii) pasuria nr. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 150 m² (në bashkëpronësi të P. K., K. Q., V. H., Th. M., dhe G. A.); (iii) pasuria nr. {***}, e llojit njësi me sipërfaqe 28 m².

⁵² Kjo kërkesë i është drejtuar Zyrës së Urbanistikës së Bashkisë Sarandë, duke i kërkuar shesh për ndërtimin e objektit “Zyra avokatie”.

miratuar destinacioni i sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, për avokatët Sarandë, me objekt “*lokal+zyra+banesë*”. Në po këtë datë, është miratuar leja e ndërtimit për grupin e avokatëve me destinacion të sheshit të ndërtimit të objektit *lokal+zyra+banesë*.

54.4 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë sqarime mbi ligjshmërinë e veprimeve të kryera për këtë pronë në raport me vendimin nr. 39, datë 26.01.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit shitja e trojeve si veprim juridik është në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 7989, datë 27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, sipas së cilit *organet e pushtetit vendor pranë këshillave të rretheve apo bashkive, kishin të drejtë të bënin kalimin në pronësi të subjekteve privatë të trojeve shtetërore, vetëm në rastet e parashikuara nga kjo dispozitë*. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vendimi nr. 39, datë 26.01.2016, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është marrë 20 vjet pas lidhjes së kontratës për shitblerjen e truallit nga grupi i avokatëve dhe jo vetëm nga babai i tij. Sipas tij, në këtë çështje, grupi i avokatëve është mbështetur edhe nga Ministria e Drejtësisë, e cila asokohe i kishte kërkuar Bashkisë Sarandë të trajtonte me përparësi kërkesat e avokatëve për sheshe ndërtimi në vende të përshtatshme për ndërtimin e objekteve për ushtrimin e avokatisë dhe se vendimi përkatës i Këshillit të Bashkisë Sarandë është vlerësuar i ligjshëm edhe nga prefekti i Vlorës. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ndër të tjera: (i) shkresë e datës 25.04.1996 e Prefektit të Vlorës drejtuar Kryetarit të Bashkisë Sarandë, mbi ligjshmërinë e vendimit nr. {***}, datë 15.03.1996; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 07.04.1994, e Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar KRRt-së të Bashkisë Sarandë, me lëndë “Për dhënie sheshi ndërtimi”, përmes së cilës kërkohet të shihen me përparësi kërkesat e avokatëve për t’u miratuar sheshe ndërtimi në vende të përshtatshme për ndërtimin e objekteve për avokatinë.

54.5 Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës: *subjekti ka detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara duke përfshirë edhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera për këtë pronë në raport me vendimin nr. 39, datë 26.01.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*⁵³. Në kundërshtim të këtij rezultati, subjekti ka sqaruar se [...] *Ne nuk kemi kryer asnjë veprim të ndaluar nga ligji, unë absolutisht nuk jam pjesë e kësaj shtate. Nuk përmendet se çfarë ligji apo rregulli është shkelur nga personat e lidhur, sepse në fakt nuk është shkelur asnjë ligj apo rregull prej tyre, nuk mbajnë përgjegjësi për procedurat e institucioneve, ndërkohë që unë nuk përgjigjem edhe sikur të kenë gabuar vlerësimin ligjor personat e lidhur [...]*. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 27, datë 19.05.2016, të Gjykatës Kushtetuese⁵⁴, i cili, sipas tij, godet një vendim të Gjykatës së Lartë të ngjashëm me atë të përmendur nga Komisioni, si dhe VKM-në e datës 22.05.2019⁵⁵, që ka rregulluar këtë proces duke urdhëruar procedimin me objektet e

⁵³ Sipas këtij vendimi, Gjykata e Lartë, në përfundim të shqyrtimit të çështjes me palë paditëse P. K., dhe palë e paditur A. H., ZVRPP-ja Sarandë dhe Bashkia Sarandë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 06.03.2012, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes me nr. {***}, datë 27.06.1998, në favor të subjektit A. H., duke u shprehur edhe për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. {***}, datë 28.08.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, me të cilin është vendosur miratimi i lejes së sheshit të ndërtimit, në pronën e subjektit A. H.

⁵⁴ Përmes këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 712, datë 18.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

⁵⁵ VKM-ja, datë 22.05.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, ka si qëllim vendosjen

përfituara në të njëjtën mënyrë.

55. Në analizë të situatës së fakteve të parashtruara më lart, trupi gjykues, referuar kuadrit ligjor në fuqi të kohës, vëren se shitja e truallit shtetëror përfshihej në fushën e veprimtarisë së ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e të drejtës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe të privatizimit”⁵⁶. Në nenin 21 të këtij ligji, ligjvënësi ka parashikuar shitjen e trojeve shtetërore te subjektet private, vendas apo të huaj për qëllime ndërtimi, sipas çmimit të përcaktuar nga aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, si dhe organin kompetent që do të kryente shitjen e këtyre trojeve që do të ishte organi financiar i pushtetit lokal, nën juridiksionin e të cilit ndodheshin trojet objekt shitje. Nga ana tjetër, ligji nr. 7980, datë 27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, ndalonte këto organe të tjetërsonin pronat publike, përveç rasteve të parashikuara në nenin 3 të tij⁵⁷. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se mes grupit të avokatëve dhe seksionit financiar të Këshillit të Bashkisë Sarandë, është lidhur kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.1996, me objekt truall me sipërfaqe 150 m², e paraprirë nga vendimi nr. {***}, datë 15.03.1996, i këtij Këshilli, i cili i është nënshtruar edhe filtrit të kontrollit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të prefektit. Ndërkaq nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupit gjykues nuk i rezulton i administruar ndonjë vendim gjykate që të ketë shpallur të pavlefshme kontratën e shitblerjes të datës 14.08.1996 e, aq më pak, vendimin përkatës të Këshillit të Bashkisë, akte mbi bazën e të cilave është përfituar trualli objekt shqyrtimi. Në të tilla rrethana, trupi gjykues i Kolegjit, duke vlerësuar se çështja e përputhshmërisë ligjore mes akteve të Këshillit të Bashkisë Sarandë dhe ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995, del jashtë tagrit të tij, e gjen të pambështetur konkluzionin e arritur nga Komisioni në drejtim të deklaramit të subjektit të rivlerësimit.

Garazh me sipërfaqe 23,8 m², në Lagjen nr. {}, Sarandë***

56. Komisioni ka arritur në përfundimin se *subjekti, së bashku me provat e tjera, në tërësi me rrethanat e çështjes, nuk ishte bindës në shpjegimin e tij për arsyen e mosdeklarimit të këtij garazhi dhe mbi shpjegimet e tij se kjo ishte një pronësi e krijuar nga babai i tij, duke mos arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit.*
57. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *ky konkluzion është i gabuar pasi mbështetet në konstatimin e pavërtetë që babai i tij nuk dispononte leje drejtimi për automjet, pasi ai ka disponuar leje drejtimi që prej vitit 1967, ndërsa certifikata e pronësisë për garazhin është paraqitur dhe është mohuar nga Komisioni.* Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur ankimit dhe kërkon të merret në cilësinë e provës kopje e vërtetuar e lejes së drejtimit të babait, Th. M.
58. Nga kontrolli i arsytimit në vendim, bazuar në pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin e tij se subjekti nuk ishte bindës në shpjegimet mbi mosdeklarimin e këtij garazhi, në DIPP-në para fillimit të detyrës së vitit 2012, e ka mbështetur

nën një regjim të rregullt juridik të procedurës së ndjekur nga njësitë e qeverisjes vendore për kalimin e pronësisë së trojeve të dhëna për ndërtim, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

⁵⁶ Shfuqizuar me ligjin nr. nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

⁵⁷ Në nenin 3 të këtij ligji, parashikohet: “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve, kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private bëhet vetëm në rastet që vijojnë: a) Për ndërtimin e banesave me qëllim të liritimit të banesave të ish-pronarëve si dhe për të pastrehët, të ndërtuara nga Enti i Banësive apo persona të tjerë. b) Me vendim të Këshillit të Ministrave, për shitje, për investime shumë të rëndësishme për vendin”.

edhe në konstatimin *se babai i subjektit të rivlerësimit nuk dispononte automjet*⁵⁸. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues vëren se Komisioni në këtë rast nuk e ka ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në kuadër të deklaratës së pasurisë *vetting*.

59. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

59.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarohet: *“Garazh automjeti, 23,8 m², L. {***}, rruga “{***}”, ndërtuar pa leje rreth viteve 1994-1995, me burim krijimi të ardhurat nga pagat e dy prindërve, aktualisht në procedurë legalizimi sipas vetëdeklarimit formular tip A, Nr. {***} prot., datë 11.11.2006. Vlera totale sipas situacionit të punimeve = 200.000 lekë. 100% bashkëpronësi e prindërve”*. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ndër të tjera: (i) vetëdeklarim formular tip A, nr. {***} prot., datë 11.11.2006, sipas së cilit shtetasi Th. M., ka aplikuar për legalizimin e një objekti informal (garazh), me sipërfaqe 23,8 m², me funksion parkim mjete, i ndodhur në lagjen nr. {***}, pall. nr. {***}; (ii) shkresë kthim përgjigje e ZVRPP-së Sarandë, e cila ka përcjellë kartelën e pasurisë nr. {***}, e llojit truall me sip. 751,6 m², në pronësi “shtet”, në të cilën ndodhet objekti i ndërtuar. Kjo pasuri nuk rezulton e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012 e as në DIPP-të të personit të lidhur Th. M.

59.2 Gjatë hetimit administrativ, me pyetësorin nr. 3, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të paraqesë certifikatat e pronësisë së garazhit dhe truallit e ndërtimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 06.04.2017, për pasurinë nr. {***}, ndërtesë me sipërfaqe totale 31 m²; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 02.03.2018, për pasurinë nr. {***}, truall me sipërfaqe totale 31 m², të dyja në pronësi të z. Th. M.

59.3 Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës: *Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2012. Subjekti ka detyrimin të shpjegojë sa më sipër edhe arsyet e mosdeklarimit. Subjekti nuk ka përfshirë në deklaratën *vetting* kopje të certifikatës së pronësisë për objektin “garazh” dhe për truallin ku ndodhet ky objekt*”. Në shpjegimet e tij mbi këto rezultate, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *[...] Është deklaruar kur është dokumentuar, nuk mund të bëhej ndryshe dhe nuk është bërë/ndërtuar nga unë [...]. Aktet tregojnë se tani vonë është regjistruar. Është prezent në deklarinimin e vitit 2018 sipas ligjit, duke qenë se u materializua si pasuri. Nuk ka pasur asnjë tendencë mosdeklarimi, thjesht i jam referuar dokumentimit. Ai ishte objekt në risk mund të prishej çdo çast dhe nuk kishte asnjëherë siguri. Nuk mund të deklaronim pasuri hipotetike, me këtë logjikë kam ecur. [...] gjithçka është kryer e proceduar nga im atë dhe nuk mund të gjykoja, vlerësoja apo kontrolloja veprimet e tij në kuptim të ligjit, pozicionit dhe moralit.[...]*.

60. Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të mësipërme, trupi gjykues fillimisht konstaton se Komisioni nuk ka administruar gjatë hetimit administrativ ndonjë akt për të vërtetuar faktin nëse babai i subjektit të rivlerësimit dispononte ose jo leje drejtimi për automjet. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se Komisioni konstatimin se babai i tij nuk dispononte leje drejtimi për automjet nuk e ka bërë pjesë të rezultateve të hetimit, por ia ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit vetëm në vendim dhe e ka përdorur atë në arsyetimin e tij, pa treguar aktin në të

⁵⁸ Shih paragrafin 138 të vendimit.

cilin mbështetet. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, që kundërshton konstatimin e Komisionit mbi mosparaqitjen e certifikatave për vërtetim pronësie të pasurisë garazh dhe truallit mbi të cilin është ndërtuar objekti, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së barrës së provës dërguar subjektit të rivlerësimit, vëren se ky konstatim i Komisionit lidhet me mosparaqitjen e këtyre akteve bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, ndërkohë referuar fashikullit të Komisionit rezulton që këto akte të jenë depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, pas regjistrimit të këtyre pasurive në ZVRPP-në Sarandë, në vitin 2018. Ndonëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë rast u gjenden të drejta dhe të bazuara në fakte, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur ai nuk është ngarkuar me ndonjë përgjegjësi disiplinore në kuadër të deklaratës së pasurisë *vetting*, ato konsiderohen të tilla që nuk e bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit dhe pa efekt në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

Truall me sipërfaqe 4200 m², {}, Sarandë, individualizuar në tre pasuri të veçanta me nr. {***}, nr. {***} dhe nr. {***}***

61. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“Pas analizimit të deklaramentit të subjektit në raport me detyrimin ligjor për të provuar vërtetësinë e deklaramenteve në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë vërtetësinë e deklaramenteve dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive. Në këto kushte, situata faktike ku subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të pasurive të mësipërme, nuk ka shpjeguar bindshëm dhe nuk ka provuar me dokumentacion ligjor mënyrën e përfitimit të tyre, trupi gjykues vlerëson se situata e subjektit lidhur me deklarimin e këtyre pasurive klasifikohet sipas parashikimeve të germës “b” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016”*. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion duke e konsideruar të pabazuar në prova dhe në ligj, pasi ligjshmëria e burimeve të krijimit të pasurive të tij është e qartë.
62. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të hetimit administrativ, si dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

62.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarohet: *“Truall 4200 m², rruga “{***}” ({***}), Sarandë, individualizuar si pasuritë: (i) nr. {***}, me sip. 1882,5 m²; (ii) nr. {***}, me sip. 1164,7 m²; (iii) nr. {***}, me sip. 1153,8 m², me burim nga kompensimi i pronave të gjyshit A. M., me vendimin nr. {***}, datë 01.12.1994 dhe nr. {***} (plotësues), datë 29.03.1996, të KKK Pronave, Bashkia Sarandë, në bashkëpronësi midis babait tim Th. M., dhe vëllezërve F., V. e M. M., në raportin ¼ pjesë secili. Në bashkëpronësi 25% të Th. M.”*. Bashkëngjitur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka depozituar shkresën e ZVRPP-së Sarandë⁵⁹, e cila ka konfirmuar të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve F. M., M. M., V. M., dhe Th. M., tre pasuritë e sipërcituara.

62.2 Nga informacioni i përcjellë nga AShK, Drejtoria Vendore Sarandë⁶⁰, përveç tre pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, konfirmohen të regjistruara në bashkëpronësi të

⁵⁹Shih shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 30.11.2016, të ZVRPP-së Sarandë.

⁶⁰Shih shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të AShK Drejtoria Vendore Sarandë, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur; shkresë nr. {***} prot., datë 19.08.2017 dhe nr. {***} prot., datë 05.10.2017, të ZQRPP-së drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 12.02.2019, e ATP-së drejtuar Komisionit.

shtetasit Th. M., me shtetasve F., M., dhe V. M., edhe pasuritë e llojit truall me nr. {***} dhe nr. {***}. Lidhur me mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive nga babai i subjektit të rivlerësimit, rezulton se:

i) me vendimin nr. {***}, datë 22.06.1994, ish-KKKP Sarandë ka vendosur t'i kthejë ish-pronarëve⁶¹ F., V., M., dhe Th. M., *katin e parë të shtëpisë së ndërtuar prej tyre dhe të shpronësuar me vendim të ish-Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Sarandë me nr. {***}, datë 27.10.1969, së bashku me truallin 200 m²*. Në vijim, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.1994, i njëjti organ ka vendosur: *1. Të njohë z. A. M., si ish-pronar të një sipërfaqe trualli prej 4400 m² në formën e një drejtkëndëshi. Truallin prej 200 m² që është shtëpia e ish-pronarit i zbritet nga kompensimi për faktin se është kthyer nga KKP Sarandë me vendim nr. {***}, datë 22.6.1994. 2. Të kompensohen trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarit A. M., me një sipërfaqe trualli prej 4200 m² me vendim të veçantë në zonën e re turistike, sipas planit të vendosjes përkatëse. Ndërsa me vendimin (plotësues) nr. {***}, datë 29.03.1996, ka vendosur [...] të kompensojë në natyrë trashëgimtarët ligjorë të A. M., me një sipërfaqe trualli prej 4200 m² [...].*

ii) me kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.06.1997, shtetasit F. M., Th. M., V. M., M. M., dhe E. M., trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të z. A. M., i dhurojnë motrës E. M., pronën e njohur e të kthyer me vendimin nr. {***}, datë 22.06.1994, të ish-KKKP Sarandë dhe, kjo e fundit, po nëpërmjet kësaj kontrate dhurimi, heq dorë nga çdo e drejtë pronësie nga pasuria trashëgimore dhe çdo pasuri tjetër jashtë kësaj pasurie që është objekt i kontratës së dhurimit;

iii) me vendimin nr. {***}, datë 18.09.1998, ish-KKKP Sarandë ka vendosur që trashëgimtarëve ligjorë të z. A. M., *t'iu kthehet truall i lirë për 960 m²; Parcela S1 truall 270 m² [...]; Parcela S2 truall 50 m²; [...] Parcela S3 truall 640 m² [...]. Në bazë të nenit 21 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, trashëgimtarëve ligjorë të A. M., ju njihet e drejta e parablerjes për objektet në rast privatizimi: *magazina e ndërmarrjes së elektrikut për truallin nën ndërtesë 360 m²; magazina e ndërmarrjes së ujësjellësit për truallin nën ndërtesë 127 m²; magazina e ndërmarrjes elektrike për truallin nën ndërtesë me sipërfaqe 45 m²*. Sipas vendimit me të njëjtin numër dhe datë (me makinë shkrimi) të ish-KKKP Sarandë, të përcjellë pranë ILDKPKI-së nga ZVRPP-ja Sarandë është vendosur që trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit A. M., *t'iu kthehet truall i lirë për 1380 m² sipas planvendosjes: parcela S1 truall 352 m², parcela S2 224 m² dhe parcela S3 804 m²*.*

iv) nga komunikimet mes ZQRPP-së Tiranë dhe ZVRPP-së Sarandë, konstatohet se kjo e fundit ka hasur në problematikë lidhur me vendimin nr. {***}, datë 18.09.1998, të ish-KKKP Sarandë, duke parashtruar: *[...] nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në ZVRPP-në Sarandë, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 18.09.1998, AKKP-ja u ka kthyer trashëgimtarëve të A. M., një sipërfaqe trualli prej 1380 m² të lirë [...]. Parcela S1, truall me sipërfaqe 352 m²; parcela S2 me sipërfaqe 224 m², parcela S3 me sipërfaqe 804 m². [...] Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga AKKP-ja Tiranë rezulton se trashëgimtarëve ligjorë të A. M., iu është kthyer një sipërfaqe trualli e lirë 960 m² si vijon: S1 270 m², S2 50 m² dhe S 640 m². Ndodhur në kushtet kur përcillet një vendim nga AKKP-ja Tiranë, i cili përmban*

⁶¹ Me dëshminë e trashëgimisë nr. {***}, datë 09.10.1993, të Gjykatës së Rrethit Sarandë, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të shtetasit A. M., që janë: A. M., F. M., L. T., Th. M., E. P., V. M., dhe M. M.

sipërfaqe të ndryshme të kthyer (960 m²) nga vendimi që administrohet në hipotekë Sarandë (1380 m²) atëherë nga ana e ZVRPP-së Sarandë kërkohet mendim se si do të procedohet.

v) sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekorë të datës 22.09.2004, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të z. Th. M., me pjesë takuese 1/4, pasuria me nr. {***} e llojit truall me sipërfaqe 200 m² kthyer me vendim të KKKP-së, për të cilin është aplikuar për regjistrim, sipas kërkesës së datës 07.09.2004 të shtetasit F. M.⁶², ndërsa sipas kartelës së pasurisë rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të z. Th. M., me 1/4 pjesë takuese, pasuria e llojit truall me sipërfaqe 640 m² me nr. {***}, me datë regjistrimi 11.12.2015.

62.3 Gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit për të paraqitur dokumentacion ligjor për krijimin dhe burimin e ligjshëm të dy pasurive cituar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar⁶³ se bëhet fjalë për pasurinë me nr. {***}, e llojit truall, me sipërfaqe 200 m² dhe pasurinë me nr. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 640 m², të regjistruara në emër të babait të tij Th. M., me 1/4 pjesë takuese, trashëguar nga i ati A. M., të cilat rrjedhin nga vendimi nr. {***}, datë 18.09.1998 dhe vendimi nr. {***}, datë 01.12.1994, i KKKP-së Sarandë, për ekzistencën e të cilave nuk ka pasur dijeni, provuar ky fakt edhe nga përgjigja e ZVRPP-së Sarandë e datës 30.11.2016, të paraqitur me deklaratën e pasurisë *vetting*. Sipas tij, pasuria me nr. {***} e llojit truall me sipërfaqe 200 m² ka qenë e regjistruar që në datën 22.09.2004 në bashkëpronësi të babait dhe xhaxhallarëve të tij, me pjesë takuese 1/4, por me kontratë dhurimi në datën 12.06.1997 kjo sipërfaqe trualli i është dhuruar motrës së tyre E. M., e cila duhet të kryente veprimet e regjistrimit. Këto pretendime shoqërohen me kopjen e njehsuar të dokumentacionit të ZVRPP-së Sarandë.

62.4 I pyetur nga Komisioni, mbi mospërputhjen e përmbajtjes së ekzemplarëve të vendimit nr. {***}, datë 18.09.1998, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar⁶⁴ se vihet në dijeni aktualisht, duke sqaruar se mospërputhja mes tyre qëndron në faktin se ekzemplari që administron zyra e hipotekës pranë ZVRPP-së Sarandë flet për sipërfaqen 1380 m², ndërsa ekzemplari i dërguar nga AKKP-ja Tiranë flet për sipërfaqen 960 m², që në opinionin e tij vjen për shkak të ndërhyrjes nga persona të jashtëm që mund të kenë interes, në dokumentacionin e pronësisë që disponon AKKP-ja Tiranë, duke hequr nga dosja ekzemplarë origjinal të vendimit dhe duke zëvendësuar atë me ekzemplarë jo real që i zvogëlon familjes së tij sipërfaqen e truallit të kthyer me qëllim përfitimin e paligjshëm. Për të mbështetur këto pretendime subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, ndër të tjera, vërtetim nga dokumentet hipotekorë të datës 21.02.2002 sipas së cilit figuron e regjistruar në emër të shtetasve V., L., Th., E., F. dhe M. M., pasuria e llojit truall me sipërfaqe 1380 m², me 1/6 pjesë takuese, si dhe aplikim me nr. rendor {***}, të shtetasit V. M.

62.5 Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barrë prove: (i) *subjekti dhe personi i lidhur duhet të provojnë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive, duke depozituar dokumentacion që vërteton regjistrimin e pronës së kthyer pranë ZVRPP-së Sarandë, sipas vendimit nr. {***}, datë 22.06.1994, të ish-KKKP-*

⁶² Me vendimin nr. {***}, datë 23.9.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore së trashëgimlënësit Andon Mërkuri, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë fëmijët e tij, F. M., V. M., Th. M. dhe M. M., për regjistrimin e të cilit pranë ZVRPP-së Sarandë, është aplikuar sipas kërkesës së datës 14.10.2009 të F. M.

⁶³ Shih përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

⁶⁴ Shih përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

së; (ii) subjekti duhet të paraqesë dokumentin e regjistrimit të pronës së kthyer me vendimin nr. {***}, datë 22.06.1994, të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Sarandë, nëse është regjistruar e drejta e parablerjes, e drejtë e cila ligjërisht regjistrohet në regjistrat hipotekorë dhe mbi mospërputhshmërinë e përmbajtjes së vendimit nr. {***}, datë 18.09.1998, fakt i konstatuar edhe nga korrespondenca zyrtare ndërmjet ZQRPP-së nr. {***} prot., datë 08.05.2015, drejtuar ZVRPP-së Sarandë, nr. {***} prot., datë 26.03.2015, të ZVRPP-së Sarandë dhe nr. {***} prot., datë 30.12.2014, të AKKP-së. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: [...]për rastin e pasurisë me vendimin nr. {***}, datë 22.06.1994, as im atë nuk ka pasur dijeni, aq më tepër unë, madje as ZVRPP-ja nuk ma paraqiti kur kërkova pasuritë për procesin e vetting-ut. Me ardhjen dijeni jam interesuar personalisht dhe ju kam vënë në dispozicion gjithçka kam gjetur. [...] veprimet e kalimit të pronësisë, pas regjistrimit të sipërfaqes së truallit në ZVRPP Sarandë, duhej t'i kryente E. M., (halla ime) dhe është përgjegjësi individuale e saj që deri aktualisht nuk i ka kryer këto veprime. Në prapësimet shtesë të datës 03.09.2021 dhe në seancën dëgjimore të datës 21.09.2021, subjekti ka paraqitur certifikatë regjistrimi pronësie lëshuar më datë 25.08.2021 me vulë elektronike nga ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë, sipas së cilës në emër të znj. E. P., figuron e regjistruar pasuria nr. {***}, z. k. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 200,97 m², shoqëruar me fragment të hartës kadastrale.

62.6 Në analizë të fakteve dhe të rrethanave të mësipërme, nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues konstaton fillimisht se konkluzioni i Komisionit lidhet me dy pasuri të paluajtshme që kanë si origjinë vendimet nr. {***}, datë 22.06.1994 dhe nr. {***}, datë 18.09.1998, të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Sarandë, me objekt kthimin dhe kompensimin e pronave trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit A. M., (gjyshi), të cilat nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë drejtim, trupi gjykues vëren se pasuria me nr. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 200 m², ka si origjinë vendimin nr. {***}, datë 22.06.1994, të ish-KKKP Sarandë. Megjithëse kjo pasuri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* e deri në vitin 2021 figuronte e regjistruar në bashkëpronësi të z. Th. M., me pjesë takuese ¼ dhe rezultoi se ajo i ishte dhuruar prej tyre që më datë 12.06.1997 shtetas E. M., (e motra e z. Th. M.), regjistruar me vonesë në emër të saj më datë 21.09.2021. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se pasuria me nr. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 640 m², ka si origjinë vendimin nr. {***}, datë 18.09.1998, të ish-KKKP-së Sarandë, vendim i cili rezultoi i administruar në dy versione që referojnë sipërfaqe të ndryshme 960 m² (pjesë e të cilës është edhe sipërfaqja prej 640 m²) dhe 1380 m². Në kushtet që kjo pasuri ka figuruar e regjistruar në regjistrat publikë në bashkëpronësi të babait të subjektit të rivlerësimit në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë kryer veprime juridike që lidhen me të, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e deklarimit të saj në zbatim të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, pika 7 e tij, dispozita të cilat obligojnë subjektet e rivlerësimit të deklarojnë në deklaratën e pasurisë *vetting*, saktësisht dhe në mënyrë të plotë pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

62.7 Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* i pasurisë së paluajtshme truall me sipërfaqe 640 m², me nr. pasurie {***}, që ka si origjinë vendimin nr. {***}, datë 18.09.1998, të ish-Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave Bashkia Sarandë, e vendos subjektin e

rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

63. Trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, Kolegji, bazuar në sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë si parashikuar nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

64. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni në lidhje me kontrollin e figurës ka vepruar në kundërshtim më frymën kushtetuese, sipas nenit DH të Kushtetutës dhe standardet e përcaktuara nga neni 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka kryer hetime në lidhje me kontrollin e figurës dhe nuk ka asnjë pretendim në drejtim të subjektit, duke paraqitur vlerësime joligjore dhe abuzive të një organi jo të pavarur si DSIK-ja. Edhe konkluzioni për cenim të besimit të publikut është haptazi në kundërshtim me ligjin.*
65. Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se në lidhje me kontrollin e kriterit të figurës Komisioni nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, por ka çmuar se [...] *konstatimet e gjetura gjatë hetimit të rrethanave që përmbajnë praktikat e procedimeve penale, analizuar në funksion të këtij kriteri të vlerësimit, kanë dëshmuar se subjekti i rivlerësimit ka krijuar kushtet e klimës së pandëshkueshmërisë në sytë e publikut, duke cenuar besimin e publikut të drejtësisë, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
66. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, si dhe qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ku Gjykata ka arsyetuar se *për sa i takon procesit të kontrollit të figurës, sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, objekti i këtij kontrolli është identifikimi i atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe pas njohjes me dokumentacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, nuk është i bazuar. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore, lidhur me këtë kriter, Komisioni mund të konkludonte deri në konstatimin e përshtatshmërisë apo papërshtatshmërisë së subjektit, por jo të përdorte indicet që vijnë nga hetimi për të, si fakte të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut. Në këtë drejtim, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji⁶⁵ se në interpretim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm, i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, duhet që të ekzistojnë shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të dhënat e dokumentacionit të administruar nga organet ligjzbatuese do të vlerësohen nga trupi gjykues në vlerësimin në tërësi të çështjes e në harmoni edhe me konkluzionet që do të arrihen lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në këtë kuptim, mangësitë e konstatuara në veprimet procedurale të kryera nga subjekti i*

⁶⁵ *Shih vendimet nr. 19/2023 (JR), paragrafi 94 dhe nr. 38/2023 (JR), paragrafi 35.6.*

rivlerësimin në procedimin penal nr. {***}/2014, të regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit H. H., si dhe në procedimet penale nr. {***}/2016, nr. {***}/2016, nr. {***}/2016 dhe nr. {***}/2016, të vendosura në kontekstin e informacioneve të administruara nga organet ndihmëse në procesin e kontrollit të figurës, sipas nenit 36 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e trupit gjykues u konsideruan në drejtim të kriterit të vlerësimin të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

67. Sa i takon pretendimin të subjektit të rivlerësimin se *Komisioni ka paraqitur vlerësime joligjore dhe abuzive të një organi jo të pavarur si DSIK-ja*, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje se pretendime të tilla kanë gjetur trajtim në vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, zbatuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilave organet e rivlerësimin kryejnë një hetim të pavarur dhe të pa kushtëzuar nga raportet e organeve ndihmëse, një ndër të cilat edhe DSIK-ja. Faktin që Komisioni ka mbajtur një qëndrim të pavarur e dëshmon më së miri qëndrimi i ndryshëm i tij, nga ai i DSIK-së, duke mos e konsideruar subjektin të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e aftësive profesionale

68. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimin, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme dhe në analizimin e fakteve të denoncuar nga publiku gjatë procesit të rivlerësimin. Lidhur me kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimin, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “[...] subjekti i rivlerësimin për shkak të mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit ka demonstruar gjykim të dobët, që ka sjellë, gjithashtu, shkelje të të drejtave të palëve, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Trupi gjykues vlerëson se ndodhet para rastit kur gabimet e subjektit të rivlerësimin evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, prandaj edhe subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm, për sa i përket aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.
69. Subjekti i rivlerësimin pretendon se *Komisioni nuk ka arsyetuar përse i referohet ligjit nr. 96/2016 edhe për raste jashtë periudhës së rivlerësimin në tejkallim të kompetencave të tij duke i dhënë ligjit fuqi prapavepruese, pasi Kushtetuta dhe ligji kanë ngarkuar organe të tjera që kontrollojnë tej datës 08.10.2016.*
70. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, vëren se në pikën 3 të tij përcaktohet shprehimisht se periudha e vlerësimin për aftësitë profesionale për efekt të këtij ligji do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit. Pavarësisht këtij rregulli të përgjithshëm, ligjvënësi ka parashikuar në pikën 4 të këtij neni edhe rastin përjashtimor, sipas së cilit: *Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimin. Në lidhje*

me këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 84/2016, ka arsyetuar: “[...] *Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4 ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë gjithashtu nga organet e reja kushtetuese të rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit. Duke zbatuar edhe në këtë rast interpretimin pajtues të normës, gjykata vlerëson se kjo është mënyra se si duhet të interpretohet pika 4 e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, nën dritën e standardeve kushtetuese dhe se një interpretim i ndryshëm i saj mund të bëhet shkak edhe për trajtimin e pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit”.*

71. Në zbatim të këtyre dispozitave, trupi gjykues vëren se, në rastin konkret, Komisioni ka analizuar dhe i ka nënshtruar vlerësimit të tij, ndër të tjera, edhe procedimin penal nr. {***}/2017, për veprën penale të “Falsifikimi i monedhave” parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal, të adresuar nga denoncuesi E. S., duke e shtrirë periudhën e vlerësimit edhe në vitin 2017, pra, edhe përtej kufirit të sipërm të periudhës së vlerësimit, e cila është tri vitet e fundit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016 dhe shtrihet në periudhën 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016. Ky procedim penal është marrë në shqyrtim nga Komisioni pas një denoncimi nga publiku që jepte informacion mbi mangësi në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke plotësuar kushtet e nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shtrirjen e periudhës së vlerësimit për aftësitë profesionale, për një periudhë më të gjatë kohore se sa tri vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.
72. Subjekti i rivlerësimit në konsiderata të përgjithshme pretendon se *shkeljet apo mangësitë profesionale të konstatuara nuk mjaftojnë për kualifikimin “si të papërshtatshëm profesionalisht” dhe aplikimin e pikës 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
73. Në shqyrtim të këtij pretendimi, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe ankimi në veçanti për secilën prej dosjeve të analizuara nga Komisioni, trupi gjykues mori në analizë gjetjet dhe konstatimet e Komisionit për çdo çështje, duke i vlerësuar ato në raport me rrethanat konkrete dhe kuadrin ligjor në fuqi. Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni ka evidentuar gjetje apo problematika në 3 (tre) çështje penale që i përkasin dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor e objektiv dhe në 3 (tre) çështje penale të adresuara nga denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
Çështje të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv
74. Në lidhje me dosjen nr. {***}, që i përket kallëzimit penal nr. {***}/2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (në vijim “Prokuroria Sarandë”), Komisioni ka arritur në konkluzionin se *qëndrimi i subjektit se vendimi ka qenë për mosfillim nuk do të thotë që të mos jetë i arsyetuar dhe i kuptueshëm nga palët dhe publiku. Prokuroria, si organ procedural ushtron ndjekjen penale dhe, në përmbushje të detyrave të saj kushtetuese, është e detyruar që në përfundim të hetimit të dalë me një vendim të arsyetuar rreth fakteve, provave, ekzistencës apo jo të veprës penale.*
75. Trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve në dosjen e kallëzimit penal nr. {***} të vitit

2015, të Prokurorisë Sarandë dhe akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se:

- Prokuroria Sarandë, më datë 27.08.2015 ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***/2015, për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” ,e parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal.
- Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 25.09.2015, bazuar në nenin 290, pika 1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin e regjistruar me nr. {***} prot., datë 27.08.2015, në Prokurorinë Sarandë. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim⁶⁶.
- Në raportin e vlerësimit të Prokurorisë së Përgjithshme është konstatuar se në vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 25.09.2015 mungon arsyetimi në lidhje me mungesën e elementëve të veprës penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”, të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal;
- Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës: *“Subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të qartësisë të pjesës arsyetuese të vendimit, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi teksti i vendimit të pushimit të çështjes për këtë procedim penal është i pakuptueshëm”*. Në shpjegimet e tij mbi këtë rezultat hetimi, subjekti ka parashtruar: *“Prokurori përqendrohet në ekzistencën ose jo të faktit penal dhe jo përshkrimin e gjithë kuadrit tjetër si administrativ, etj. apo zgjatje të arsyetimit në raste të tilla. Në këtë kuptim, arsyetimi i mosfillimit të procedimit penal logjikisht ka tendencë në këtë drejtim vlerësimi dhe mendoj kjo është normale, për më tepër nuk ka pasur asnjë lloj pretendimi. Besoj arsyetimi i shkurtër lidhet me faktin tepër formal dhe pa të dhëna konkrete për ndonjë vepër penale. Më parë procedohej për raste të tilla dhe me kthim materialit me shkresë, por kjo praktikë gradualisht po rrallohet”*.

76. Në analizë të përmbajtjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal të akteve të administruara në dosjen e kallëzimit penal, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit (në mungesë të argumenteve konkrete në ankim), trupi gjykues vëren se neni 291, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale përcakton për prokurorin detyrimin që edhe kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, ai jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit penal. Në rastin konkret, nga përmbajtja e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, trupi gjykues vëren se ai përbëhet nga rrethanat e çështjes, si dhe baza ligjore mbi të cilën prokurori ka mbështetur vendimmarrjen e tij, që është neni 290/1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale, por në të mungon analiza dhe arsyetimi mbi mungesën e elementëve të veprës penale. Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo mangësi konsiderohet në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

77. Në lidhje me dosjen nr. 2, që përket procedimit penal nr. {***/2015, të Prokurorisë Sarandë, Komisioni ka arritur në konkluzionin: *“Komisioni vlerëson se neni 50 i Kodit Penal, që ka të bëjë me rrethanat rënduese, është një dispozitë që aplikohet ndaj personit që ka konsumuar veprën penale për të përcaktuar masën e dënimit. Pra, rrethanat rënduese janë ato që ligjvënësi i ka përcaktuar dhe që organet proceduese duhet t'i marrin parasysh për të aplikuar masën maksimale të dënimit. Parë në këtë kontekst, prokurori duhet që rrethanat rënduese t'i*

⁶⁶ Konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 29.05.2018, të Prokurorisë Sarandë, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

bëjë me dije në referim të veprës penale dhe t'i ketë parasysh në caktimin e masës së dënimit që kërkon për autorin e veprës penale”.

78. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në dosjen procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, të Prokurorisë Sarandë dhe akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se:

- Subjekti i rivlerësimit ka regjistruar më datë 08.01.2015 procedimin penal nr. {***}/2015, për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” e parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal, mbi bazën e materialeve të dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka shpallur moskompetencën tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë Sarandë, për çështjen penale të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të nënës së të dëmtuarës M. I.

- Me vendimin nr. {***}, datë 08.01.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi ka gjykuar procedimin penal nr. {***}/2014, i cili ishte regjistruar më parë nga Prokuroria Sarandë, në ngarkim të shtetasve E. T., P. B., A. M., R. C., dhe E. K., të akuzuar për veprën penale të “Shfrytëzim prostitucioni” parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal, ka gjetur fajtorë dhe i ka dënuar shtetasit në fjalë.

- Me vendimin e datës 30.03.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, duke arsyetuar si vijon: *[...] Nga verifikimet e kryera ka rezultuar që në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë të ketë qenë e regjistruar më parë procedimi penal nr. {***}/2014, në ngarkim të shtetasve E. T., P. B., A. M., A. M., R. C., dhe E. K., fillimisht të dyshuar për veprat penale të “Heqja e paligjshme e lirisë” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal dhe “Shfrytëzim prostitucioni”, parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal. Çështja nr. {***}/2014, në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur, është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 08.01.2015, ka dënuar shtetasit në fjalë. Vendimi penal nr. {***}, datë 08.01.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është administruar me cilësinë e provës dokumentare në dosjen e procedimit penal nr. {***}/2015. Në rrethanat e lartpërmendura vlerësojmë se fakti penal objekt hetimi në kuadër të çështjes penale {***}/2015, përbën “gjë të gjykuar” edhe në kuptim të nenit 7 të K.Pr.Penale (ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtin vepër penale), pasi është hetuar në kuadër të çështjes penale nr. {***}/2014 nga ky organ procedimi dhe të pandehurit janë dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.*

- Në raportin e vlerësimit të Prokurorisë së Përgjithshme nuk janë konstatuar gjetje lidhur me këtë rast.

- Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjen: *ai nuk ka bërë prezentë rrethanën rënduese të të akuzuarit, i cili rezultoi të ishte recidiv/përsëritës, për të njëjtën vepër penale.* Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Referuar dhe vendimit gjyqësor, në rastet kur dispozita e parashikon paragraf më vete veprimin në rrethana të caktuara dhe që mund të jenë rënduese nuk ka se si në akuzën për paragrafin ta përfshish. Ose do paraqitet si rrethanë rënduese ose si paragraf konkret në dispozitë, nuk mund të jenë të dyja se bien në kontradiktë. Vetë neni 114/1 i Kodit Penal parashikon paragraf më vete në lidhje me veprimin në rrethana rënduese, ndaj nuk mund të referohet neni 50 i Kodit Penal. Kjo është tashmë praktikë e konsoliduar. Madje nuk ka qenë recidivist (fakt i konfirmuar edhe në vendimin gjyqësor), por ka vepruar ndaj një të mituri dhe në këtë kuptim është akuzuar dhe dënuar për paragrafin e dytë (114/2)”.*

79. Në analizë të konstatimeve të mësipërme, në raport me konkluzionin e Komisionit, si dhe

shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi rezultatet hetimit (në mungesë të argumenteve konkrete në ankim), trupi gjykues vëren se neni 50 i Kodit Penal përcakton rrethanat rënduese të dënimit, një ndër të cilat është edhe rrethana e parashikuar nga shkronja “ç”, kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë. Në vlerësim të zbatueshmërisë së kësaj dispozite, trupi gjykues fillimisht vëren se Komisioni nuk përcakton specifikisht se cilës prej vendimmarrjeve të subjektit të rivlerësimit i referohet dhe për cilin nga të pandehurit bëhet fjalë. Në këto rrethana, trupi gjykues verifikoi, *së pari*, vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***/2015, në drejtim të konkluzionit të arritur nga Komisioni për mosmarrjen në konsideratë të rrethanave rënduese, siç është rasti i një dënimi të mëparshëm. Në këtë drejtim, ndonëse trupi gjykues e gjen jo të mbështetur arsyetimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes se ajo përbën “gjë të gjykuar” për sa kohë që vendimi penal nr. {***}, datë 08.01.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të cilit i referohet subjekti, nuk përmban vulën e gjykatës që është i formës së prerë dhe për çështjen është paraqitur rekurs në Gjykatë të Lartë⁶⁷, nga ana tjetër në vlerësimin e trupit gjykues një fakt i tillë nuk mbështet as konkluzionin e Komisionit se ky vendim dënimi ndaj të pandehurve përbën një rrethanë rënduese, për sa kohë nuk mund të konsiderohet si dënim i mëparshëm pa qenë vendim gjykate i formës së prerë. Ndërsa referuar vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2014, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {***} datë 08.01.2015, ka vendosur deklarinimin fajtorë dhe dënimin e shtetasve të mësipërm, nga përmbajtja e vendimit të gjykatës, trupi gjykues vëren se gjykata, pasi ka verifikuar certifikatat e gjendjes gjyqësore, ka konstatuar se ata kanë qenë të padënuar më parë. Në konkluzion të kësaj analize, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk konfirmohet konkluzioni i Komisionit mbi konsiderimin e rrethanave rënduese, sipas përcaktimeve të nenit 50 të Kodit Penal në aplikimin e masës së dënimit.

80. Në lidhje me dosjen nr. {***}, që i përket procedimit penal nr. {***/2015, të Prokurorisë Sarandë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se *arsyetimi i subjektit në pushimin e këtij procedimi penal është i pabazuar në legjislacionin procedural penal. Ligji penal ka bërë klasifikimin e veprave penale, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar që për veprat penale, për të cilat ligji parashikon masë të vogël dënimin, prokuroria apo gjykata të mos arsyetojë vendimin.*
81. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në dosjen procedimit nr. {***/2015 dhe akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se:
- Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka regjistruar në datën 18.11.2015 procedimin penal nr. {***/2015, për veprën penale “Vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit M. Z., të datës 15.11.2015, për vjedhjen e një karroce në pronësi të tij.
 - Kallëzuesi M. Z., ka deklaruar⁶⁸ se [...] *në lidhje me denoncimin e bërë nga ana ime për humbjen e karrocës, unë sqaroj se karrocën (rimorkion) e kam gjetur në rregull dhe e kam në shtëpinë time dhe, për këtë arsye, nuk dua të merrem me pretendimin që kam bërë.*

⁶⁷ <https://gjykataelarte.gov.al/sq/ceshtje/> shtetasi E. K., ka paraqitur në datën 15.09.2015 rekurs në Gjykatën e Lartë, lidhur me çështjen penale me palë Prokuroria Sarandë dhe të pandehurit E. K., E. T., R. C., A. M, A. M., dhe P. B., akuzuar për veprat penale “Shfrytëzim i prostitucionit”, “Heqje e paligjshme e lirisë” dhe “Moskallëzim krimi”.

⁶⁸ Në procesverbalin e deklarimeve të datës 21.07.2016.

- Me vendimin e datës 28.07.2016, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, të regjistruar për veprën penale të vjedhjes, argumentuar me faktin se në rastin konkret fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim⁶⁹.
- Në raportin e vlerësimit të Prokurorisë së Përgjithshme nuk janë konstatuar gjetje lidhur me këtë rast.
- Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit konstatimin se vendimi i tij nuk përmbante analizë ligjore të mungesës së elementëve të veprës penale. Në lidhje me këtë rezultat hetimi, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka sqaruar se duke qenë përpara një fakti penal të thjeshtë, pa anashkaluar ngarkesën e tij në punë, nuk e ka parë të nevojshme një analizë komplekse e shumëfaqëshe.

82. Në analizë të përmbajtjes së vendimit të pushimit të procedimit penal të akteve të administruara në dosjen e procedimit penal, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, ndonëse ka shprehur shkakun ligjor të pushimit të çështjes, nuk ka kryer një analizë ligjore të elementëve të veprës penale të “Vjedhja”, e parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit, që kallëzuesi nuk ka më asnjë pretendim të mëtejshëm lidhur me faktin e kallëzuar prej tij, nuk përputhet me përdorimin si bazë ligjore për pushimin e çështjes të shkronjës “b” të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, e cila parashikon rastin kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ndërkohë që në rastin konkret duhet të referohej shkronja “c” e kësaj dispozite⁷⁰. Në përfundim të sa më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues konfirmohet konkluzioni i Komisionit mbi mungesën e arsytimit të vendimit të pushimit të procedimit penal. Kjo mangësi vlerësohet të konsiderohet, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Çështje penale të adresuara nga denoncimet nga publiku

83. Në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 29.03.2016, të adresuar në denoncimet e shtetasit V. G., Komisioni ka konkluduar se: “[...] në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2016, subjekti nuk ka kryer hetime dhe nuk ka zbatuar vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. {***}, datë 11.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me mosveprimet e tij ka zvarritur çështjen deri sa ka nxjerrë vendimin e pushimit. Këto mosveprime të subjektit bien në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Moskryerja e detyrave funksionale të subjektit kanë afektuar indikatorët e njohurive të ligjit, aftësive organizative të etikës dhe integritetit, të parashikuara në nenet 73, 74 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

84. Nga aktet e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, të paraqitura nga

⁶⁹ Konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 29.05.2018, të Prokurorisë Sarandë, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

⁷⁰ Në nenin 328, pika 1 përcaktohet: “1. Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij”.

denoncuesi⁷¹, trupi gjykues konstaton se:

- Prokuroria Sarandë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 29.03.2016, mbi bazën e kallëzimit penal të datës 19.02.2016, të shtetasit V. G., ndaj Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, INUV Bashkia Sarandë, Bashkisë Sarandë, INUK Dega Sarandë, IKMT Tiranë, si dhe kundër shtetasit J. Sh., i cili, sipas tij, ka ndërtuar me dokumente të falsifikuara një objekt pa leje ngjitur me pronën e tij.
- Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 01.04.2017, ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
- Pas ankimit ndaj këtij vendimi nga denoncuesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {***}, datë 11.01.2018, ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesës dhe prishjen e vendimit, datë 01.04.2017, të Prokurorisë Sarandë për pushimin e procedimit penal nr. {***} viti 2016, vetëm për sa i përket pjesës që lidhet me veprimtarinë e Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, duke urdhëruar organin e akuzës të kryejë veprimet hetimore të përcaktuara prej saj brenda një afati 3-mujor nga dita që ky vendim të marrë formë të prerë”*. Në këtë vendim, gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar: *“[...] lidhur me kallëzimin penal të shtetasit V. G., ndaj veprimtarisë së punonjësve të drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, gjykata në këtë pikë nuk është dakord me disponimin e prokurorit për pushimin e çështjes, pasi çmon se nga ana e prokurorit nuk janë analizuar të gjitha aktet e nxjerra nga ky organ në drejtim të legalizimit të pronës së shtetasit J. Sh. [...] gjykata çmon se është detyrë e organit të prokurorisë të hetojë në lidhje me këto dy dokumente (gentplani i datës 02.04.2013 dhe procesverbali i konstatimit i mbajtur në datë 28.07.2012), akte të Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, që kanë qenë pjesë e praktikës së legalizimit të pronës së shtetasit J. Sh., për të konkluduar nëse përmbajtja e tyre është e vërtetë apo e pasaktë. Në këtë mënyrë nga ana e prokurorit duhet të urdhërohet kryerja e një ekspertimi teknik në fushën e ndërtimit me qëllim pasqyrimin e planvendosjes së të dy pronave, sipas gjendjes në fakt dhe krahasimi i tyre me gentplanin dhe procesverbalin e konstatimit të mbajtur nga punonjësit e Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, respektivisht në vitin 2013 dhe në vitin 2012. Gjykata konstaton se nga ana e prokurorit nuk është hetuar fare në drejtim të këtyre dy dokumenteve, të cilat për sa kohë që janë pjesë e praktikës së legalizimit dhe janë akte të nxjerra nga punonjësit e drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, në ushtrim të funksioneve të ngarkuara me ligj, kundër të cilëve shtetasi Vangjel Gremo ka paraqitur kallëzim penal dhe pretendon se janë të falsifikuara në përmbajtje [...]”*. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. {***}, datë 26.03.2018.
- Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me këtë denoncim. Në shpjegimet e tij subjekti ka sqaruar se: *“Rasti lidhet vetëm me vlerësime juridike dhe me asnjë argument tjetër. Debati juridik është pjesë e veprimtarisë së prokurorit. Prokuroria Sarandë vazhdon hetimet në lidhje me pretendimet e kallëzuesit. Unë kam dhënë dorëheqjen në interes të ligjit dhe transparencës, për objektivitet maksimal. Kam hetuar këtë çështje dhe kam kryer veprimet procedurale hetimore bazuar në parimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. Fakti që gjykata nuk pranon tërësisht apo pjesërisht kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes nuk prezumon apriori se prokurori*

⁷¹ (i) Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr.{***}, datë 11.01.2018; (ii) kërkesë e datës 07.04.2016, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; (iii) pjesë nga vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër nr.{***}, datë 26.03.2018.

nuk ka kryer detyrën siç duhet, por kjo dëshmon për një kontroll ligjshmërie rigoroz të veprimtarisë hetimore të prokurorit nga gjykata konform ndryshimeve”.

85. Në analizë të fakteve të mësipërme të dala nga vendimet gjyqësore të të dyja shkallëve, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një veprimtari të pamjaftueshme hetimore në drejtim të verifikimit të pretendimeve të kallëzuesit, lidhur me punonjësit e Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime e verifikime të mëtejshme në drejtim të veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve”, duke caktuar detyrë konkrete kryerjen e një ekspertimi teknik në fushën e ndërtimit me qëllim pasqyrimin e planvendosjes së të dy pronave, sipas gjendjes në fakt dhe krahasimin e tyre me gendplanin dhe procesverbalin e konstatimit të mbajtur nga punonjësit e Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, veprime këto të cilat janë urdhëruar nga gjykata. Ndonëse në gjendjen e akteve nuk mund të përftohet informacion nëse subjekti i rivlerësimit ka zbatuar detyrat e caktuara nga gjykata pas rrëzimit të ankimit të tij nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, trupi gjykues vlerëson se ai që në fillim duhet të kishte kryer hetime edhe në drejtim të punonjësve të ALUIZNI-t në funksion të zbardhjes së çështjes. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
86. Në lidhje me materialin kallëzues, me nr. {***}, datë 23.07.2015, të adresuar në denoncimet e shtetasit S. D., Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti ka demonstruar mangësi të theksuara të njohurive ligjore, duke shkelur procedurën e parashikuar në nenin 327 e vijues (sipas Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e fundit) dhe parimet procedurale për një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor. Problematikat e hasura në këtë procedim konsiderohen nga trupi gjykues si serioze dhe të papranueshme, referuar edhe eksperiencës dhe përvojës së prokurorit. Rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve në drejtim të aspekteve ligjore, në kuptim të pikës 2, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magistratit”.*
87. Nga analiza e akteve të vëna në dispozicion nga denoncuesi⁷², të administruara në dosjen e

⁷² Bashkëlidhur denoncimit janë paraqitur aktet si vijojnë: (i) vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 30.08.2017, të prokurorit S. Ç., lidhur me një kallëzim penal ndaj gjyqtarës N. D.; (ii) letër e datës 17.08.2017 e denoncuesit S. D., drejtuar një sërë institucionesh të tilla si Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Ministrin të Drejtësisë, KLD-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën adreson pretendime për disa subjekte rivlerësimi; (iii) letër “takim në KLD më datë 08.10.2018”, me z. N. Gj.; (iv) kallëzim penal i datës 22.07.2015, i kallëzuesit S. D., ndaj shtetasit A. Ç., drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; (v) vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 31.07.2015 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë; (vi) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 25.11.2015; (vii) vendim i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë nr. {***}, datë 15.03.2016; kërkesë e datës 11.06.2018, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë Sarandë; (viii) kërkesë nr. {***}, datë 25.09.2018, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Sarandë; (ix) kërkesë e datës 11.09.2018, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Sarandë; (x) kërkesë e datës 02.06.2016 drejtuar prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; (xi) kërkesë e datës 07.06.2016, drejtuar prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; (xii) listë provash dhe faktesh e datës 30.05.2018, drejtuar prokurorit Lorenc Mërkuri; (xiii) 2 (dy) preventiva punimesh nga preventivues Ing. H. M.; (xiv) shkresë nr. {***} prot., datë 05.09.2017, e Institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar KLD me lëndë “Dërgohet letra e shtetasit S. D.”; (xv) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 05.09.2017, e Institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar shtetasit S. D.; (xvi) shkresë nr. {***} prot., datë 21.07.2017, e Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Kryeinspektorese së KLD-së, me lëndë “Përcillet ankesa e shtetasit S. D.”; (xvii) shkresë nr. {***} prot., datë 07.07.2017, e KLD-së, drejtuar shtetasit S. D.; (xviii) shkresë nr. {***} prot., datë 31.07.2017, e KLD-së, drejtuar shtetasit S. D.

Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

- Shtetasi S. D., ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë Sarandë, regjistruar me nr. {***} prot., datë 23.07.2015, ndaj shtetasit A. Ç., dhe zyrtarëve të Bashkisë Sarandë, Drejtorisë së Urbanistikës dhe INUV-së për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- Në lidhje me këtë kallëzim penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në datën 31.07.2015 mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se [...] *konflikti midis shtetasit S. D., dhe A. Ç., është konflikt me natyrë juridiko/civile dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre, palët duhet t’i drejtohen gjykatës. Fakti i mësipërm nuk përmban elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, pasi shtetasi A. Ç., nuk rezulton të ushtrojë ndonjë funksion publik, [...] në rastin konkret nuk gjenden elementët e ndonjë figure të veprës penale në veprimtarinë e subjekteve të kallëzuar [...].*
- Pas ankimit ndaj këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {***}, datë 25.11.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Prokurorisë Sarandë, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, për kallëzimin penal të shtetasit S. D., dhe vazhdimin e hetimeve, duke arsyetuar ndër të tjera: [...] *Gjykata çmon se në kushtet kur kërkuesi S. D., privatisht me anë të një inxhinieri ndërtimi ka evidentuar shkeljet e kryera sipas tij nga ana e sipërmarrësit A. Ç., të cilat, sipas tij, janë të tilla që mund të vënë në rrezik edhe vetë ekzistencën e këtij objekti, prokurori kishte detyrimin ligjor për të kryer disa verifikime lidhur me këto pretendime të kallëzuesit S. D., pasi nëse me të vërtetë ekziston një rrezik i tillë është e qartë se nuk jemi përpara përgjegjësisë civile, por as penale dhe është detyrë e organit të akuzës së identifikojë llojin e shkeljes së kryer dhe të kualifikojë drejt veprën penale që mund të jetë konsumuar nga subjekti në rastin konkret. Po kështu, gjykata e gjen të pabazuar argumentin e prokurorit se shtetasi A.Ç. nuk është funksionar publik dhe, si i tillë, nuk mund të pretendohet se ai ka kryer veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, sipas nenit 248 të Kodit Penal, pasi kallëzimi i shtetasit S. D., lidhur me këtë vepër nuk shtrihet ndaj shtetasit A. Ç., por ndaj funksionarëve të Bashkisë Sarandë dhe prokurori duhej ta shtrinte hetimin e tij ndaj këtyre funksionarëve duke administruar së pari aktet administrative të miratuara nga ky organ si për lejimin e ndërtimit të këtij objekti ashtu dhe për miratimin e lejes së shfrytëzimit të saj. Gjykata ka urdhëruar kryerjen e veprimeve si vijojnë: [...] caktimi i një eksperti që do të bëjë këqyrjen në vend të objektit dhe do të saktësojë nëse nga ana e sipërmarrësit A. Ç., ka shkelje të projektit të miratuar nga ana e KRRT-së Bashkisë Sarandë dhe nëse ka, çfarë pasojash kanë sjellë këto tek prona e ankuesit S. D.; administrimi prej Bashkisë Sarandë, i të gjithë praktikës që i përket ndërtimit të këtij objekti që i përket si fazës për lejimin e ndërtimit të tij, ashtu dhe fazës për miratimin e lejes së shfrytëzimit, për të parë nëse nga funksionarë të Bashkisë Sarandë është shkelur ligji dhe nëse mund të ketë konsumim prej tyre të veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Pas ankimit ndaj këtij vendimi nga Prokuroria Sarandë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 15.03.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.*
- Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime për këtë denoncim. Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar se: *“Ankesa është dukshëm e pabazuar. Thjesht vlerësime subjektive të ankuesit pa asnjë bazë. Vendimi mbi mosfillimin e procedimit penal është marrë brenda afatit ligjor, mbi bindjen time të brendshme bazuar në analizën e fakteve dhe provave. Pas regjistrimit të çështjes mbi bazën e*

vendimmarrjes së gjykatës, në përfundim të hetimeve, kam ngritur akuzë dhe kam marrë të pandehur sipërmarrësin A. Ç. Bëhet fjalë për një debat të vlerësimit dhe të interpretimit thellësisht juridik, madje dhe vetë gjykata nuk është konsekuente që tregon se kemi të bëjmë me një cazus të diskutueshëm. Nuk ka pasur asnjë arsye apo shkak ligjor për përjashtimin tim. Kam paraqitur ankim ndaj vendimit të shkallës së parë për pafajësinë, më shumë për zënie afati sepse nuk kisha ende vendimin e plotë të zbardhur. Ndërkohë, pasi u zbardh vendimi, i pandehuri ka vdekur për shkak të Covid-19” .

88. Në analizë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues, referuar vendimeve gjyqësore të të dyja shkallëve, vëren veprime të pamjaftueshme verifikuese në drejtim të pretendimeve të kallëzuesit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime, të tilla si caktimi i një eksperti që do të bëjë këqyrjen në vend të objektit dhe do të saktësojë nëse nga ana e sipërmarrësit A. Ç., ka shkelje të projektit të miratuar nga ana e KRRR-të Sarandë; administrimi prej Bashkisë Sarandë, i të gjithë praktikës që i përket ndërtimit të këtij objekti, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për t’u kryer në fazën paraprake edhe nga gjykata. Pavarësisht se nga aktet e administruara nuk përftohet informacion mbi zbatimin e detyrave të lëna nga gjykata nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ato duhet që të ishin kryer që në fillim nga subjekti i rivlerësimit në funksion të zbardhjes së çështjes. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se vendimi, për mosfillimin e procedimit penal i datës 31.07.2015, i subjektit të rivlerësimit, është marrë pa u kryer veprimet e duhura në drejtim të verifikimit të pretendimeve të kallëzuesit, konfirmuar edhe nga vendimmarrja e gjykatave të të dyja shkallëve, qoftë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, qoftë nga Gjykata e Apelit Gjjirokastër. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
89. Në lidhje me procedimin penal nr. {***/2017, të adresuar në denoncimin e shtetasit Erjon Skopeci, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“Problematikat e hasura në këtë procedim konsiderohen nga trupi gjykues si serioze dhe të papranueshme, referuar edhe eksperiencës dhe përvojës së prokurorit. Rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve ligjore, në kuptim të pikës 2, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Këto mosveprime të subjektit kanë afektuar indikatorët e njohurive të ligjit, aftësitë organizative të etikës dhe integritetit, të parashikuara në nenet 74 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
90. Nga verifikimi i akteve të administruara në Komision prej denoncuesit⁷³ dhe subjektit të

⁷³ Denoncuesi ka paraqitur bashkëlidhur denoncimit aktet si vijojnë: -- vendim nr. {***}, datë 31.01.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; -- kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit, e datës 16.02.2017 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; -- urdhër për ekzekutimin e vendimit penal të gjykatës, i datës 16.02.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, drejtuar Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë; -- dispozitiv i vendimit nr. {***}, datë 16.02.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; -- vendim për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit E. S., të datës 24.03.2017; -- vendim për mosfillimin e procedimit penal të datës 10.07.2017; -- shkresë nr. {***} prot., datë 24.04.2017, e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, lidhur me procedimin penal në ngarkim të E. S.; -- kërkesë e shtetasit E. S., e datës 13.02.2017, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm; -- ankesë e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 14.02.2017; -- vendim i Inspektoratit të KLD nr. {***} prot., datë 02.10.2017, mbi arkivimin e ankesës së shtetasit S. S.

rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, rezulton se:

- Prokuroria Sarandë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}/2017 për veprën penale të “Falsifikimi i monedhave” parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal, mbi bazën e materialit kallëzues të përcjellë në datën 23.01.2017, nga Drejtoria e Policisë Sarandë, mbi kallëzimin e shtetasës E.B., e cila kishte paraqitur më datë 21.01.2017 kallëzim penal për blerjen me kartëmonedha falco të një aparati celular në dyqanin e saj nga një person i panjohur. Ajo kishte fiksuar automjetin e markës “Opel” me targa {***}.
- Me urdhrin “Për ndalimin e të dyshuarit për një krim” të datës 27.01.2017, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 253 të Kodit të Procedurës Penale, ka urdhëruar ndalimin e menjëhershëm të shtetasit E. S., pasi dyshohet të jetë autori i veprës penale të parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal. Në këtë urdhër, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar veprimet procedurale hetimore të kryera nga policia gjyqësore, deri në atë moment, të tilla si: [...] është bërë identifikimi në sistemin TIMS në rubrikën “Gjoha” i personit pronar i automjetit tip “Opel” me targa {***}, ngjyrë e kuqe, i cili rezulton se i përket shtetasit E. S., [...]. Nisur nga të dhënat e dhëna në kallëzimin e bërë nga shtetasja E. B., për karakteristikat e personit të dyshuar për këtë ngjarje, nga ana jonë u nxor nga sistemi TIMS fotoja e këtij personi dhe u bë krahasimi i shenjave dhe karakteristikave të personit, sipas kallëzimit të bërë me karakteristikat e përfituara në foton e nxjerrë nga sistemi TIMS për shtetasin E. S., nga ku rezultoi se ishte i njëjti person. Më datë 26.01.2017, nga ana e komisariatit të Policisë Durrës është bërë kapja e personit në kërkim E. S., dhe më pas shoqërimi i tij në Komisaratin e Policisë Sarandë së bashku me mjetin që ai ka në pronësi tip “Opel Astra”, me targa {***}, ngjyrë vishnje. Lidhur me këtë ngjarje është kryer veprimi procedural i paraqitjes për njohje direkt të personit të dyshuar E. S., nga ana e shtetasës së dëmtuar E. B. Referuar procesverbalit për njohjen direkt të personit ka rezultuar se shtetasja E. B., në të gjitha versionet e paraqitjes së personave konkretë të ketë identifikuar si autor të veprës penale pikërisht të dyshuarin E. S. Gjithashtu, prej policisë gjyqësore është bërë dhe këqyrja e jashtme e mjetit që posedonte shtetasi i dyshuar E. S., e cila është shoqëruar me fotografitë përkatëse. Nga këqyrja e dokumenteve të gjendura në mjetin e tij rezulton se mjete autoveturë i markës “Opel” tip Astra, me targë {***}, ngjyrë e kuqe, është në pronësi të shtetasit E. S., banues në Durrës. Sipas informacionit të policisë gjyqësore rezulton se karakteristikat e përshkruara nga ana e kallëzueses E. B., ditën e ngjarjes, përputhen me ato të konstatuara pas kapjes së tij, si për vetë autorin e dyshuar, ashtu edhe për mjetin që ai ka në pronësi. Në rrethanat e lartpërmendura, rezulton të ketë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi E. S., [...] të jetë autor i veprës penale të parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal. Më datë 28.01.2017, subjekti i rivlerësimit, duke parashtruar se ekzistojnë kushtet ligjore të parashikuara nga nenet 228-229 (kushtet dhe kriteret e përgjithshme), 230/1 (kriteret e veçanta), 253, 258, 259 e 244/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë vleftësimin të ligjshëm të ndalimit të shtetasit E. S., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimi i monedhave” i parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj tij “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {***}, datë 31.01.2017, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Sarandë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori E. H., duke vendosur vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit të personit nën hetim E. S., mbi bazën e urdhrin të

ndalimit të prokurorit Lorenc Mërkuri dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

- Me kërkesën e datës 16.02.2017, prokurori E. H., i ka kërkuar gjykatës zëvendësimin e masës së sigurimit⁷⁴ për shtetasin E. S., nga “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 në “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, arsyetuar me faktin se nevojat e sigurimit janë zbutur, kërkesë e miratuar nga gjykata me vendimin nr. {***}, datë 16.02.2017, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të shtetasit E.S.

- Me vendimin e datës 24.03.2017, prokurori E. H., ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit E. S., dhe shuarjen e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndërsa me vendimin e datës 10.07.2017, prokurori I. H., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga shtetasi E. S., ndaj shtetases E. B., për veprën penale “Kallëzim i rremë” i parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal;

- Në përfundim të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është ftuar nga Komisioni të japë shpjegime, për këtë denoncim. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *[...] dosja nuk është trajtuar nga unë, kam nxjerrë urdhrin e ndalimit dhe kërkesën për masë sigurimi. Besoj duhet të kem qenë dhe në komunikim me prokurorin e çështjes. Ndoshta ai ka pasur impenjim tjetër zyrtar, arsye tjetër, nuk mund ta kujtoj. Impenjimi im ka qenë në funksion të punës dhe shpejtësisë së reagimit ligjor. Në seancë të masës së sigurimit është paraqitur vetë prokurori i çështjes. Në fakt prokurori mbrojti të njëjtat kërkesa, ndalimi është vleftësuar i ligjshëm nga gjykata. Në këto rrethana nuk arrij të kuptoj se si pretendimet janë drejtuar ndaj meje. [...] Rasti mendoj ka qenë fatkeq, disa prova që përputheshin dhe denoncuesja që njohu mjetin dhe personin (i njëjti mjet, e njëjta ngjyrë, të njëjtat numra e germa të targës vetëm me ndryshimin 567 dhe 576). Besoj çdo prokuror apo gjykatë në këto rrethana do të vlerësonte në të njëjtën mënyrë, mund të ndodhë në çdo vend të botës. Gabimi i denoncueses ishte njerëzor dhe ajo më vonë e gjeti dhe e denoncoi autorin që është dënuar sipas ligjit [...].*

91. Në analizë të fakteve të mësipërme, nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i Komisionit, për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit në këtë rast, bazohet në argumentet si vijojnë: (i) subjekti ka treguar mangësi profesionale dhe nuk ka kryer hetim në lidhje me objektin e ngjarjes; (ii) subjekti nuk ka kryer veprime procedurale të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes dhe nuk është investuar për një procedim të drejtë bazuar në parimet e Kodit të Procedurës Penale; (iii) subjekti për shkak të moskryerjes së hetimeve dhe përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe procedurale, i ka hequr lirinë një qytetari të pafajshëm. Në këto drejtime, trupi gjykues vëren, *së pari*, se në gjendjen e akteve nuk përcaktohet qartësisht nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë prokurori i çështjes, jo vetëm për shkak të mungesës së urdhrin të regjistrimit të procedimit penal, por edhe për shkak se nga kronologjia e akteve procedurale vihet re se prokurori që ka ndjekur çështjen në vijim nuk ka

⁷⁴ Nga hetimet ishin ngritur dyshime që autori i veprës penale mund të ishte shtetasi O. M., i cili ishte parë nga kallëzuesja E. B., duke qarkulluar në qytet me automjetin me targa {***}. Kallëzuesja kishte deklaruar përpara Policisë Gjyqësore se ishte ky shtetasi që i kishte dhënë kartëmonedhat falco dhe ishte larguar. Sipas saj ky person kishte shumë karakteristika të ngjashme me shtetasin E. S., dhe targat e makinave të tyre ndryshonin vetëm me një shkronjë. Makina e E. S., kishte targën {***}, ndërsa makina tjetër kishte targën {***}. Në kuadër të hetimeve paraprake kompania celulare EAGLE ka informuar se aparati celular me IMEI i celularit i blerë me kartëmonedha falco ishte i regjistruar në emër të shtetasit H. M.

qenë subjekti i rivlerësimit. Në të tilla rrethana, si dhe në kushtet kur urdhri i ndalimit dhe masa e sigurimit e dhënë ndaj denoncuesit, si veprime procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit nuk nënkuptojnë përfundimin e hetimeve, nuk mund të flitet për mungesë veprimesh hetimore për zbardhjen e ngjarjes, të cilat siç konstatohet nga aktet procedurale në vijim kanë vijuar të kryhen nga prokurori i çështjes, i cili ka zëvendësuar brenda dy javësh masën e sigurimit nga arresti në burg në detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se urdhri për ndalimin e të dyshuarit, i parashikuar nga neni 253 i Kodit të Procedurës Penale, i marrë nga subjekti i rivlerësimit është bazuar në veprimet hetimore të kryera deri në atë moment nga policia gjyqësore, siç janë: (i) të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, që përputheshin me të dhënat e përshkruara nga kallëzuesja, lidhur me targën e automjetit të shtetasit E. S.; (ii) krahasimi i fotografisë të nxjerrë nga sistemi TIMS për shtetasin E. S., me karakteristikat e përshkruara nga kallëzuesja; (iii) procesverbalin e njohjes direkt të kallëzueses, sipas së cilës identifikohet si autor shtetasi E. S. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit urdhrin e ndalimit e ka argumentuar me parandalimin e rrezikut të ikjes dhe shmangies së të dyshuarit ndaj procedimit, bazuar në faktin se vepra penale e dyshuar parashikonte një dënim maksimal deri në 5 vjet burgim, si dhe faktin që personi deri aktualisht i ishte shmangur hetimit të çështjes. Në konkluzion të kësaj analize, në vlerësimin e trupit gjykues nuk konfirmohet konkluzioni i Komisionit për mangësi të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e veprimeve hetimore.

Procedime penale të referuara nga informacionet e organeve ligjzbatuese

92. Në lidhje me procedimin penal nr. {***/2014, Komisioni ka konkluduar se: *Mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit janë të dukshme dhe të tilla që çojnë në një vlerësim për qëllim të procesit të rivlerësimit, pasi ka munguar në marrjen e veprimeve procedurale të nevojshme dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të veprës penale. Për një vëzhgues të jashtëm krijon premisa serioze të cenimit të besimit të drejtësisë, në kontekstin e mosveprimit apo veprimeve të qëllimshme për të mos lejuar mbajtjen e përgjegjësisë penale, duke krijuar efektin e pandëshkueshmërisë në perceptimin e publikut.*
93. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në dosjen procedimit nr. {***/2014 dhe akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se:
- Më datë 29.04.2014, Drejtoria e Policisë Vlorë i ka përcjellë Prokurorisë Sarandë materialet procedurale në ngarkim të shtetasit H. H., për veprën penale të “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” parashikuar përkatësisht nga nenet 278/3 dhe 283 të Kodit Penal⁷⁵.

⁷⁵ Sipas informacionit për referimin e veprës penale të prokurorit, të datës 28.04.2014, rrethanat e çështjes parashtrihen si vijojnë: “[...] forcat e FNSH-së 712 Tiranë [...] në datën 28.04.2014, ora 00:30, kishin gjetur katër çanta të dyshuara me lëndë narkotike të braktisura në vendin e quajtur “{***}” afër piramidës {***} në fshatin {***} dhe dyshonin se këtë lëndë e transportonte shtetasi B. H., djali i shtetasit H. H., banues në fshatin {***}. [...] Pasi është shkuar në banesë nuk është bërë e mundur gjetja e tij, dhe nga pohimi verbal i Halit Hasani, del se djali i tij quhej B. H., dhe ndodhej në Tiranë. Nga kontrolli i banesës u sekuestruan 5 telefona jo të rregullt, një kartë telefoni dhe një tytë arme gjahu. Më pas kontrolli vazhdoi në stanin e këtij shtetasi, ku gjatë këqyrjes së stanit të lopëve të shtetasit H. H., [...] u gjetën 7 copë kallëpe forma të ngjashëm me lëndën plasëse tritol, një ndezës granate, një kapsollë, me fitil zjarrpërcjellës 45 cm e gjatë, 2 granata [...]. Nga ana jonë u bë sekuestrimi dhe vendimet për ekspertimin daktiloskopik vlerësues dhe teknik të eksplozivit [...] këqyrja e vendit të ngjarjes së gjetjes së katër çantave në vendin e quajtur {***}; u bë sekuestrimi i lëndës narkotike, peshimi i saj, si dhe përpilimi i vendimeve për ekspertimin daktiloskopik vlerësues dhe kimik të lëndës. I pyetur si person nën hetim shtetasi H. H., nuk ka dashur të japë shpjegime dhe ka refuzuar firmën. [...]”.

- Subjekti i rivlerësimit ka regjistruar në datën 29.04.2014, procedimin penal nr. 256 të vitit 2014 për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal dhe regjistrimin e emrit të personit nën hetim, H. H. Po në këtë datë, me vendim “Për veçimin e materialeve të çështjes penale nr. {***} të vitit 2014”, drejtuesi i prokurorisë Ç. Sh., ka vendosur veçimin e akteve nga procedimi penal nr. {***} i vitit 2014, të referuara për dispozitën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1, duke regjistruar procedim penal më vete, pa përcaktuar numër dhe datë të regjistrimit të procedimit penal.
- Më datë 05.05.2014, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore⁷⁶, me afat brenda datës 25.05.2014. Me vendimin e datës 22.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur fillimisht pushimin e pjesëshëm të hetimeve në ngarkim të shtetasit H. H.,⁷⁷ e më pas me vendimin e datës 31.12.2014 ka vendosur pezullimin e hetimeve të këtij procedimi penal arsyetuar me faktin se [...] nga veprimet hetimore të kryera dhe provat materiale të administruara nuk është bërë e mundur të provohet se shtetasi H. H.,ka qenë mbajtës i lëndës plasëse të gjetur dhe sekuestruar në afërsi të stanit të bagëtive të tij, [...]. Në këto kushte, nuk është bërë e mundur të provohet se ky shtetas është autor i kësaj vepre penale të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal. [...].
- Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës mbi gjetjet si vijojnë: (i) subjekti nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të materialit të referuar nga policia gjyqësore dhe se vepra penale për të cilën duhet të fillohej procedimi penal është “Trafikimi i narkotikëve” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal; (ii) procedimi penal nr. {***}/2014 duhet të ishte regjistruar për të dyja faktet e referuara, edhe për lëndën narkotike të sekuestruar edhe për municionin; (iii) vendimi për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit H. H., është marrë jashtë afatit ligjor dhe nuk është vendosur asnjë zgjatje afati hetimi. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “[...] Kam vlerësuar materialin në kushtet që më është ngarkuar hetimi. Unë nuk isha autoriteti që përcaktoja apo zgjidhja cilin procedim apo pjesë të procedimit duhet të ndiqja. Procedimi më ka ardhur i regjistruar. Arrestimi ishte kryer vetëm për armëmbajtjen dhe jo për narkotikët, unë jam ngarkuar me hetimin për këtë pjesë, kjo duket qartë nga aktet. Ndërkohë në praktikën e punës në dijeninë time ecuria ka qenë e tillë: procedimet penale përfshi “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal, vepër penale në kompetencë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda

⁷⁶ (i) Të administrohen pranë Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë, në një kohë sa më të shkurtër aktet e ekspertimit daktiloskopik vlerësues dhe teknik i lëndës eksplozive etj.; (ii) të pyetet hollësisht në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale bashkëshortja e të dyshuarit Th. H.; (iii) të pyeten në të njëjtën cilësi dhe për të njëjtat fakte familjarët e tjerë të të dyshuarit H. H.; (iv) të pyeten nëse kanë dijeni mbi itinerarin e lëvizjeve të të dyshuarit dhe familjarëve të tij shtetasit Sh. I. dhe M. H.; (v) të administrohet kopje e njehsuar e librit të sallës operative të Komisarariatit të Policisë Sarandë në faqet ku mbarten të dhënat për datat 27- 28.04.2014; (vi) të këqyret memorja e aparateve telefonike të sekuestruar në banesën e të dyshuarit; (vii) të bëhen të kërkueshme dhe të administrohen të dhënat përkatëse nga kompanitë respektive të telefonisë celulare, për numrat celularë të dyshuarit dhe familjarëve të tij për periudhën e ngjarjes; (viii) të administrohen me procesverbal pranë Prokurorisë Sarandë, kopje të njehsuara të akteve nga fashikulli i procedimit penal nr. {***}, datë 29.04.2014, si dhe materiali i administruar të analizohet me prokurorin e çështjes.

⁷⁷ Në këtë vendim arsyetohet se: [...] nga veprimet hetimore të kryera dhe provat materiale të administruara nuk është bërë e mundur të provohet se shtetasi H. H.,ka qenë mbajtës i lëndës plasëse të gjetur dhe sekuestruar në afërsi të stanit të bagëtive të tij, në vendin e njohur me emrin “{***}”, {***}. Nga hetimi nuk është bërë e mundur të provohet se ky shtetas është autor i kryerjes së veprës penale, për të cilën është regjistruar procedimi penal në ngarkimin e tij.

Tiranë niseshin nga kjo prokurori, por kjo nuk përjashtonte kontribute të prokurorive të rretheve për situata të caktuara. Pavarësisht se është regjistruar procedimi për armëmbajtjen, motivi duhet të ketë qenë hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. [...] Duket nga veprimet e para ka mbetur i veçuar materiali pikërisht për pjesën e narkotikëve dhe mua më është ngarkuar hetimi vetëm në drejtim të armëmbajtjes. Logjikisht këtë nënkupton dhe vendimi për veçimin nga drejtuesi. Procedimi më tej për narkotikët nuk ishte kompetencë apo detyrë e imja, por vlerësohej dhe përcaktohej nga marrëdhëniet e drejtuesit me policinë dhe me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. [...] vendimi për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit H. H., nuk duhet të jetë marrë jashtë afatit ligjor, por duhet të jetë një lapsus i datës, me saktësi pas kaq kohësh nuk mund të gjykoj”.

94. Nga analiza e fakteve të mësipërme, rezulton se veprimtaria hetimore e këtij procedimi penal është shtrirë në harkun kohor 29.04.2014 – 22.12.2014, në tejkalim të afatit të parashikuar nga neni 323, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, periudhë gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë disponuar me vendim për zgjatje të afatit të hetimeve, sipas kërkesave të nenit 324, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo kohëzgjatje duket se ka ardhur, *së pari*, për shkak të mosrespektimit të afatit të caktuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore, për t’u kryer brenda datës 25.05.2014. Konkretisht, janë administruar me disa ditë vonesë nga afati i përcaktuar, akti i ekspertimit vlerësues i provës materiale me nr. {***}, i cili mban datën 16.06.2014 dhe akti i ekspertimit teknik të provave materiale me nr. {***}, i cili mban datën 18.06.2016, si dhe janë dërguar në tejkalim të afatit të përcaktuar në urdhër, kërkesat për informacion drejtuar kompanive telefonike, më 26.05.2014, që ka sjellë administrimin me vonesë të përgjigjeve të tyre në datat 05.06.2014, 09.07.2014 dhe 25.11.2014. *Së dyti*, veprimtaria hetimore e kryer në muajt korrik – dhjetor rezulton me veprime të rralla, duke konsistuar vetëm në administrimin e përgjigjeve të kompanive telefonike, të cilat nuk e justifikojnë kohëzgjatjen e hetimit të çështjes për disa muaj. Veç sa më sipër, referuar akteve të fashikullit të procedimit penal, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte regjistruar fillimisht të dyja veprat penale, sipas referimit nga organi i policisë, pra, edhe veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Në vlerësimin e trupit gjykues ky argument mbështetet edhe në faktin se ka qenë pikërisht subjekti i rivlerësimit, i cili ka disponuar në të njëjtën datë me regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal edhe me vendimet për vleftësimin e sekuestros së datës 29.04.2014, duke vendosur përveç të tjerash edhe sekuestrimin e 4 (katër) çantave që mbartnin gjithsej 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) pako me materialin bimor të dyshuar lëndë narkotike, me peshë totale 144,375 kg, të gjetura në vendin e quajtur “{***}” afër piramidës {***} në fshatin {***}, sipas procesverbalit të sekuestrimit të provave materiale të datës 28.04.2014. Vetëm pas këtij momenti procedural, drejtuesi i prokurorisë mund të procedonte me veçimin e akteve nga procedimi penal nr. {***} të vitit 2014, të referuara për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, sipas nenit 283 të Kodit Penal, duke e regjistruar procedim më vete e duke bërë më pas edhe kualifikimin e duhur ligjor të veprës penale. Moskryerja e regjistrimit të procedimit penal nga subjekti i rivlerësimit për një vepër të rëndë penale, në shkelje të dispozitave procedurale, përveçse konsiderohet në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatoreve të parashikuar në

nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, mbështetur edhe në informacionet që organet ligjzbatuese kanë administruar lidhur me të, i japin një peshë të veçantë shkeljes së kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë procedim penal.

95. Në lidhje me procedimet penale nr. {***/2016, {***/2016, {***/2016, {***/2016 dhe {***/2016, Komisioni ka arritur në konkluzionin se *urdhri për regjistrimin e këtyre procedimeve penale është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashikuar në udhëzimin nr. {***/2016, datë 19.06.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. {***/2016, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm.*
96. Trupi gjyqësor, pas shqyrtimit të akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se: (i) mbi bazën e materialit kallëzues të Policisë Sarandë (Stacioni i Policisë {***/2016) të administruar në Prokurorinë Sarandë me nr. {***/2016 prot., datë 26.05.2016, subjekti ka regjistruar më datë 05.10.2016 procedimin penal nr. {***/2016, për veprën penale “Vetëgjyqësia” të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit {***/2016; (ii) mbi bazën e materialit kallëzues të Policisë Sarandë të administruar në prokurori me nr. {***/2016 prot., datë 01.06.2016, subjekti ka regjistruar më datë 06.10.2016 procedimin penal nr. {***/2016, për veprën “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 140/a/1 i Kodit Penal; (iii) mbi bazën e materialit kallëzues të Policisë Sarandë të administruar në prokurori me nr. {***/2016 prot., datë 27.06.2016, subjekti ka regjistruar më datë 06.10.2016, procedimin penal nr. {***/2016, për veprën penale të “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve M. S., dhe G. S.; (iv) mbi bazën e materialit kallëzues të Policisë Sarandë të administruar në prokurori me nr. {***/2016, datë 27.06.2016, subjekti ka regjistruar më datë 06.10.2016 procedimin penal nr. {***/2016, për veprën penale “Vetëgjyqësia” të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, ndaj personit nën hetim J. S.; (v) mbi bazën e materialit kallëzues të Policisë Sarandë të administruar në prokurori me nr. {***/2016, datë 30.06.2016, subjekti ka regjistruar më datë 06.10.2016 procedimin penal nr. {***/2016, për veprën penale “Vetëgjyqësia” të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit J. S.; (vi) me vendim të datës 07.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. {***/2016, nr. {***/2016, nr. {***/2016, nr. {***/2016, nr. {***/2016 dhe nr. {***/2016 të vitit 2016, në një procedim penal të vetëm me nr. {***/2016; (vii) më datë 20.04.2017, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës gjykimin e procedimit penal nr. {***/2016, me të pandehur J. S., M. S., V. S., dhe G. S.; (viii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {***/2017, datë 30.11.2017, ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të veprës për të pandehurit J. S., e M. S., nga “Dhuna në familje e kryer në mënyrë të përsëritur” të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal në “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, deklarimin fajtorë të të pandehurve J. S., M. S., dhe V. S., për veprën penale “Dhuna në familje”; (ix) në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, pas kalimit të barrës së provës për të njëjtin konkluzion si pasqyruar në paragrafin 95 më sipër, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Pretendohet se nga momenti i regjistrimit të materialeve kallëzues deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal ka kaluar periudha mbi një muaj. Kjo nuk përbën shkelje të asnjë dispozite apo urdhri konkret. Afatet janë për mosfillimet, ato kanë qenë rekomanduar fillimisht “të arsyeshme”, pastaj “30 ditë”, por në K.Pr.Penale nuk ka pasur përcaktim konkret deri në atë të tanishëm për afatin 15 ditë. Është normale që kur kalon afati kalojmë logjikshëm në regjistrim, por nuk ka përcaktim nëse duhet*

bërë në ditën e 32, 33 etj. [...] Gjykata ka përkrahur pothuajse gjithë qëndrimet e mia, sjellja ime ka qenë vetëm në favor të zgjidhjes së drejtë të rastit, pas asnjë lloj kontakti jashtë dosjes dhe ligjit. [...].

97. Në analizë të fakteve të mësipërme, në drejtim të konkluzionit të arritur nga Komisionit, lidhur me kohën e regjistrimit të procedimeve penale në Prokurorinë e Sarandës, trupi gjykues konstaton se: (i) urdhri për regjistrimin e procedimit penal nr. {***/2016, është marrë pas 4 muaj e 10 ditë nga data e paraqitjes së materialit kallëzues; (ii) urdhri për regjistrimin e procedimit penal nr. {***/2016, është marrë pas 4 muaj e 6 ditë; (iii) urdhri për regjistrimin e procedimit penal nr. {***/2016, është marrë pas 3 muaj e 9 ditë; (iv) urdhri për regjistrimin e procedimit penal nr. {***/2016, është marrë pas 3 muaj e 9 ditë; (v) urdhri për regjistrimin e procedimit penal nr. {***/2016, është marrë pas 3 muaj e 6 ditë. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues vëren se në formën e tyre në vitin 2016 ato nuk parashikonin afat kohor për verifikimin e kallëzimit që duhet të kryhet nga prokurori përpara se ai të vendoste për zgjidhjen ligjore të çështjes. Këto afate janë trajtuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar⁷⁸. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar, duke tejkaluar pa shkaqe të përligjura, në periudha të paarsyeshme, afatin e marrjes së urdhrave për regjistrimin e procedimeve penale të mësipërme. Këto mangësi, konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/ 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
98. Në vlerësim të trupit gjykues, mangësitë e konstatuara në aspektin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe ato të konstatuara nga procedimet penale të trajtuara në kuadër të kontrollit të figurës, ku me peshë të veçantë janë ato që i përkasin shtetasve H. H., S. D., e V. G., konsiderohen si mangësi që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm nga pikëpamja e aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
99. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe rezultoi i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 450, datë 22.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

⁷⁸ I ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 27.10.2006 dhe udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili, në pikën 2 të tij, parashikon: “2.1 Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitet të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. 2.2 Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar – në pikën 2.1 të sipërpërmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë. [...]”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 24.10.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi